

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

UBT News

Media & Events

5-25-2016

UBT News - Maj 2016

University for Business and Technology

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper>

Recommended Citation

University for Business and Technology, "UBT News - Maj 2016" (2016). *UBT News*. 3.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper/3>

This Book is brought to you for free and open access by the Media & Events at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in UBT News by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Maj 2016

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

Celebrating



15 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education | Research | Training | Consulting | Certification

Since 2001

UBT - 15 VJET RRËFIM SUKSESI

STUDENTËT E UBT-SË PREZANTUAN 17 BIZNES-PLANE

..... Faqe 5

REKTORI HAJRIZI PARAQET AKTIVITETET E QENDRËS SË UBT-SË PËR SIGURI KIBERNETIKE

..... Faqe 7

Dr.AHMADZARGARI: UNIVERSITETI AMERIKAN OFRON MUNDËSI TË MËDHA PËR STUDENTËT E UBT-SË

..... Faqe 9

UBT IA JEP ÇMIMIN "EXCELLENCE LEADERSHIP AWARD" HUMANISTES AUSTRIAKE, MARIANNE GRAF

..... Faqe 13



Page 4

Editorial

Edmond Hajrizi

UBT – 15 vite shenjë dalluese e cilësisë akademike në rajon

Pesëmbëdhjetë vite në jetën e një institucioni nuk duken shumë. Institucioni krijohet si ide e dikujt, hyn në radhë me ekzistueset, zë vendin e tij në një qoshe dhe zhvillohet me kohën.

Por, në jetën e një institucioni si UBT, që lindi si ide e madhe dhe ndryshe nga të tjerët, nuk zuri një qoshe e as nuk hyri në garë me të tjerët, nuk u zhvillua as me kohën, por eci fuqishëm para saj, ndryshe nga të tjerët dhe shumë hapa përpara kohës, 15 vjet janë shumë të mëdha, shumë dekada për nga gjurmët e lëna, risitë dhe fama e krijuar, jo vetëm në vend.

Këto ditë, maturantë të shkollave të mesme të Kosovës po ndjekin, në klasat e tyre apo në ambientet e UBT-së, atë që UBT u ofron për studime. Është shumë e qartë që ata e njohin shumë mirë institucionin, të arriturat deri tash dhe mundësitë e mëdha që u krijohen duke qenë pjesë e tij. Pyesin deri në detajin më të vogël. E kuptueshme – po ndërmarrin hapin më të rëndësishëm në jetën e tyre, por hapin më të drejtë. Duke ia besuar UBT-së periudhën e studimeve, më të vlefshmen në jetën e një njeriu. Me besim të plotë në sukses.

E ky besim i tyre është përgjegjësia më e madhe që mund të marrë një institucion akademik, të cilin UBT e merr pa frikë, pa drojë, pa dilema. Sepse, kështu ka bërë edhe 15 vitet e kaluara – i ka bërë të rinjtë dhe të rejtat pjesë të tij, u ka qëndruar afër gjatë gjithë kohës së studimeve. I ka futur në rrugën e shkencës e të jetës. Për ta parë veten në një situatë që e lakmon çdo institucion – krenar me secilin student të vetin. Krenar me të gjitha sukseset e shumta të të rinjve e të rejave që, pavarësisht ku kanë arritur, pavarësisht sukseseve të mëdha, flasin për shtëpinë e tyre, UBT-në, si vendin ku nisën rrugën e dijes dhe të suksesit. Për një institucion nuk mund të ketë mburrje më të madhe.

Besimi, dhe sukcesi i studentëve tanë, mbështetet në punën e madhe të bërë në UBT, që nga dita e parë.

UBT, që në nismën e tij, u fut në garën e madhe të dijes. Jo për t'u matur me të tjerët në vend e në rajon. Por, për t'u matur me institucionet akademike më të rëndësishme evropiane e amerikane. Për të sjellë në Prishtinë, në Republikën e Kosovës, përvojat kulminante akademike, më bashkëkohoret, për të sjellë këtu profesorët më të mirë, planprogramet më të avancuara, literaturën e fundit, përvojat moderne në të gjitha fushat që ndërlidhen me edukimin universitar.

Hapi tjetër i UBT-së, i veçantë në të gjithë rajonin, ishte lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institucione prestigjioze akademike në mbarë botën. Profesorë nga këto institucione erdhën në UBT dhe bartën përvojën e tyre te studentët dhe te stafi. Por, më e rëndësishmja, studentët të UBT-

së i vazhduan studimet në këto institucione, në të gjitha nivelet e studimeve. Treguan se janë të barabartë me studentët në kryeqendrat e Evropës, në SHBA e më gjerë. U kthyen në UBT, me tituj akademikë, për ta bartur dijen dhe përvojën e tyre te studentët e rinj. U kthyen në Kosovë, për të drejtuar institucione të rëndësishme, kompani, biznese të suksesshme. Një pjesë e tyre u bënë pjesë e institucioneve ndërkombëtare, të dijes dhe të fushave të tjera.

Ndërkombëtaritetin e UBT-së nuk e bëjnë vetëm këto marrëveshje. Është shumë i gjatë vargu i institucioneve ndërkombëtare, në të cilat UBT ka depërtuar, duke qenë i vetmi institucion nga rajoni. Duke e përfaqësuar denjësisht Republikën e Kosovës, shpesh edhe në institucione ku nuk kanë mundur të depërtojnë as institucionet tona shtetërore. Ky fakt, tashmë, njihet dhe pranohet nga të gjithë. Nëse ka një organizatë të rëndësishme ndërkombëtare, që ka të bëjë me edukimin, shkencën, hulumtimin, inovacionin, përfaqësues i Kosovës në të nuk ka kush të jetë tjetër, pos UBT.

Ndaj, studentë dhe profesorë të UBT-së përfituan shumë nga ky aktivitet ndërkombëtar, që UBT-në e bëri përfitues të shumë programeve edhe nga institucionet kryesore të Bashkimit Evropian, ku institucioni ynë është pikë reference për përkrahje dhe mbështetje.

Veçan kësaj, për çka jemi gjithnjë të vetëdijshëm për peshën e barrës që bart ky përfaqësim dhe kjo përkrahje, UBT e përdori këtë përvojë dhe këtë mbështetje, për ta përcjellë te institucionet e Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet, te studentët, grupet e interesuara, te qytetarët.

Përvoja e ekspertëve të UBT-së po lë shenja të dallueshme në shumë fusha të zhvillimit të jetës në vend, risimtare, për të cilat përvoja ndërkombëtare dhe dija e ekspertëve të angazhuar në këtë institucion është më se e vlerësuar.

UBT ishte këtu, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës, që nga viti 2001. Pikë reference për të gjithë institucionet prestigjioze ndërkombëtare, akademike dhe të tjera. Adresë e shumëkërkuar nga të rinjtë e të rejtat e vendit, që duan studime të nivelit perëndimor në kryeqytetin e tyre. Mëkpritëse e figurave të rëndësishme nga të gjitha fushat, ndërkombëtarë e vendorë, që e quajten privilegj të jenë në UBT dhe nga aty të përcjellin mesazhe të rëndësishme për të gjithë.

Do të jetë këtu, gjithnjë. Adresë e edukimit akademik ndryshe, edukimit modern, hulumtimit, risisë, kualitetit të dëshmuar. Adresë që hap rrugët e suksesit për të gjithë që kanë kaluar nëpër të. Adresë mburrjeje.

Gjithnjë, një hap përpara të tjerëve.



15 YEARS
LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2016

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Bashkëpunëtorë: Besart Troshupa, Fatbardha Kiqina, Sherife Sokoli.

Bashkëpunuan edhe studentët të tjerë të drejtimit Media dhe Komunikim

Adresa: www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: ELV Studio

Shtypi: "Roto Print"

REKTORI EDMOND HAJRIZI FLET PËR STUDIMET GJATË VITIT AKADEMIK 2015-16

UBT - 15 VJET RRËFIM SUKSESI

“Kosova dhe arsimit i lartë në Kosovë është në fazën e ndërkombëtarizimit, prandaj për ne është shumë i rëndësishëm aspekti i ndërkombëtarizimit të UBT-së. Ne kemi një rezultat të mirë tek kjo pjesë, sepse kemi bashkëpunime të shumta me të gjitha vendet e zhvilluara të botës nga Evropa, e SHBA-ja”, thotë rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi në një intervistë për “Radio Kampus” dhe “UBT News”, ka folur për 15 vjet të UBT-së, si rrëfim suksezi, për stafin prej 400 ligjëruesve dhe më shumë se 9 mijë studentëve. Në intervistë, profesor Hajrizi ka folur edhe për nevojën e dinamizimit të kërkimeve shkencore, si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik, për ndërlidhjet dhe shkëmbimin e përvojave të UBT-së me universitete të tjera me traditë evropiane, për nevojën e zgjerimit të UBT-së me programe të reja, për pjekjen e kushteve që edhe në UBT të fillojnë programet e doktoratës...

UBT News: Si kaloi semestri i parë akademik gjatë këtij viti?

Hajrizi: Mendoj se semestri dimëror ka qenë një pjesë e vitit të ri akademik që ka shënuar rezultate sikurse edhe semestrat tjerë të viteve të kaluara. Kemi pasur më shumë studentë, staf e infrastrukturë. Ka pasur rezultate të mira, duke u bazuar në faktin që studentët tanë kanë shfaqur rezultate të mira, e suksese të shumta, si: bursa për studime në universitete të tjera, ku ata kanë shfaqur rezultate pozitive në punët e tyre praktike, duke u angazhuar në problemet që ka pasur Google, pastaj në vizitat e bëra në vende të ndryshme, e që kanë dalë si

rezultat i punëve dhe sukseseve që ata kanë arritur. 40 studentë të UBT-së, pas një ftese nga ekspertë të ndërmarrësisë, për t'i përfshirë në një institucion të kësaj natyre, të gjithë e kanë plotësuar kriterin, që ishte befasi edhe për hartuesit e kriterëve, të cilët mbase kanë pritur që do të ketë më pak, kurse ne kemi qenë akoma më të lumtur për faktin se studentët tanë po bazohen në vlera, po punojnë dhe në këtë mënyrë po shkohen më tutje, prandaj mund të përfundojmë që ka qenë një semestër shumë i suksesshëm.

UBT News: Keni pasur vizita të shpeshta në shtetet evropiane, a mund të tregoni se cilat janë përvojat që i keni marrë nga atje, ose çfarë përvojash keni dërguar?

Hajrizi: Kosova dhe arsimit i lartë në Kosovë është në fazën e ndërkombëtarizimit, prandaj për ne është shumë i rëndësishëm aspekti i ndërkombëtarizimit të UBT-së. Ne kemi një rezultat të mirë tek kjo pjesë, sepse kemi bashkëpunime të shumta me të gjitha vendet e zhvilluara të botës nga Evropa, e SHBA-ja. Nga ky rrjet i tërë bashkëpunimi na bie të kemi vizita të shumta për të rritur bashkëpunimin, pastaj për të krijuar bashkëpunime të reja dhe për t'i intensifikuar ato, por edhe për të gjeneruar projekte e ide të reja bashkëpunimi. Aktualisht jemi fokusuar tek vendet e Vishegradit, si: Çekia, Sllovakia, Hungaria, e Polonia, që edhe atje të krijohen bashkëpunime të shumta. Kemi pasur vizita të shumta në Universitetin e Budapestit, të Varshavës, e të Bratislavës. Kemi qenë si profesorë-vizitorë, kemi shkëmbyer studentë dhe staf, si dhe kemi nënshkruar marrëveshje për diploma të përbashkëta.

Kështu, është krijuar një rrjet i gjerë i mundësive për studentët që të vazhdojnë të kenë bursa, si dhe për stafin që të kenë përvoja të reja me kolegë të tjerë dhe për këtë arsye është

dashur që të vizitohen vende të ndryshme.

UBT News: Dy javët e fundit janë karakterizuar me organizime të përbashkëta: UBT – Shoqata Austriake-Kosovare. Këto zhvillime, pothuajse, kanë qenë në fokus të opinionit publik, prandaj a mund të flisni pak se si keni arritur të ndërtoni raporte kaq të ngushta me strukturat akademike, shtetërore e të shoqërisë civile të Austrisë?

Hajrizi: Unë kam kryer studimet në Austri, si dhe kam punuar atje dhe Austria ka qenë njëra ndër pikënisjet e ndërmarrësisë së UBT-së dhe përkrahëse e madhe në këtë aspekt. Në këtë përkrahje kanë marrë pjesë profesorë e ekspertë, të cilët i kanë kontribuar krijimit, ndërtimit, e zhvillimit të UBT-së. Ne kemi një raport të veçantë me Austrinë dhe me Shoqatën Austriake-Kosovare, ku unë jam udhëheqës i bordit këshilldhënës të kësaj shoqate. Kështu, jemi marrë vesh që bashkërisht të krijojmë evente që kanë për qëllim njoftimin me modelet dhe praktikën e mira austriake, por edhe me temat që janë të nevojshme për zhvillimin e Kosovës. Duke filluar nga viti i kaluar, ne organizojmë konferencat njëditore, të ashtuquajtura “Ditët austriake-kosovare”, për fusha të ndryshme. Kështu, kemi organizuar ditën e mediave, të integritimit evropian, të sigurisë, atë të turizmit, të qeverisjes lokale etj. Në përgjithësi, prekim tema të rëndësishme, ku ftojme ekspertë të jashtëm, kryesisht nga Austria, por edhe nga vende të tjera, ekspertë vendorë, palë të interesit, e qeveritarë, kurse debatojmë për tema me rëndësi për Kosovën, për atë se ku jemi, e ku duhet të shkojmë dhe cilat janë praktikën e mira për zbatim dhe prej te cilave kemi përfitime.

UBT News: A do të vazhdoni me organizime të tilla dhe cilat janë synimet tuaja kryesore që dëshironi t'i arrini duke sjellë ekspertiza e përvoja për fusha të ndryshme?

Hajrizi: UBT-ja është forum ku të gjithë mund të vijnë e të shprehën si dhe të paraqesin pikëpamjet e tyre të pavarura dhe intelektuale. Ideja dhe qëllimi kryesor është që të ftohen personalitete të tilla si Busek, Lunachek, ministra të punëve të jashtme të vendeve të ndryshme, ministrat tanë, të cilët japin kontribut të madh në këtë pjesë. Është shumë e rëndësishme që të bëhet një dialog i mirëfillt mes pjesës politikëbërëse dhe shoqërisë, kurse universiteti ynë shërben si urë lidhëse dhe është vendi ku debatohet, prandaj kjo na nderon, por edhe na jep përgje-

gjësi për krijimin e forumeve të mëtutjeshme.

UBT News: Profesor Hajrizi, sot ka filluar semestri i dytë i vitit akademik 2015/2016, çka u sugjeroni studentëve, profesorëve dhe të gjithë të angazhuarve të tjerë Brenda UBT-së?

Hajrizi: Ideja jonë është që të bazohemi në cilësi e saktësi të të gjithë kuadrit, të tregojmë se përmes një studimi cilësor mund të arrihen rezultate të mira në jetë, mund të ndërtohet karrierë, vende pune, mund të ndihmohet shoqëria etj. Përgjegjësia e studentit është që të studiojë seriozisht, të shtrojë pyetje, t'i marrë informacionet e duhura, të jetë proaktiv, të marrë pjesë në ligjëratat e të punojë projekte. Kurse, përgjegjësia më e madhe bie mbi stafin akademik i UBT-së, në mënyrë që t'i ndihmojë studentëve të rinj që kanë nevojë më së shumti për orientim profesional, të bazuar në argumentet dhe praktikën më të mira. Ky angazhim po vazhdon nga ky grup i ekspertëve që tash jemi mbi 400 dhe punojmë me më tepër se 9000 studentë. Në këtë mënyrë po krijohet një sistem dhe bashkëpunim interesant, me një potencial pozitiv për zhvillimin e Kosovës. Prandaj, kjo është një ndjenjë e përgjegjësisë për të ndihmuar dhe për të ecur përpara, pra në bazë të këtyre rezultateve. Perspektiva jonë është shumë e mirë dhe duhet të falënderojmë të gjithë ata që po kontribuojnë në këtë aspekt.

UBT News: A keni shtuar dhe a ka nevojë UBT-ja për përforsim me staf të ri?

Hajrizi: Ne çdoherë po kemi rritje të numrit të studentëve, rritje të programit të studimeve rritje të infrastrukturës dhe kryesorja është rritja cilësore e stafit akademik. UBT-ja ka punuar shumë për t'i ngritur kuadrot tona, duke i dërguar në universitetet partnere për të doktoruar, për të marrë përvoja ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë të ecim përpara. Neve çdoherë na duhen kadro me përvoja të reja, sepse është një sfidë permanente intelektuale që studentit dhe shoqërisë t'i ofrohen të arriturat e fundit. Ne po ashtu kemi një element të veçantë, ndërkombëtarizimin. Kryesisht, 20-30 për qind e programit të UBT-së, mbështetet me staf ndërkombëtar, në mënyrë që të ruhet ndërkombëtariteti. Ne kemi edhe programe që mbahen tërësisht në gjuhën angleze dhe ky është një element i fortë i UBT-së, për të ndërlidhur dhe bartur dijen dhe teknologjinë e fundit deri tek studentët në Kosovë.

UBT News: A do të zgjeroheni me programe të reja, përfshirë këtu edhe me ngritjen e nivelit të studimeve, deri në doktorata, pasi që Kolegji UBT, tashmë ka një përvojë akademike 15-vjeçare.

Hajrizi: Ne kemi aplikuar për akreditim për studime të dokto-

ratës dhe presim që të formohet komisioni për vlerësim. Jemi pjekur pas një kohe të gjatë të veprimtarisë dhe në bazë të zhvillimit të kuadrove, kjo duhet patjetër të ndodhë. Studimet e doktoratës janë vende ku gjenerohet dije e re dhe është një funksion i domosdoshëm për institucionet e arsimit të lartë. Në anën tjetër, jemi duke u munduar të jemi fleksibilë dhe proaktivë për krijimin e programeve të reja, për të cilat ka nevojë tregu i punës në Kosovë. UBT-ja gjithmonë ka pasur një lidhje të ngushtë me tregun e punës, prandaj, ne kemi vënë theks të veçantë tek nevoja për studime në fusha të reja, si: shëndetësia, bujqësia, ushqimi etj. Pra, fusha që për neve kanë prioritet për faktin se Kosova dhe bota kanë nevojë për kadro të reja. Ndërsa, për sa i përket shkencave teknologjike, ne jemi fokusuar mjaft shumë, por do të fokusohemi akoma më tepër. Mendoj se në UBT ka elemente edhe për zhvillimin e shkencave humane, prandaj do të ketë programe të reja në këtë fushë, të cilat ne do t'i ofrojmë në kuadër të universitetit tonë.

UBT News: Sivjet UBT-ja shënon 15 vjetorin e themelimit, çka nënkupton kjo në një shtet si Kosova, që ende vazhdon të përballet me problemet e tranzicionit?

Hajrizi: 15 vjet të UBT-së janë një rrëfim i suksesit dhe zhvillimit permanent të një institucioni i cili ka filluar prej zeros. Ne kemi filluar në vitin 2001, kurse në vitin 2015 kemi shënuar një përparim të madh. Rezultati më së miri shihet tek fakti që 400 njerëz, përbëjnë stafin akademik, aktualisht UBT-ja ka mbi 9000 studentë dhe është i pranuar për ekselencë, pra është model i ekselencës në aspektin e cilësisë dhe njihet nga qindra universitete e partnere ndërkombëtare.

Ne po ashtu kemi pasur ndikim në zhvillimin ekonomik e shoqëror, e kemi luajtur rol pozitiv si ambasadorë të Kosovës, kemi gjeneruar zhvillime dhe rezultate dhe e kemi thyer paragjykimin që në vendet në tranzicion, siç është Kosova, zhvillime të tilla nuk mund të bëhen. Studentët tanë e kanë zënë vendin e parë në robotikë, kemi hapur programe të reja që për herë të parë janë shfaqur në regjion, kemi zhvilluar gara të ndryshme, kemi hapur shkollën e parë të informatikës në tërë Ballkanin, pastaj edhe shkollën e arkitekturës, shkollën e biznesit, e kështu me radhë.

UBT-ja është pikë reference pozitive dhe është shembull i liderit në aspektin e arsimit të lartë në regjionin e Ballkanit Perëndimor, e tërë këto arritje janë bërë në sajë të angazhimit dhe punës së stafit, por edhe studentëve të mirë, të sjellshëm, të interesuar për studime, e me vlera dhe kjo na ka ndihmuar shumë që të arrijmë këtu ku jemi sot.

Prof.dr. Edmond Hajrizi: “UBT-ja është pikë reference pozitive dhe është shembull i liderit në aspektin e arsimit të lartë në regjionin e Ballkanit Perëndimor”



NGA KONFERENCA "DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E INTEGRIMEVE EVROPIANE"



"Pyetja është se, jo vetëm çka duhet t'i sjellë Evropa Kosovës, por edhe çfarë mund t'ia ofrojë Kosova Evropës": Erhard Busek



"Austria historikisht e ka përkrahur Kosovën": Pjesëmarrës të konferencës "Dita austriake-kosovare e integritimeve evropiane"

BUSEK POROSIT NGA UBT: KOSOVARËT TË JAPIN SHEMBUJ PËR INTEGRIM NË BE

"Duhet të keni bashkim, ashtu siç ishit të bashkuar për pavarësinë e Kosovës. Nuk duhet të mjaftoheni me historinë, me dhunën e Milosheviqit, por me zhvillimin. Ju duhet të promovoni vendin tuaj me turizëm, trashëgimi kulturore, të vetëmonitoroheni, të bëni më shumë punë, të bëni universitete cilësore për t'i përgatitur gjenerata me edukim, me hulumtime për integritime evropiane etj.," theksoi Erhard Busek

Erhard Busek, ish-zëvendëskancelar i Austrisë, diplomat i mirënjohur evropian, i angazhuar shumë rreth çështjes së Kosovës, njëherësh koordinatori i Iniciativës për Bashkëpunim Juglindor (SECI), në konferencën njëditore: "Dita austriake-kosovare e integritimeve evropiane", organizuar nga UBT-ja dhe Shoqata austriake-kosovare, ka porositur kosovarët që të japin shembuj më praktikë, që të jenë pjesë e integruar brenda BE-së.

Ai, duke u bazuar në gjendjen aktuale në Kosovë, theksoi se edhe Austria pas Luftës së Dytë Botërore, kur po krijohej nga një monarki, kishte probleme dhe ishte afër luftës civile. "Atëherë kishte përplasje të konsiderueshme njëri me tjetrin, por ishte arritur që të mos ndodhte luftë civile, që do të ishte fundi i Austrisë", saktësoi ai, teksa jepte mesazhin se edhe kosovarët duhet të merren vesh.

"Nëse nuk do të merreshim vesh nuk do të shkonim përpara. Kishte diferenca të thella, por kishte qasje për kompromis", shtoi ai dhe porositi që, pavarësisht diferencave dhe mospajtimeve të brendshme, duhet bashkëpunuar për të mirën e Kosovës.

"Duhet të keni bashkim, ashtu siç ishit të bashkuar për pavarësinë e Kosovës. Nuk duhet të mjaftoheni me historinë, me

dhunën e Milosheviqit, por me zhvillimin. Ju duhet të promovoni vendin tuaj me turizëm, trashëgimi kulturore, të vetëmonitoroheni, të bëni më shumë punë, të bëni universitete cilësore për t'i përgatitur gjenerata me edukim, me hulumtime për integritime evropiane etj.," theksoi ai.

Në këtë rrafsh ai e ka ladhur UBT-në, si një institucion akademik, që sipas tij, nëpërmjet formave të edukimit po bënë përpjekje të mëdha integrimi. Ndryshe, ka thënë ai, nuk jetohej me historinë, aq më tepër tashti kur Evropa është në fazë kritike, deri në shkapërderdhje.

"Dikush po thotë se po rritet nacionalizmi, por unë po them se nuk ka nacionalizëm, por ka egoizëm", vuri në pah ai dhe shtoi se Evropa ka probleme refugjatësh dhe se secili mundohet të mbrojë vetveten.

Busek tha gjithashtu se Austria e Kosova janë që të dyja të vogla dhe se varen nga globalizimi. "Pyetja është se, jo vetëm çka duhet t'i sjellë Evropa Kosovës, por edhe çfarë mund t'ia ofrojë Kosova Evropës", vijoi ai. Në këtë drejtim, ai tha se kosovarët duhet të jenë të vetëdijshëm se pakkush e njeh Kosovën në Evropë, se pesë shtete ende s'e kanë njohur atë. Në tërësi, Busek tha për Evropën se nuk ka diamante, ar e argjend, por e ka trurin. Duke folur për

trurin tha se UBT është në rrugë të mirë. "UBT është e ardhme e kontinentit tonë", vijoi ai, teksa pas UBT-së ka shkuar në takim me presidenten e vendit, Atifete Jahjagën.

Vetë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ndërkaq, ka folur për hapat pozitivë që Kosova i ka arritur në fushën e arsimit-edukimit gjatë 15 vjetëve të fundit, aq sa është jetëgjatësia edhe e UBT-së. Ai theksoi se Kosova po shkon drejt normalitetit në këtë fushë, se i ka 120 mijë studentë të regjistruar në 450 programe. "Kjo është mesatare e mirë", shtoi ai, ndërsa u shpreh se UBT-ja në fokus ka internacionalizimin e Kosovës dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Tregoi se është i vetëdijshëm se duhet shtuar cilësinë. "UBT është shumë aktiv në edukim, porse është i interesuar që Kosovën ta shohë anëtarë të plotë të Sistemit të Bolonjës. Po provojmë që sektorin e edukimit ta bëjmë pjesë të organizatave në rrjetet e ndryshme, shkencë e politikë, ndaj besoj që Kosova ka gjëra interesante dhe do t'i nxjerrim në sipërfaqe, si në fushën e edukimit evropiane, ashtu edhe në fushën e industrisë", u shpreh ai.

Fjalë të mira për miqësinë e Austrisë me Kosovën, në veçanti me Erhard Buskeun, ka folur zëvendësministri në Minis-

trinë e Integritimeve, Ramadani Ilazi. "Austria historikisht e ka përkrahur Kosovën", nënvizoi ai dhe konstatoi se Kosova është projekt paqësor, i cili do përforcuar tutje. Ilazi ka folur edhe për liberalizimin e vizave, që sipas tij, nuk është e mirë vetëm për Kosovën si përfituese reale, por edhe për Evropën. Sipas tij, Kosova i ka përmbushur kriteret, por po pret që në prill të vërtetohet një gjë e tillë nga komisionet përkatëse. Ilazi ftoi opozitën që të jetë pjesë e procesit.

Deputeti i Parlamentit të Kosovës, nga radhët e opozitës, Ilir Deda, tha se integritime evropiane është fjalë e ëmbël, porse sipas tij arrihet vetëm me angazhim. Ai kryesisht kritikoi institucionet publike, ndërsa arritjet ia adresoi sektorit privat. Deda tha se dialogu i brendshëm është vlerë politike, ndërsa për hapat pozitivë të zhvillimit të sektorit privat zuri ngoje UBT-në, pastaj Prizrenin si organizator të festivaleve ndërkombëtare, aktrimin që shkoi deri në OSCAR etj. Ai shfaqti shpresën se në tetë vitet e ardhshme Kosova do jetë shumë më mirë.

Në kuadër të miqësisë Kosovë-Austri, Karoline Jaoger - Klein, ligjëruese në Vjenë, ka shpjeguar për UNESCO-n, për dështimin e anëtarësimit të Kosovës vitin e kaluar, për anë-

tarësimin e Austrisë në këtë organizatë, menjëherë pas themelimit etj.

"Kosova ka provuar të hyjë në UNESCO në vitin 2015, por ju duhet të keni politikë kombëtare për ta listuar trashëgiminë kulturore. Lista është instrumenti më i mirë, kurse Kosova duhet familjarizuar me të", tha ajo. Nëpërmjet monitorit e ka paraqitur listën e disa objekteve të trashëgimisë kulturore, por është shprehur se duhet të ketë edhe shumë të tjera. Ka thënë se në këtë rrafsh duhet të ketë konsensus edhe me Serbinë.

"Nëse ju emërtoni diçka në listën e trashëgimisë dhe ekspertiza evropiane interesohet për të, atëherë do të jetë më mirë. Dëshiroj që Kosova të jetë në UNESCO, mirëpo për këtë duhet më shumë punë", vijoi ajo dhe shfaqti shpresën se më 2017 Kosova do të anëtarësohet në këtë organizatë.

"Kemi bashkëpunim shumë të mirë me UBT dhe do të ndihmojmë në këtë plan", tha ndër të tjera ajo.

Sharmin përmbajtjesor ia ka dhënë kësaj konference, Gynter Feflinger, kryetar i shoqatës Austriake-Kosovare dhe udhëheqës i fushatës "Po për Kosovën", i cili vazhdimisht ka shfaqur idetë e tij për zhvillimet integruuese të Kosovës.

NË KUADËR TË JAVËS SË NDËRMARRËSISË

STUDENTËT E UBT-SË PREZANTUAN 17 BIZNES-PLANE

“Është kënaqësi që të kemi mundësi të motivohemi nga studentët tanë. Kjo fushë gjeneron pozitivitet, rritje, kreativitet që shkon në ndikim të zgjerimit të përgjithshëm të dijes në ndërmarrësi dhe inovacion”, u shpreh rektori Hajrizi në ceremoninë e prezantimit të biznes-planeve

Mbi 65 studentët të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi të UBT-së të angazhuar në përgatitjen e biznes-planeve, në kuadër të lëndës Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësi, prezantuan sot 17 biznes-plane, në kuadër të Javës së Ndërmarrësisë.

Biznes-planet e studentëve përfshijnë tema nga më të ndryshmet, si: Kompania për riciklimin e aluminit; Fabrika për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e djathit; Prodhimi/Përpunimi i biskotave; Kultivimi i karotës; Bujtina në Bogë «Panorama»; Prodhimi i ciderit “Logrin Hard Cider”; Internet Service Provider – ISP; Serra për kultivimin e luleve; Sistemi online i parkimit; Prodhim i qarqeve elektronike; Çerdhja për fëmijë; Mbjellja dhe kultivimi i aronisë; Kultivimi i drurit Paulownia; Salt therapy; “Dardha”; Ngritja e fermës e të tjera.

Studentët e angazhuar në punimin e biznes-planeve janë: Vlora Belallari, Elona Miftaraj, Gentiana Qorri, Faton Mirena, Burim Kasrati, Fiona Prokshi, Rina Veliu, And Deva, Manuela Berisha, Valerina Colaj, Qëndresa Shabani, Tenzilla Luboteni, Hamide Zabeli, Arjeta Mehmeti, Edona Kullashi, Marigona Nikçi, Gent Sefa, Faton Jashari, Donjeta Gashi, Florenta Fetoshi, Jonida Xhema, Krenar Çeku, Rilind Beqaj, Agon Hysaj, Benita Syla, Mirjeta Syla, Fjolla Hisari, Flakadon Osmani, Ejup Lahu, Nuha Hasani, Halil Berisha, Visar Maxhuni, Samir Shala, Roni Kasemi, Jeton Mullarama, Art Berisha, Imri Jezerci, Drilon Shala, Endrit Hoxha, Albin Hasaj, Driton Jashanica, Albana Popova, Arbana Prelvukaj, Egzona Morina, Granit Hajrizi, Premtim Zejnullahu, Afije Gashi, Dhurata Azemi, Xhejlane Imeri, Merita Dabinovci, Vjosa Cena, Fitim Luma, Reis Sallova, Blerim Llugini, Mustafë Salihu, Donat Polloshka, Gent Shkoda, Drilon Selmani, Myekked Konstantini, Lendita Kadriu, Anesa Koprani e Lumir Krasniqi.

Në ceremoninë e prezantimit të biznes-planeve morën pjesë përfaqësues të institucioneve, përfshirë, zonjën Besa Zogaj, zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Republikës së Kosovës, profesorë, studentë e mysafirë të tjerë. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi u shpreh i kënaqur që UBT-ja çdo ditë e më shumë me nisma të ndryshme po krijon mundësi për studentët që të tregojnë dijen dhe punën e tyre hulumtuese.



Biznes-planet e studentëve përfshijnë tema nga më të ndryshmet, si: Kompania për riciklimin e aluminit; Fabrika për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e djathit; Prodhimi/Përpunimi i biskotave; Kultivimi i karotës; Bujtina në Bogë "Panorama"; Prodhimi i ciderit "Logrin Hard Cider"; Internet Service Provider – ISP; Serra për kultivimin e luleve; Sistemi online i parkimit; Prodhim i qarqeve elektronike; Çerdhja për fëmijë; Mbjellja dhe kultivimi i aronisë; Kultivimi i drurit Paulownia; Salt therapy; "Dardha"; Ngritja e fermës e të tjera.

“Është kënaqësi që të kemi mundësi të motivohemi nga studentët tanë. Kjo fushë gjeneron pozitivitet, rritje, kreativitet që shkon në ndikim të zgjerimit të përgjithshëm të dijes në ndërmarrësi dhe inovacion”, u shpreh dr. Hajrizi.

Ai më tutje vazhdoi se ideja e ndërmarrësisë është që të ngritet kultura, që të ketë qasje sa më të madhe të individit, për të bërë diçka të re, një qasje e cila gjeneron rritje e zhvillim. Ndërmarrësi është potencial i madh dhe faktori kryesor të ecim përpara, tha Hajrizi. Ai përmendi krijimin e inkubatorit universitar që ka pasur mbështetje nga ndërkombëtarët si dhe inkubatorit virtual të Kosovës, që është i pari në vend e në rajon, një projekt që është i mbështetur nga SHBA, si dhe shumë nisma të tjera, që kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të hulumtimit dhe punës shkencore dhe u kanë dhënë mbështetje studentëve për jetësimin e ideve të tyre. Besa Zogaj, zëvendësministre në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, tha se për të është shumë privilegj të jetë në këtë vend të rëndësishëm, para

studentëve të dalluar që prezantojnë idetë e tyre.

Ajo shtoi se sektori privat është promotori kryesor i zhvillimit ekonomik, është shtyllë e parë e programit qeveritar 2015-2018.

Duke përmendur disa nga nismat e ekzekutivit të vendit për përkrahjen e ndërmarrësisë, ajo përmendi pakon e re fiskale, që ka ndikuar dhe janë duke u vërejtur përparësitë e të bërit biznes, si dhe fondin për garantime në vlerë 18 mijë euro, imbeshtetur nga USAID dhe Komisioni Evropian, që ka për qëllim të promovojë sektorin privat dhe bizneset që udhëhiqen nga femrat dhe në zona rurale.

Dr. Ylber Limani, dekani i Fakultetit të Menaxhment, Biznesit dhe Ekonomisë, tha se Java e ndërmarrësisë, në kuadër të së cilës po bëhen prezantimet, është pasqyrimi i punës dhe dijes që kanë mbledhur studentët gjatë pesë semestrave të studimeve. “Ky është moment që ju do ta krijoni një biznes-plan, që do të jetë një trokitje në derë të bizneseve të reja për të krijuar diçka të re”, tha dr. Limani. Sipas tij, nuk është e lehtë që studentët të jenë ndër-

marrës e për ta arritur këtë duhet të veprojnë më shpejt, të arrijnë në qëllimin që e kanë synuar këta biznesmenë të rinj.

Ndërsa, Armend Muja, ligjërues i lëndës Menaxhimi strategjik i ndërmarrësisë, në kuadër të së cilës janë përgatitur biznes-planet, tha se për UBT-në është shumë e rëndësishme qasja strukturore si institucion dhe mbështetja e studentëve për hartimin e të gjitha planeve.

Organizimi në fushën e biznes-planeve dhe prezantimi i tyre ka qenë pikë kyçe për drejtimin e Biznesit në UBT, shtoi Muja.

Ai përmendi disa aspekte në krijimin e një biznes-plani të një studenti fillestar, duke theksuar se aspekti i parë është qasja në financa, aspekti i dytë sistemi arsimor – kontribut që në edukimin fillor ai të mësohet të bëjë biznes, aspekti i tretë barriera e biznesit, femrat kosovare të zonjat dhe të suksesshme në biznes, si dhe aspekti i katërt, që është aspekti individual.

Z. Muja tha se në këtë lëndë çdo vit studentët me ide inovative kanë hartuar biznes-plane dhe i kanë prezantuar.

Sipas tij, Kosova ka nevojë që të ketë njohuri të reja rreth kësaj fushe, ndërsa përmendi edhe përkrahjen e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, e cila e ka mbështetur UBT-në në realizimin e shumë projekteve të rëndësishme.

Në ceremoninë e sotme morën pjesë edhe studentët që kanë përfunduar studimet në UBT, e që tani janë ndërmarrës të suksesshëm. Një ndër ta është Florian Piraj, që ka kryer në UBT studimet në drejtimin Menaxhim i Mekanikës dhe Inxhinieri. Ai tha se falë UBT-së dhe kushteve që i janë ofruar, ai sot është një ndërmarrës i ri, që ka krijuar një kompani, që është kompania e parë e llojit të tillë në Kosovë dhe në rajon që prodhon printerë personalë 3D. I

Edhe Bujar Statovci, që ka studiuar në Fakultetin e Arkitekturës, tani ka një zyrë për krijimin e ideve të reja në ndërmarrësi. Rrugëtimi i tij ka nisur me hapjen e inkubatorit të UBT-së në vitin e kaluar, ku është zgjedhur për ide inovative. Ideja e projektit ka qenë krijimi i ndërtesave të lëvizshme, që është produkt inovativ në tregun rajonal.

Albina Zeneli

EKSPERTË KOSOVARË DHE AUSTRIKË DISKUTOJNË PËR STREHIMIN NË KOSOVË

KOSOVA PËRBALLET ME PROBLEME TË THEKSUARA NË FUSHËN E STREHIMIT



“Kemi kaluar procesin e integritimit, por gjendja e banimit social në Kosovë është e rëndë, edhe pse është punuar mjaft edhe në legjislacion”, tha Merita Dalipi nga Ministria e Planifikimit Hapësinor

Në organizim të UBT-së, Shoqatës austriake-kosovare dhe OJQ për strehim social dhe të drejta pronësore në Kosovë, u mbajt konferenca me titull “Dita austriake-kosovare e strehimit social”, në të cilën, si edhe në të gjitha konferencat e mëparshme, pati referues nga Kosova dhe nga Austria.

Konferencën e hapi Prof. Dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, i cili foli për rëndësinë e madhe që ka ky projekt për popullatën, e sidomos për ata me nevojë të banimit. Ndër të tjera, ai theksoi bashkëpunimin që ka UBT me këto organizma si nga Austria po ashtu edhe nga Kosova. “E mira e krejt kësaj është ndërtimi i Kosovës, dhe këtu po bëhet mjaft rreth saj.

Katër kandidatë certifikohen për ciceronë turistike

Në UBT dje u organizua ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve të trajnimit për ciceronë (guida) turistike, në të cilën certifikatat iu dhanë Shukrane Begut, Egzona Azemit, Shaban Latifit dhe Avdi Mehmetit.

Trajnimi, i cili përfshiu gjithsej 96 orë, të ndara në 10 module, u organizua në bashkëpunim me Cultural Heritage Without Borders (CHWB).

UBT ka licencën për të certifikuar administratorët për administrimin e objekteve publike kolektive”, tha Dr. Hajrizi.

Pas tij, fjalën e mori Merita Dalipi, përfaqësuese e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, e cila po ashtu u përqendrua në rëndësinë e zhvillimit të projektit për banim social. Sipas saj, Kosova ka kaluar procesin e integritimit. “Kemi kaluar procesin e integritimit, por gjendja e banimit social në Kosovë është e rëndë, edhe pse është punuar mjaft edhe në legjislacion”, tha znj. Dalipi.

Murat Hoxha, përfaqësues i gjeodetëve të Kosovës, u përqendrua te prona si aset i rëndësishëm i hipotekimit dhe i zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Wolfgang Amann, profesori asociuar nga Austria, foli për përvojat austriake të strehimit social, duke paraqitur në formë tabelare edhe angazhimin e shteteve të tjera evropiane. Ai rekomandoi edhe kosovarët se si mund të zhvillojnë këtë aspekt, duke u ndalur te fokusimi te familjet me nevojë. “Austria ka pasur një projekt që i ka zgjatur 20 vjet dhe ka investuar në 12 shtete”, tha ai. Më tej ai u angazhua në rekomandimin se si do të duhej të zhvillohej ky projekt në Kosovë. “Për të pasur sukses do të duhej fokusuar në sasinë e banimit, provizionit, cilësisë së ndërtimit, zhvillimit urban, integritimi social,

etj.”, tha z. Amann. Mentor Hoxha, anëtar i sistemit për pronën kadastrale në Kosovë, u përqendrua në privatësinë pronësore, duke u ndalur te problemet që paraqiten ose janë paraqitur këtu te ne, meqë Kosova është një shtet i ri, dhe, si shtet i ri, normalisht, që përballet me probleme të mëdha në fushën e kadastrës dhe shkeljen e privatësisë së qytetarëve. Problem tjetër, sipas tij, është edhe shitja e pronave më tepër se një herë, si rezultat i mosnjohurive të përkatësisë pronësore. Megjithatë, ai u shpreh optimist, që edhe në vendin tonë do të ndryshojnë gjërat shumë shpejt, pasi që zhvillimi teknologjik e ka bërë të vetën.

“Jemi duke jetuar në një formë të Big Brother-it, ku satelitët na vëzhgojnë gjatë tërë kohës, pastaj është edhe Google Map, që e di saktë se ku jemi e çka posedojmë”, u shpreh z. Hoxha.

Ai theksoi se sfidë tjetër për shtetin e ri të Kosovës është liria e informacionit, dhe e cila, do të vazhdojë deri në përfundimin e kornizës ligjore, sepse nuk ka mbikëqyrje efektive për marrjen e masave, në rastet kur privatësia e ndonjë qytetari thyhet. Krejt në fund, ai theksoi se ata janë pro transparencës së të dhënave kadastrale dhe pro modelit austriak.

Përfaqësuesi i OJQ-së, Agron Beka, tregoi se modeli i banimit social e ka historikun e krijimit

në Angli dhe që ata janë munduar t’i japim një formë edhe në vendin tonë. Sipas tij, problem për udhëheqësit tanë është se ata nuk e kuptojnë qartë rolin e banimit social, pra, nuk e dinë se një shërbim i tillë, a është ndihmë që i jepet qytetarëve apo obligim ligjor. “Banimi social është i rregulluar me ligj dhe si i tillë është edhe obligim ligjor”, tha z. Beka. Tutje ai sqaroi se qeveria dhe organizatat e ndryshme joqeveritare, prej vitit 2005 deri më 2015 kanë ndërtuar rreth 1460 shtëpi për këtë qëllim, kurse shumica e tyre janë ndërtuar për komunitetin serb, e që janë të zbrazura, sepse ata kanë vendosur të kthehen në Serbi apo edhe vende të tjera. Ai përmendi edhe një projekt tejet të rëndësishëm, “Strehedhe ti”, qëllimi i të cilit është strehimi i mbi 100 familjeve, që kanë nevojë për strehim gjatë muajve të dimrit. Një projekt i tillë e ka jetësuar OJQ-ja, në bashkëpunim me Kolegjin UBT, bashkardhetarët, si dhe bizneset private e publike, kurse kryetari i bordit është rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi.

Në kuadër të kësaj konference, fjalim mbajti edhe ekspertja për administrimin e strehimit social, Zana Tabaku. Ajo tha në vitin e kaluar është lansuar sistemi për regjistrimin e personave, që kanë nevojë për strehim, si dhe vendosja e tyre nëpër banesa e shtëpi strehimi. Sistemi përfshin pagesat

Konferencën e hapi Prof. Dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, i cili foli për rëndësinë e madhe që ka ky projekt për popullatën, e sidomos për ata me nevojë të banimit. Ndër të tjera, ai theksoi bashkëpunimin që ka UBT me këto organizma si nga Austria po ashtu edhe nga Kosova. “E mira e krejt kësaj është ndërtimi i Kosovës, dhe këtu po bëhet mjaft rreth saj. UBT ka licencën për të certifikuar administratorët për administrimin e objekteve publike kolektive”, tha dr. Hajrizi

e qiramarrësve e qiradhënësve, si dhe hartat se ku ndodhen vendet strehuese. Në fund, ajo shprehu edhe gatishmërinë për të sqaruar ecurinë se si funksionon i tërë ky sistem për të interesuarit.

Shkumbin Asllanit theksoi se UBT-ja ka themeluar qendrën për studime shkencore, që gjendet në kuadër të Fakultetit Juridik. Ai tregoi në mënyrë të detajuar krijimin e analizës ligjore për legjislacionin ligjor, që ka për qëllim analizimin e ligjeve e mangësive të tyre, dhe kërkoi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ta shqyrtojë përmbytjen e ligjeve për sa i përket strehimit social. Asllani theksoi se gjatë analizës do të rishikohen çështjet e strehimit social dhe do jepen rekomandime se si mund të rregullohet ky problem nga qeveria. “Analiza ligjore për legjislacionin pronësor është shumë e rëndësishme, sepse që nga paslufta nuk janë bërë studime dhe rekomandime të këtij niveli”, u shpreh ai.

Konferenca u mbyll me fjalimin e Ramë Hamzës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili tha se ata janë ndër shpenzuesit më të mëdhenj të buxhetit të Kosovës, pasi që harxhojnë rreth 18 për qind të buxhetit të Republikës së Kosovës. Tutje, ai sqaroi se ministria ka ngritur disa objekte të strehimit social nëpër qytete të ndryshme dhe për komunitete të ndryshme. “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është diçka e shenjtë, sepse ka marrë një mision të shenjtë”, tha ai. Ai tregoi se ata janë përgjegjës për ushqimin e familjeve në kushte të vështira, por jo, edhe për strehimin e tyre, sepse, sipas tij, kjo tashmë ka kaluar në kuadër të pushtetit lokal të komunave. Por, edhe përkundër kësaj, ai u shpreh se kjo ministri do të vazhdojë të ndihmojë dhe të japë kontribut në zgjidhjen dhe përbalimin e këtij problemi.

Fatbardhë Kiqina



Rektori Hajrizi mori pjesë në debatin për rolin e statistikave

Rektori i UBT-së, prof. Dr. Edmond Hajrizi, që njëkohësisht është edhe Kryetar i Këshillit të Statistikave, mori pjesë në një diskutim rreth rëndësisë së statistikave, të organizuar nga Ambasada e Suedisë, Agjencia e Statistikave e Kosovës dhe Agjencia e Suedisë për Bashkëpunim dhe Statistika.

Në diskutim morën pjesë edhe Pernilla Trägårdh, drejtor i Agjencisë Ndërkombëtare Bashkëpunim dhe Statistika të Suedisë, Thomas Kjellson, nga

po kjo agjenci, Isa Krasniqi, kryeshef ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Stefan Lundgren, Drejtori i Përgjithshëm në Statistikat e Suedisë dhe diskutues të tjerë.

Në diskutim u trajtuan çështje të ndryshme të rolit dhe rëndësisë së statistikave në vendin tonë, me theks të veçantë në mundësinë që në këtë fushë të përfitohet nga përvoja suedeze, institucione të cilat vend kanë ofruar ndihmën dhe përvojën e tyre të pakursyer.

STUDENTËT E UBT-SË VIZITUAN KOMPANINË "DELOITTE"



Përfaqësues nga Qendra e Karrierës dhe studentët të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT vizituan kompaninë "Deloitte" dhe morën pjesë në prezantimin e gjetjeve të studimit "Liderët e së Ardhmes - Hapat e Parë në Tregun e Punës".

Ata morën pjesë aktive në debatin e organizuar me këtë rast, duke dëshmuar dije dhe interesim të lartë rreth temës së trajtuar. Pas prezantimit, studentët vizituan edhe zyrat e kompanisë "Deloitte" për të parë nga afër se si zhvillohet puna në këtë kompani.

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE "SIGURIA KIBERNETIKE DHE PRIVATËSIA"



"UBT ka të akredituar në studimet master në programin Siguria e Informacionit dhe Privatësia, që është programi i parë i akredituar në këtë fushë jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, si dhe shumë drejtime të tjera të studimit, si Shkencat kompjuterike, Sistemet e Informacionit", tha rektori Edmond Hajrizi

REKTORI HAJRIZI PREZANTON AKTIVITETET E QENDRËS SË UBT-SË PËR SIGURI KIBERNETIKE

UBT ishte partneri organizativ i konferencës, në të cilën morën pjesë profesorë dhe studentë të shumtë të UBT-së dhe ku prezantimi i punës së Qendrës së UBT-së për Siguri Kibernetike u prit me mjaft interes nga pjesëmarrësit e shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë

Aktiviteti i Qendrës së UBT-së për Siguri Kibernetike dhe kontributi i saj në krijimin e kuadrove të reja në fushën e sigurisë dhe të privatësisë, ka qenë fokusi i fjalës së rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi në konferencën ndërkombëtare "Siguria Kibernetike dhe Privatësia", organizuar nën patronazhin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Njësitin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit (ILEK) të Policisë së Kosovës, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës e organizata të tjera.

UBT ishte partneri organizativ i konferencës, në të cilën morën pjesë profesorë dhe studentë të shumtë të UBT-së dhe ku prezantimi i punës së Qendrës së UBT-së për Siguri Kibernetike u prit me mjaft interes nga pjesëmarrësit e shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Para pjesëmarrësve në konferencë, rektori Hajrizi tha kjo qendër shërben tashmë si pikë referencë për zhvillimin e diskutimeve në këtë fushë dhe për dhënien e këshillave për të gjitha institucionet e interesuara dhe në të gjitha nivelet.

Ai përkujtoi se UBT ka zhvilluar aktivitete të hershme në fushën e sigurisë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me universitetet ndërkombëtare, që ka rezultuar me një përvojë dhe hulumtim me shumë interes.

UBT ka të akredituar në studimet master në programin Siguria e Informacionit dhe Privatësia, që është programi i parë i akredituar në këtë fushë jo vetëm në Kosovë,

por edhe më gjerë, si dhe shumë drejtime të tjera të studimit, si Shkencat kompjuterike, Sistemet e Informacionit. Nisur nga kjo, ekziston një bazë e mirë që të krijojmë disa kuadro në këtë fushë. UBT ka edhe laboratorët në kuadër të Kampusit Inovativ të UBT-së, ku ka një grup të pajisjeve dhe një hapësirë shumë të mirë për hulumtime në këtë fushë.

Gjithashtu studentët e UBT-së janë dalluar në shumë aktivitete në fushën e sigurisë dhe privatësisë, si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në fjalën e tij, tha se në vitin 2015 është hartuar Strategjia kombëtare për rritjen e sigurisë kibernetike. Ai theksoi se kjo fushë kërkon ekspertë të përgatitur, në mënyrë që të mbrohen institucionet financiare nga këto krime.

"Nëpërmjet promovimit të kësaj fushe, Teknologjinë Informative do ta bëjmë njëri nga fushat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik. Këtë e shohim edhe në ekonomitë e vendeve më të zhvilluara. Është njëra nga temat kryesore të ekonomisë dhe sot po bën që të ndryshojë struktura e ekonomisë, që të ndryshojnë dhe të transformohen proceset e ndryshme në kuadër të gjithë sektorëve të ekonomisë", tha ai.

Stavileci ka rikujtuar se në funksion të zhvillimit të këtij sektori, është dhënë në shfrytëzim një objekt në Gërmi, i cili do të shërbejë si bëjë inkubator i biznesit për fushën e TIK-ut. "Në të ardhmen, ai potencialisht mund të shndërrohet në një park teknologjik".

Kreu i MZHE-së, më tej, theksoi se në bashkëpunim me Bankën

Botërore po punojnë për zhvillimin e një të ashtuquajturës "Ekonomia Digjitale e Kosovës", duke u bazuar në tri shtylla: Infrastruktura digjitale, Edukimi digjital dhe Bizneset digjitale.

Ndërsa, Bedri Hamza, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, tha se me avancimin e teknologjisë është shtuar dhe rrezikshmëria në këtë fushë.

"Çfarë ka qenë e mjaftueshme për t'u mbrojtur nga kërcënimet kibernetike në të kaluarën nuk është e mjaftueshme sot. Mbrojtja gjithnjë e më gjerë e sistemit të informacionit lidhet me interesat kriminale të individëve dhe grupeve të shumta", tha Hamza.

Ndërkaq, Agron Mustafa, drejtor i Telekomit të Kosovës, u shpreh se Telekom/Vala operon që më se 16 vjet. "Sot ku po flasim për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit, mund ta marrim me mend se çka do të kishte ndodhur potencialisht në qoftë se Telekom i Kosovës nuk do të ishte i sigurt në mbrojtjen e të gjithë informacioneve që qarkullojnë, apo kanë qarkulluar".

Sipas tij, Telekom i Kosovës me vite të tëra ka qenë pre e perceptimeve të gabuara se ka mungesë të mbrojtës së të dhënave dhe informatave që kanë kaluar aty për shkaqe të ndryshme. "Si rezultat i këtij perceptimi nuk kemi qenë edhe aq të padëmmtuar".

Kurse, Mentor Hoxhaj, kryesues i Konferencës "Siguria Kibernetike dhe Privatësia", e vlerësoi këtë si një ngjarje shumë të rëndësishme. Ai bëri të ditur se konferenca do të jetë dyditore, me panelistë të ndryshëm nga e gjitha bota. Pjesëmarrës në konferencë janë edhe rreth 30 hakerë shqiptarë.

NGA SHBA, LIBRA PËR UBT-NË

BIBLIOTEKA MJEKËSORE DHE E SHKENCAVE TË JETËS NË UBT PASUROHET ME 20 MIJË LIBRA TË RINJ

Librat u dhuruan nga kolegë tanë pedagogë dhe studentë nëpër universitete të ndryshme amerikane dhe me kontributin thelbësor të Projektit Ndërkombëtar të Librit në Leksington të Shtetit të Kentakit

Biblioteka Mjekësore dhe e Shkencave të Jetës në UBT u pasurua me më shumë se 20 mijë libra të rinj nga Shtetet e Bashkuara. Librat u dhuruan nga kolegë tanë pedagogë dhe studentë nëpër universitete të ndryshme amerikane dhe me kontributin thelbësor të Projektit Ndërkombëtar të Librit në Leksington të Shtetit të Kentakit. Nën drejtimin e dekanes së Shkolës së Infermierisë së Universitetit të Floridës së Veriut, Dr. Linda Konelli (Linda Connelly), Shoqata e Studentëve të Infermierisë të Universitetit të Floridës së Veriut (ShSI UFV) dëshiron të bëjë pjesë e këtij projekti duke mbledhur sa më shumë libra universitarë që të mundej për t'ia dërguar UBT-së në Kosovë që ky të hapë librarinë e vet të parë të programit të infermierisë. ShSI UFV-ja



ia doli të mblidhte më shumë se 1000 libra në vjeshtë të vitit 2015 dhe i nisi ata në Kosovë nëpërmjet Projektit Ndërkombëtar të Librit.

UBT-ja i mori librat dhe UFV-ja planifikon ta vazhdojë këtë partneritet duke mbledhur libra të tjerë këtë pranverë për t'i nisur ata në Kosovë përpara 1 majit.

Kjo përvojë ishte nxitëse dhe prekëse, duke na kujtuar se sa mirënjohës duhet të jemi. Në një letër dërguar UBT-së, studentët nga Florida thanë se shpresonin të kishin luajtur "një rol të vogël në ndihmën për të hapur një program të ri infermierie, duke inkurajuar kështu një ndjenjë globale

të bashkësisë në fushën e kujdesit shëndetësor".

Studentët dhe pedagogët thanë:

Aleks Ferose (Alex Feroce): Ishte nder për mua të isha pjesë e një projekti kaq të mrekullueshëm dhe ai më bëri të vlerësoj burimet që ne studentët kemi në dispozicion.

Xhes Stivens (Jess Stephens): U përmbyta nga bujaria dhe mbështetja që ofruan pedagogët e UFV-së përgjatë gjithë procesit. Ishte e mrekullueshme të shihje zhvillimin e projektit qysh prej ditës së parë dhe ndihem i prekur që isha pjesë e këtij viti të parë të dhurimit.

Dr. Linda Konelli (Linda Connelly): Duke zhvilluar projektin ndërkombëtar të librit, shpejt kuptuam se ishim shumë mbrapa me procesin e transportit. Nëpërmjet mirësisë dhe nxitjes së Z. Majkëll Trotter (Michael Trotter), Mbikqyrës për Dërgesat dhe Marrjet në UFV, projekti ynë i dha frytet me lehtësi.

Veronika (Veronica): Për mua, infermiera ndërtohet mbi dhënien dhe duke marrë pjesë në projektin ndërkombëtar të librit, ndjeva se mund të isha në gjendje të jepja në nivel global.

Enxhi Marini (Angie Marini): Unë fillova në pjesën e dytë të projektit, i cili përbëhej nga transportimi dhe grumbullimi i librave prej zyrave të profesorëve, ku ata gjendeshin. Nuk besoj të kem qenë rrethuar ndonjëherë nga kaq shumë libra mjekësorë. Duke ditur që në po i dhuronim ata për një vend në zhvillim ishte shumë prekëse dhe unë mezi pres ta vazhdoj këtë projekt në të ardhmen.



"Java e Leximit" në UBT

Qendra e Karrierës e UBT-së organizoi aktivitetin "Java e Leximit". Profesi i UBT-së dhe njëri ndër organizatorët e këtij aktiviteti, Halil Bashota tha se për organizimin e këtij aktiviteti, ata janë frymëzuar nga studentët, të cilët shkaku i provimeve janë në fazën ku lexojnë më tepër se kurrë.

Ai tha se leximi nuk duhet të merret si diçka stresuese, por si diçka relaksuese dhe shumë i rëndësishëm.

Më tutje, z. Bashota tregoi edhe për kapacitetin e bibliotekave të UBT-së, si online ashtu edhe atyre fizike. "UBT-ja është anëtare e bibliotekave online, në mënyrë që studentët të kenë qasje në librat, gazetatat dhe revistat e ndryshme, për të cilat edhe paguajmë", tha ai. Një librari e këtij lloji është EBSCO, e cila përmban rreth 50.000 libra të profesioneve të ndryshme. Bashota duke treguar mënyrën e qasjes në këtë sistem tha se librat mund të ruhen për lexim të mëvonshëm, si dhe të shkarkohen, kurse qasje mund të kenë vetëm stafi dhe studentët e UBT-së. Ai tha se në kohët e fundit është rritur interesimi i studentëve për përdorimin e librarive online si dhe atyre fizike, e kjo shihet si diçka shumë pozitive. "Leximin duhet marrë si diçka tonën dhe si shprehje se leximi e relakson trurin dhe e zgjeron dijen tonë", theksoi Bashota.



STUDENTËT E UBT-SË ME REZULTATE TË LARTA NË PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË TALENTEVE

Të gjithë studentët e UBT-së, që kanë marrë pjesë në një garë në programin e zhvillimit të talenteve dhe ndërlikjes me ndërmarrësinë, e kanë kaluar testin me rezultat dukshëm më të mirë se pragu i përcaktuar. Programi i zhvillimit të talenteve përfshin testimin e dijes sipas kriterëve

të përcaktuara, me qëllim të përzgjedhjes së studentëve më të mirë për zhvillimin e programeve të ndryshme.

Sikur edhe në shumë gara të tjera, edhe në këtë garë, studentët e UBT-së treguan dije të theksuar, duke u dalluar dukshëm nga kolegët e tyre nga institucione të tjera.

UBT jep donacion për projektin "Streho edhe ti"

UBT ka vazhduar edhe këtë vit me dhënien e ndihmës për qytetarët në nevojë. Pas një varg aktivitete në ndihmë për njerëzit që kanë nevojë për dorën e ndihmës, të ndërmarrë viteve të shkuara, sivjet UBT ka dhënë një donacion për organizatën joqeveritare "SHPRK", me seli në Prishtinë.

Donacioni i UBT-së përfshin kontributin për realizimin e projektit "Streho edhe ti", qëllimi i të cilit është strehimi i familjeve në territorin e Republikës së Kosovës.

INTERVISTË: PROF.DR. AHMAD ZARGARI, PËRFAQËSUES I UNIVERSITETIT AMERIKAN MORENEAD STATE UNIVERSITY, ME SELI NË KENTUCKY

UNIVERSITETI AMERIKAN OFRON MUNDËSI TË MËDHA PËR STUDENTËT E UBT-SË

Prof.dr. Ahmad Zargari është përfaqësues i Universitetit amerikan Morehead State University, me seli në Kentucky, njëherësh dekan në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Sistemit të Informacionit brenda këtij universiteti.

UBT News: Ju keni nënshkruar një marrëveshje me rektorin e UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, sipas së cilës studentët e UBT-së do ta kenë mundësinë për të studiuar për një semestër ose një vit në universitetin tuaj. A mund të na tregoni më tepër për këtë marrëveshje?

Profesori Ahmad: Po. Ne jemi takuar në kampus, në kampusin e Morehead-it dhe atje kemi diskutuar rreth bashkëpunimit mes Universitetit për Biznes dhe Teknologji, këtu në Prishtinë dhe Universitetit Morehead në Kentucky, për shkëmbimin e studentëve, bashkëpunimit në projekte, në projekte kërkimore, i cili do të përfshijë mundësinë e ardhjes së studentëve dhe stafit të UBT-së për të mësuar në Morehead për një semestër dhe ata të Morehead-it do të vinë këtu në UBT. Po ashtu studentët mund të na bashkohen dhe të vazhdojnë studimet e tyre në Kampusin e Morehead-it, si dhe është edhe mundësia e përfundimit të bursave nga studentët tuaj për t'i përfunduar studimet Master në Inxhinieri dhe Teknologji. Po shpresojmë që kjo marrëveshje do ta zgjerojë bashkëpunimin në nivelin tjetër, niveli i cili përfshin bashkëpunimin në projekte dhe shpresoj që me shoqatën e akreditimit të quajtur ATMAE (Association of Technology, Management, and Applied Engineering), ju do të keni mundësinë që të lidheni për sa i përket programeve të inxhinierisë dhe teknologjisë, kjo agjenci do t'ia ofroj universitetit tuaj mundësinë që të marr pjesë në konferencën e saj, do ta keni mundësinë që të bëni prezantime

atje dhe po ashtu edhe të bëni kërkime shkencore që do të publikohen në ditarin e shënimeve të universitetit tonë.

UBT News: Po ashtu, edhe studentët tuaj do të vinë këtu dhe do të studiojnë, a mund të na tregoni se kur do të filloj ky shkëmbim dhe sa studentë do të jenë pjesë e këtij shkëmbimi?

Profesori Ahmad: Patjetër, ne e kemi planifikuar këtë. Ne e kemi bërë marrëveshjen strategjike për të hapur komunikimin tonë dhe për të hapur bashkëpunimin tonë, për të arritur deri tek logjika e shkëmbimit dhe ne po punojmë në këtë drejtim. Po shpresojmë që në semestrin vjeshtor të vitit 2016 ne do t'i marrim 3,4 ose 5 studentë tuaj për t'i vazhduar studimet Master në universitetin tonë përmes bursave që ata do t'i fitojnë.

UBT News: Së bashku me rektorin prof. dr. Edmond Hajrizi, ju keni shfaqur gatishmërinë për të shkëmbyer edhe staf akademik, në ç'mënyrë do të bëhet kjo?

Profesori Ahmad: Unë kam qenë i nderuar që të takohem me rektorin e UBT-së, dr.Hajrizi dhe të flas me të në lidhje me vizionin e shkëmbimit të bursave akademike, që do të përfshijë kërkime në mes fakulteteve, pastaj mësimet në të dy kampuset, atë të Morehead-it dhe atë të UBT-së, dhe studentët do t'i bashkohen kërkimeve. Ata do t'i publikojnë rezultatet e kërkimeve të tyre dhe më pas do t'i aplikojnë ato. Jemi shumë optimistë që ne mund ta zgjerojmë nivelin e kërkimeve mes studentëve të Morehead-it dhe studentëve të UBT-së.

UBT News: A mund të na tregoni se cilat janë përshtypjet tuaja rreth UBT-së, për stafin e studentët?

Profesori Ahmad: Unë i kam vizituar klasat tuaja, kam folur me studentët tuaj, kam parë bashkëpunimin dhe çiltërsinë mes presidentit, dekanëve dhe studentëve, dhe universiteti juaj më duket shumë i përparuar. Studentët kanë laboratorë ku ata zgjidhin probleme dhe bëjnë projekte në mekatronikë, elektroteknikë e dizajn dhe kjo do t'i ndihmojë dhe do t'i shpie ata në karriera të suksesshme në teknologjinë e avancuar duke iu referuar produktit, kualitetit e disiplinës. UBT juaj më duket shumë i fokusuar dhe i angazhuar në suksesin e studentëve, dhe kjo është shumë e ngjashme me atë që ne e bëjmë për studentët tanë në kampusin tonë.

UBT News: A mendoni se gjenerata jonë është në rrugën e duhur në nivelin e arsimit?

Profesori Ahmad: Po, vizioni për të ardhmen është misioni strategjik dhe vizioni që e kam parë në praktikë është në rrugën e duhur. Inxhinieria dhe programet teknologjike po lëvizin. Programet e tjera janë apo nuk janë duke ndryshuar shumë, por inxhinieria dhe teknologjia po lëvizin shumë shpejt. Prandaj, teksa ne lëvizim tutje, nevoja e industrisë dhe kompanive po ndryshon dhe ne duhet t'i ndryshojmë programet tona po ashtu. Unë po e shoh që kjo po ndodh në kampusin tuaj, po e shoh që ju përgatisni studentë për të ardhmen dhe kjo është shumë e rëndësishme dhe kjo është çfarë ne po mundohemi

të bëjmë. Realisht, qëllimi i prezantimit tim ka të bëjë me mënyrën se si ne i përgatisim studentët për të ardhmen. Dhe unë e pashë këtë në mekatronikën që studiohet këtu, e pashë që ajo përfshin dhe kombinon elektromekanikën dhe mekanikën e dizajnit dhe është në rrugën e duhur. E pashë që studentët tuaj të shkencave kompjuterike po mësohen të përdorin softuerin dhe harduerin në të njëjtën kohë, kjo i bën ata më të kushtueshëm për tregun. Studentët që vijnë në kampusin tuaj aftësohen dhe mësojnë detajet për zgjidhjen e problemeve e kompanive dhe ata do të jenë shumë të kushtueshëm.


UBT News: Me siguri, studentët tanë duan të dinë më tepër për universitetin tuaj. A mund të na tregoni më tepër në lidhje me atë se kur është themeluar dhe informacione tjera të përgjithshme për të?

Profesori Ahmad: Po. Ne jemi të vendosur në një vend shumë të bukur në shtetin e Kentucky-it, konkretisht në një qytet shumë të sigurt, në Morehead. Ne jemi 60 milje larg nga Kentucky-yt dhe 90 milje larg nga Ohajo, pra gjendemi në mes të qyteteve të mëdha dhe krenohemi për shumë gjëra. Ne jemi përzgjedhur për 12 vite rresht si një ndër universitetet më të mira të tipit tonë në SHBA. Po ashtu jemi të akredituar nga agjenci të shumta të akreditimit dhe e kemi mbajtur primatin që nga fillimi. Ne po ashtu jemi të specializuar në shumë drejtime, sidomos në ato të inxhinierisë. Studentët tanë i njohin profesorët e tyre dhe profesorët e njohin se-

cilin student të tyre përmes emrit, njësoj sikurse edhe ju. Gjithashtu, universiteti ynë është themeluar më 1887 dhe aktualisht kemi 11 000 studentë që pretendojnë të diplomohen në Bachelor e Master. Pastaj, ne kemi rreth 65 000 studentë të cilët kanë diplomuar prejse është themeluar universiteti dhe ata tash po kontribuojnë në SHBA duke mbajtur pozita të ndryshme, p.sh: disa janë senatorë, disa janë kongresmenë dhe një prej të diplomuarve është president i një kompanie japoneze. Pra, ata po kontribuojnë brenda dhe jashtë vendit.

Programet tona inxhinierike janë të akredituara nga ATMAE, që është një agjenci kombëtare e akreditimit. Prandaj, për studentët tuaj që do të vinë në universitetin tanë do të jetë një përvojë e mirë sepse ata do të mësojnë për jetën shoqërore dhe për atë inxhinierike. Disa nga studentët tanë ndërkombëtarë që vinë nga Kina, Lindja e Mesme, India apo vendet tjera, e përfundojnë Masterin tek ne dhe pastaj i dërgojmë në universitete të ndryshme, si në atë të Nju Jorkut apo edhe në universitete të tjera për të aplikuar për doktoratë me bursë të plotë që e marrin nga universiteti ynë. Pra, shumica e studentëve ndërkombëtarë që vijnë tek ne e përfundojnë Masterin, marrin grada, si ajo PhD në universitete të tjera, si dhe disa prej tyre shkojnë në kompani të ndryshme ku punojnë si inxhinierë. Prandaj, edhe studentët tuaj janë të mirëseardhur për t'iu bashkuar programit tonë, si dhe ne do t'i njoftojmë studentët tanë për mundësinë e ardhjes këtu.

SYRI



DITA AUSTRIAKO-KOSOVARE E BUJQËSISË 2016

MODELI AUSTRIAK I INTEGRIMIT TË ZHVILLIMIT RURAL

“Meqenëse ushqimi është prodhimi kryesor i njeriut, dhe duke u bazuar në të dhënën që prodhimet ushqimore në tërë rruzullin tokësor përfundojnë në muajin shtator, UBT, në fokus të vetin të studimeve do ta ketë këtë fushë, gjithnjë duke pasur për bazë gjetjen e alternativave për zgjidhjen e këtij problemi”, tha rektori Hajrizi në konferencë

Në Kampusin e UBT-së në Prishtinë, u organizua Konferenca: Dita Austriake-Kosovare e Bujqësisë 2016, me theks të veçantë: Modeli austriak i integrimit të zhvillimit rural, në të cilën pati referues nga Kosova, Shqipëria e Austria.

Konferencën e shpalli të hapur Rektori i UBT-së Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili në fjalën e tij përshëndetëse tha se UBT, në vazhden e interesimit dhe të studimeve të veta ka në plan edhe bujqësinë, e sidomos industrinë e ushqimit.

“Meqenëse ushqimi është prodhimi kryesor i njeriut, dhe duke u bazuar në të dhënën që prodhimet ushqimore në tërë rruzullin tokësor përfundojnë në muajin shtator, UBT, në fokus të vetin të studimeve do ta ketë këtë fushë, gjithnjë duke pasur për bazë gjetjen e alterna-



Kosova pranohet në Organizatën Botërore të Ushqimit

tivave për zgjidhjen e këtij problemi”, tha Hajrizi. Duke folur për zinxhirin prodhues, rektori, Hajrizi u ndal te mundësia e kontributit të UBT-së në rritjen e cilësisë së produkteve ushqimore. Në fund, z. Hajrizi nuk la pa përmendur angazhimin e Ministrisë së Bujqësisë të Republikës së Kosovës, kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, si dhe kryetarin e Forumit Alpbach, z. Franz Fischler, i cili ka ndihmuar dhe ndihmon në zhvillimin e sektorit të Bujqësisë në Republikën e Kosovës. Ë tej, fjalën e mori z. Vezir Januzi, zëvendësministër në Minis-

trinë e Bujqësisë në Republikën e Kosovës, i cili u përqendrua në subvencionet, që Ministria e Bujqësisë u ka dhënë dhe do t’u japë bujqve në Kosovë. Ai përmendi angazhimin e Ministrisë, sidomos në ndarjen e subvencioneve. Vitin që shkoj, sipas z. Januzi, ishin ndihmuar 390 fermerë me një shumë prej 20 milionë euro, e ishin hapur 2500 vende të reja pune. Ndërsa për këtë vit nga kjo ministri është paraparë, që fermerët të ndihmohen me 43 milionë euro subvencione. Bajram Mulaku, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, tha se

komuna e Vushtrrisë identifikohet me prodhimin e patateve, por kjo komunë ka mundësinë e kultivimit të të gjitha pemëve, sepse ka një tokë pjellore prej 7000 hektarësh me mundësi ujitjeje. “Gjatë vitit, që shkoj, Komuna e Vushtrrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë ka ndihmuar 1700 bujq me 330000 euro subvencione”, tha z. Mulaku, kryetar i Komunës së Vushtrrisë. Carl Pauer, veterinar nga Austria, tha se për një kohë të gjatë vepron në Kosovë, duke ndihmuar kosovarët me mbarëshkrimin e kafshëve, e sidomos

me shpërndarjen e lopëve. Edhe pse në Kosovë, deri tani, sipas, z. Pauer, blegtorët më shumë kanë përfitur nga qumështi dhe mish.

“Tani e tutje do të angazhohemi, që të përfitojnë edhe në kultivimin dhe rritjen e numrit të lopëve. Kosova ka ngjashmëri me Austrinë, dhe arsimimi i bujqësisë do të duhej të ishte prioritet”, tha z. Pauer.

Bianka Duro, përfaqësuese e Almako, e specialiste e blegtorisë, u fokusua sidomos në mundësitë e zhvillimit të sektorit të blegtorisë, duke pasur në theks të veçantë tregun shqiptar, të Kosovës dhe atë evropian. Referuesi i fundit, z. Franz Fischler, kryetar i Forumit Alpbach, dhe ish komisionar i EU për Bujqësi, në fjalën e tij, u përqendrua në potencialin, që ka sektori i bujqësisë në Kosovë. Ai tha se, bujqësia zë potencial të lartë, por shtroui pyetjen: “Si mund të bëjmë, që Bujqësia të jetë storie e suksesit”. Sipas z. Fischler, sukcesi nuk ka të bëjë me bujqësinë, por me ushqimin, prandaj, sipas tij, duhet menduar për zinxhirin ushqimor. “Tregjet nuk janë të drejtuara nga prodhuesit, por nga konsumatorët, prandaj duhet menduar në këtë aspekt: që ushqimi të jetë i sigurt, të ketë cilësi të lartë, dhe të ketë çmime të arsyeshme”, tha z. Fischler në fjalën e tij përmbyllëse.

Në fund, z. Fischler dhe z. Januzi nënshkruan deklaratën për pranimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Ushqimit.

NË PROGRAMIN TRAJNUES PESËMUJOR NË JAPONI

STUDENTI I UBT-SË, ATDHE BUJA U CERTIFIKUA ME TITULLIN CIO

Atdhe Buja, student në UBT në nivelin master, ka marrë pjesë në program trajnues pesëmuor në Japoni dhe ka arritur rezultatin maksimal duke u certifikuar me titullin CIO. Objektivat e përfunduar janë realizuar plotësisht nga Atdheu, i cili ka treguar një rezultat maksimal gjatë gjithë kësaj kohe në të gjitha aktivitetet brenda programit. Trajnimi i ofruar në kuadër të programit zhvillimi i asistencës nga qeveria japoneze dhe i-Learning, në JICA Okinawa International Center të Japonisë ishte një nga programet më unike të studimit.

Atdheu ishte pjesëmarrës në turin e vizitave në institucionet qendrore, kompani në Tokio & Okinawa, që ishte një mundësi shumë e mirë për të njohur më shumë realitetin dhe suksesin e popullit japonez, ku TIK-u është fushë shumë atraktive dhe ka arritur nivelin më të lartë të transformimit dhe qytetarët e këtij vendi përfitojnë përmes përmirësimit të jetesës dhe marrin shërbimet publike të nevojshme për ta.

SUKSES I MADH I STUDENTIT TË UBT-SË ATDHE BUJA NË JAPONI

GJEJNË GABIME NË YOUTUBE, SHPËRBLEHEN NGA Google

Një grup studentësh të cilët përbëhen prej 4 programereve të ndryshëm, bënë të mundur që të gjejnë gabime të ndryshme në rrjetet gjigante teknologjike.

Kësaj radhe është Leutrim Berisha ai i cili se fundit gjeti gabime në faqen e Youtube e më pas mori shpërblim, (mjete financiare) nga gjiganti Google.

Por kjo nuk është e gjitha, ky i ri kosovar ka arritur që tashmë të futet edhe në Hall of Fame tek kompania Google, transmeton Klan Kosova.

AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE TË UBT-SË

Rektori Hajrizi u takua me zonjën Tania Friederich, zyrtare e politikave në KE për hulumtim dhe inovacion

Zonja Friederich qëndroi në Prishtinë, për diskutuar programe e përkrahjes së Komisionit Evropian për hulumtim dhe inovacion në institucionet të cilat përkrahen nga ky institucion për veprimtari në këtë fushë

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka zhvilluar një takim me zonjën Tania Friederich, zyrtare e politikave në Komisionin Evropian për hulumtim dhe inovacion për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Zonja Friederich qëndroi në Prishtinë, për diskutuar programe e përkrahjes së Komisionit Evropian për hulumtim dhe inovacion në institucionet të cilat përkrahen nga ky institucion për

veprimtari në këtë fushë. UBT është një nga përfituesit kryesorë të projekteve të Komisionit Evropian për hulumtim dhe inovacion.

Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, është i caktuar si Pikë Kombëtare e Kontaktit (PKK) për Programin Korizë të BE-së për Kërkime dhe Inovacion "Horizon 2020" në Kosovë, për sekto-

rin - Teknologjitë e reja dhe të së ardhmes/ Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK). Në takimin me zonjën Friederich, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera akademike të Republikës së Kosovës, u trajtuan një varg çështjesh. Në ditën e parë u diskutua për aspekte të ndryshme të përkrahjes në fushën e shkencës, ndërsa në ditën e dytë aspekte të fushës së edukimit.

REKTORI HAJRIZI U TAKUA ME REKTORIN E UNIVERSITETIT PËR TEKNOLOGJI DHE EKONOMI TË BUDAPESTIT, JÁNOS JÓZSA

Prof. dr. Edmond Hajrizi, rektori i UBT-së, zhvilloi një takim me Prof. Dr. János Józsa, rektor i Universitetit për Teknologji dhe Ekonomi në Budapest.

Rektorët Hajrizi dhe Józsa diskutuan për një varg çështjesh me interes, përfshirë harmonizimin e aktiviteteve për studime të përbashkëta, hulumtime dhe projekte të tjera të përbashkëta. UBT dhe Universiteti për Teknologji dhe Ekonomi në Budapest kanë marrëveshje bashkëpunimi në shumë fusha, që ofrojnë mundësi shtesë për studentët dhe stafin e të dy institucioneve. Universiteti për Teknologji dhe Ekonomi i Budapestit është i themeluar në vitin 1782 dhe është një ndër universitetet më të mëdha e më të njohura në Hungari.



UBT PËRFAQËSON KOSOVËN NË KONFERENCËN VJETORE TË AESOP

REKTORI HAJRIZI NË KONFERENCËN E SELANIKUT PËR EDUKIM E PLANIFIKIM

UBT-ja, si e vetme e Kosovës, e përfaqëson nga rektori, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në Konferencën vjetore AESOP (Asociacioni i Shkollave Evropiane për Planifikim). Moto e kësaj Konference është promovimi i përsosmërisë në edukimin për planifikim dhe kërkim.

Takimi është mbajtur fundjavën që shkoi në Selanik të Greqisë. Në këtë tubim ndërkombëtar është folur kryesisht për planifikimin, gjegjësisht për qartësimin e kompetencave profesionale në këtë fushë. "Edukimi për planifikim urban është i domosdoshëm edhe në Kosovë. Kjo nënkupton që duhet të qartësohen kompetencat profesionale, në mënyrë që më lehtë të vlerësohet profesioni", ka theksuar profesor Hajrizi pas kthimit në Kosovë. Ai ka shtuar se UBT-ja ka dhënë kontribut të pakontestueshëm në debat,

lidhur me zhvillimin e standardeve të ekselencës për edukimin e planifikimit urban. AESOP është themeluar në vitin 1987, në Belgjikë, si një asociacion ndërkombëtar jo-fitimprurës, me qëllime shkencore, artistike dhe të edukimit. Statuti i këtij asociacioni është bërë zyrtar në Dortmund të Gjermanisë, kurse objektivat kryesore janë që të përfaqësohen interesat e shkollave të planifikimit në Evropë, në administratat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe veçanërisht të organizatave brenda Evropës. Qëllimi kryesor i asociacionit në fjalë është për të nxitur zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushën e planifikimit, për të mbrojtur çështjen e zgjerimit dhe të përmirësimit të arsimit të lartë në aspektin e planifikimit etj. Konferencat për këtë çështje mbahen në të gjitha shtetet pjesëmarrëse.

NË NJË TAKIM TË ORGANIZUAR NGA ZYRA NACIONALE ERSAMUS

REKTORI I UBT-SË ANGAZH OHET PËR PARLAMENT STUDENTOR NË ARSIMIN E LARTË

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka shfaqur idenë se krijimi i parlamentit studentor në kuadër të arsimit të lartë në Kosovë do të ishte në interes të ngritjes së cilësisë, si dhe në involvimin më serioz të studentëve në vendimarrje.

Këtë ide, Hajrizi e ka shfaqur në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, të enjten, në një takim të organizuar nga Zyra nacionale Erasmus +, me Zyrën e Komisionit Evropian, MASHT-in, si dhe ekspertët për reformat e arsimit të lartë. Sipas Hajrizit, krijimi i Parlamentit studentor do të krijonte lidhje më të fuqishme të studentëve dhe do t'u jepte atyre më shumë kompetencë.

Hajrizi e ka vlerësuar lart takimin, ndërsa ka sqaruar

se si ngjarje është në kuadër të grupit HERE, që, siç është shprehur ai "është një emërtim nga Brukseli për të krijuar një forum të mirë në lidhje me temat që kanë të bëjnë me arsimin e lartë". Hajrizi, gjithashtu e vlerësoi si të rëndësishëm bashkëpunimin që do të bëhej me universitetet e tjera për tema të caktuara. Në këtë rrafsh, ai ka shfaqur shpresën për përkrahjen nga MASHT-i.

Remzije Istrefi, koordinatore e Zyrës Erasmus + ka sqaruar se zyra që ajo drejton shërben si pikë ndërlidhëse ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe Komisionit Evropian. Ka sqaruar se Zyra... koordinon dhe menaxhon fondet e arsimit të lartë që vijnë nga Brukseli. "Kjo me qëllim që edhe institucionet

e arsimit të lartë në Kosovë të zhvillohen konform standardeve evropiane", ka shtuar ajo, për të treguar se Zyra Erasmus + në Kosovë ndihmon të gjithë të interesuarit, si studentët, ashtu edhe stafin akademik, stafin administrative etj. Ajo theksoi se Zyra Erasmus + ndihmon institucionet e arsimit të lartë, që të aplikojnë për programet dhe grantet që ofron Komisioni Evropian. Për ekspertin, Lindita Tahiri, reformat e arsimit në Kosovë synojnë një përputhje të plotë me ato të zonës evropiane të arsimit të lartë.

Drejtoresha e Departamentit për arsimin e lartë në MASHT, Drita Kadriu, vuri në pah se çështjet kanë marrë udhë të mbarë, pas miratimit nga qeveria të dy ligjeve: për Arsimin e Lartë dhe për Profesionet e Rregulluara.



UBT I GATSHËM EDHE PËR NJË HAP TË RËNDËSISHËM

HAJRIZI: UBT ËSHTË PJEKUR PËR PROGRAME TË DOKTORATËS

Sipas tij, stafi i mjaftueshëm akademik, infrastruktura e nevojshme, përvoja e krijuar 15-vjeçare, ndërkombëtarizimi dhe shumë elemente të tjera pozitive, janë të mjaftueshme që UBT të fillojë me programe të doktoratave

UBT është pjekur plotësisht për të pasur programe të doktoratës. Këtë e thotë me bindje, rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi. Ai thekson se si institucion i arsimit të lartë, UBT i ka në stafin akademik 400 veta, teksa 20 deri 30 për qind e programeve mbështeten nga ndërkombëtarët.

Hajrizi shton se në UBT janë të regjistruar 9 mijë studentë, në drejtime e programe të ndryshme, në të dy nivelet ekzistuese: Bachelor e Master.

Sipas tij, stafi i mjaftueshëm akademik, infrastruktura e nevojshme, përvoja e krijuar 15-vjeçare, ndërkombëtarizimi dhe shumë

elemente të tjera pozitive, janë të mjaftueshme që UBT të fillojë me programe të doktoratave.

Rektori tregon se UBT tashmë ka aplikuar për akreditim për studime të doktoratës.

“Presim që të formohet komisioni vlerësues përkatës, i cili duke pasur parasysh kohën e gjatë të veprimtarisë, bazën e zhvillimit të kuadrove tek ne dhe plotësimin e të gjitha kriterëve të nevojshme, do të bindet se jemi pjekur edhe për studime në programe të doktoratës”, ka vijuar Hajrizi, i bindur se një gjë e tillë duhet të ndodhë së shpejti. Kjo sepse, siç shprehet ai, me studimet e doktoratës prodho-

het dije e re, si funksionin e domosdoshëm për institucionet e arsimit të lartë. “Ne kemi punuar shumë që t’i nxjerrim kuadrot tona, duke i dërguar në universitetet partnere evropiane për të doktoruar. Këtë e kemi bërë në mënyrë që të kemi doktorë të rinj, me përvojë ndërkombëtare dhe të ecim përpara”, ka thënë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Gjithashtu, ai vë në pah se si institucion i arsimit të lartë, UBT, gjithnjë ka qenë dhe është fleksibil e proaktiv për krijimin e programeve të reja, për të cilat, saktëson ai, ka nevojë tregu i punës në Kosovë.

UBT me Qendrën e parë të Karrierës në Kosovë

Qendra e Karrierës në UBT, e themeluar si njësi e veçantë, me qëllim që tu shërbejë studentëve në fakultetet përkatëse në kuadër të UBT-së dhe që është e para e këtij lloji e themeluar në Kosovë, krijon mundësi të mira për studentët për punësimi, orientim profesional, përgatitje të trajnimeve etj.

Halil Bashota, menaxher i QK-së thotë se studentët mund të përfitojnë një numër të madh të programeve të trajnimeve profesionale, si ato të shkrimit akademik se si të shkruajnë bukur, pastaj trajnimet se si të shkruajnë letra motivuese, CV dhe letër rekomandimit, ku këtu përfshihet edhe pjesa e trajnimeve të karrierës që përbën një atraksion të veçantë për studentët.

“Deri më tani ne kemi ofruar trajnime të ndryshme që janë ndër-lidh me shkathtësitë e nevojshme për të kërkuar punë dhe madje edhe punësimi në kompanitë më prestigjioze vendore dhe të rajonit”, theksoi Bashota.

Sipas këtij të fundit, një shqetësim të madh paraqet fakti që një numër i madh i studentëve nuk i zgjedhin profesionet e duhura, por zgjedhja e tyre rrjedh si rezultat i preferencave shoqërore apo edhe e ndonjërit nga prindërit dhe familjarët, por assesit e orientuar mbi ndonjë analizë paraprake të mirëfilltë. Bashota tha se ata i kanë dhënë rëndësi të veçantë të ardhmes së studentëve duke bërë marrëveshje dhe kontrata

me kompani biznesore dhe institucione publike e private në vend për punësimin e tyre. “Ne kemi nisur praktikën profesionale me një start enorm duke arritur që të sistemojmë 80% të studentëve në praktikë, si pjesë e bashkëpunimit të mirë me kompanitë më prestigjioze si dhe institucionet publike dhe private në vend”. Ai shpjegoi se funksionalizimi i Qendrës së Karrierës në UBT, ka fuqizuar maksimalisht procesin e punës së studentëve, si dhe ka shtuar shanset e tyre për t’iu qasur tregut të punës përmes përvetësimit të shkathtësive profesionale, shkathtësi të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme, respektivisht për gjetjen e vendit të punës.

UBT LIDH MARRËVESHJE ME UNIVERSITETIN AMERIKAN MORENEAD STATE UNIVERSITY

Studentët e UBT-së me mundësi studimi në Amerikë



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka pritur, të hënën, përfaqësuesin e universitetit amerikan, Morenead State University, me seli në Kentucky, Ahmad Zargari - CSTM, Ph.D, njëherësh dekan në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Sistemit të Informacionit brenda këtij universiteti.

Rektori Hajrizi dhe dekan Zargari kanë arritur marrëveshje të ndërsjellë që nga 10 studentë, për një semestër ose një vit akademik, të studiojnë në institu-

cionet përkatëse të shkollimit të lartë, domethënë 10 studentë të UBT-së të studiojnë në Morenead State University dhe 10 studentë të kësaj të fundit, të studiojnë në UBT.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e UBT-së, ndërsa do të përzgjidhen ata që kanë rezultate më të mira gjatë studimit. Në takim është biseduar edhe për shkëmbim të stafit akademik, si dhe për zhvillime të përbashkëta kërkimore e shkencore.

Ligjëratë e hapur në UBT e profesorit amerikan, Ahmad Zargari

Përfaqësuesi i universitetit amerikan, Morenead State University, me seli në Kentucky, Ahmad Zargari - CSTM, Ph.D, njëherësh dekan në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Sistemit të Informacionit brenda këtij universiteti, ka mbajtur të mërkurën një ligjëratë të hapur për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Shkencave kompjuterike të UBT-së.

Para studentëve pjesëmarrës, që kishin mbushur sallën, profesori Ahmad shpjegoi në mënyrë të detajuar programet që ata i ligjërojnë në universitetin e tyre dhe theksoi rëndësinë që ato kanë për zhvillimin e teknologjisë në SHBA dhe në botë. Ai tha se Morenead State University është një mundësi shumë e mirë për të gjithë studentët, sidomos për të huajt. Zargari, po ashtu, përmendi edhe faktin se studentët e tyre përfitojnë bursa të cilat u ndihmojnë atyre gjatë kohës sa janë pjesë e universitetit. Shtoi se përfitime të tilla do të kenë edhe studentët e UBT-së, të cilët do të jenë përfitues të programit të shkëmbimit. “Universiteti ynë ka programe të ngjashme me këto në UBT, prandaj bashkëpunimi do të jetë shumë më i lehtë”, u shpreh ndër të tjera ai. Profesori

Ahmad tregoi se klasat e tyre janë të organizuara në grupe të vogla, me nga 18 studentë dhe se bashkëpunimi mes profesorëve dhe studentëve është shumë i ngushtë, njësoj sikurse edhe në UBT.

Universiteti i Morehead-it ka bashkëpunim me universitete nga vende të ndryshme të botës, si: Kina, Koreja Jugore, Franca, Gjermania dhe së fundi edhe Kosova.

“Studentët tanë marrin përvojë dhe njohuri të mëdha në fushën e inxhinierisë e teknologjisë, dhe kur të kthehen në vendet e tyre janë të gatshëm për tregun e punës”, theksoi Zargari. Ligjëratën, bashkë me një pjesë të stafit akademik, e përcolli edhe rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi. Hajrizi u shpreh shumë i kënaqur me bashkëpunimin midis dy universiteteve dhe tha se mundësia e ofruar do të shfrytëzohet nga studentët e UBT-së. Rektori shfaq shpresën se studentët e UBT-së që do të dërgohen atje, do të arrijnë sukses të madh dhe do të kthehen me përvojë e njohuri të reja.

“Qëllimi i universitetit tonë është që studentët tanë të arrijnë sa më tepër suksese, teksa ky bashkëpunim ka hapur rrugë suksesesh”, përfundoi ai.

NDEROHET HUMANISTJA E MADHE

UBT IA JEP ÇMIMIN "EXCELLENCE LEADERSHIP AWARD" HUMANISTES AUSTRIAKE, MARIANNE GRAF

Me një ceremoni të veçantë, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, e ka nderuar me çmimin "Excellence Leadership Award" humanisten austriake, dr. Marianne Graff. Në hapje të ceremonisë, rektori Hajrizi ka përmendur kontributin e madh të humanistes Graff, si lidërshipe, dhënë tashmë tri dekada, në Kosovë, Shqipëri dhe gjithandëj botës ku ka pasur nevojë. Nikoqiri ka thënë se humanistja Graff ka ndihmuar me ushqim e veshmbathje familjet skamnore në viset e thella malore në Shqipëri.

"Znj. Graff së bashku me bashkëshortin e saj, Wilhem Graff, janë themelues të shoqatës për partneritet Shqipëri-Austri, kurse në kuadër të këtij bashkëpunimi përfshiheshin aktivitete, si zhvillimi i edukimit, përkujdesja shëndetësore, të drejtat e fëmijëve, krijimi i urave ndërlidhëse midis fshatrave, projektet për ndihmë grave, projektet për forcimin e paqes, përkrahja dhe mbrojtja e minoriteteve, forcimi i dialogut ndërkulturor dhe ndërreligjioz, për ekologjinë, forcimin e ndërmarrjeve të vogla, me theks në zhvillimin e bujqësisë etj.", ka theksuar ai.

Ka treguar se Graff ka lënë gjurmë në mbi 100 projekte, si ndërtimi i shkollave, ambulancave shëndetësore, kopshteve të fëmijëve, banesave sociale, qendrave të edukimit, urave etj. Rektori Hajrizi, gjithashtu ka bërë me dije se si rezultat i këtij bagazhi të madh me vepra humanitare, Marianne Graff, në Shqipëri, është nderuar me çmimin "Urdhri Nëna Terezë", kurse në Kosovë ka



UBT nderoi humanisten e madhe Marianne Graf

"Znj. Graff së bashku me bashkëshortin e saj, Wilhem Graff, janë themelues të shoqatës për partneritet Shqipëri-Austri, kurse në kuadër të këtij bashkëpunimi përfshiheshin aktivitete, si zhvillimi i edukimit, përkujdesja shëndetësore, të drejtat e fëmijëve, krijimi i urave ndërlidhëse midis fshatrave, projektet për ndihmë grave, projektet për forcimin e paqes, përkrahja dhe mbrojtja e minoriteteve, forcimi i dialogut ndërkulturor dhe ndërreligjioz, për ekologjinë, forcimin e ndërmarrjeve të vogla, me theks në zhvillimin e bujqësisë etj.", ka theksuar ai.

fituar çmimin "Çmimi i Madh për Paqe dhe Humanizëm", të cilën e ka ndarë bashkë me Kryeadministratoren e parë të Kosovës, Bernard Kouchner dhe Komandantin e parë të forcave paqeruajtëse në Kosovë (KFOR), Gjeneralin - Mike Jackson.

"Shqiptarët nuk do ta harrojnë asnjëherë kontributin dhe ndihmën tuaj, para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë", kanë qenë

fjalët me të cilat rektori i UBT-së, Hajrizi i është drejtuar humanistes Graf, para se ta ftonte atë për t'ia dhuruar çmimin "Excellence Leadership Award".

Humanistja Graff, duke u ndjerë shumë e lumtur për pranimin e këtij çmimi ka thënë se ajo ka ndihmuar këtu, kur njerëzit janë përballur me problemet më të mëdha, kurse këtë çmim e ka kuptuar si "dashuri të kthyer

nga vetë populli". Në vijim ajo ka treguar për ndihmat në Shqipëri, që ka filluar t'i shpërndajë para 24 vjetëve, si dhe për ato në Kosovë, para 18 vjetësh. Organizata e drejtuar nga ajo ishte e para që i kishte ndihmuar popullatën kosovare, para, gjatë dhe pas luftës. Ka thënë se ajo organizatë kishte ndihmuar edhe refugjatët e rikthyer në tokat e tyre, duke u ndarë paketa ushqimore e veshmbathje,

duke ua rindërtuar shtëpitë, duke u bërë strehim të përkohshëm, duke u ndihmuar për hapjen e shkollave, të kopshteve të fëmijëve, për t'u ndihmuar fëmijëve të traumatizuar nga lufta, e kështu me radhë. UBT organizon ceremoni vjetore për dhënien e çmimit "Excellence Leadership Award", ndërsa ai u jepet personaliteteve të shquara, që kanë dhënë kontribut në sfera të ndryshme sociale.

UBT themelon programin "UBT për komunitetin", me çmimin "Dr. Marianne Graff"

Në kuadër të bashkëpunimit të UBT-së dhe humanistes austriake, dr. Marianne Graff, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, pos çmimit që ia ka dhuruar asaj, "Excellence Leadership Award", sot, ka themeluar edhe një çmim në kuadër të UBT-së, por i cili do të mbajë emrin e humanistes.

"Sot hapet programi i ri 'UBT për komunitetin', në të cilin do të përfshihet edhe ndarja e çmimit "Dr. Marianne Graff", ka thënë rektori, teksa ka sqaruar se ky çmim do t'u dhurohet studentëve për kontributin që ata do ta japin në komunitet.

Ai ka theksuar se çmimi do të fokusohet tek pjesa e angazhimit të studentëve dhe të stafit, në zhvillimin material dhe ekonomik të popullatës.

"Natyrsh, prioriteti më i madh do të jetë krijimi i një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm për rajonin", ka thënë rektori Hajrizi, i cili e ka ftuar humanis-



ten Graf për të shpjeguar më në detaje për projektin. Kjo e fundit, ndërkaq, ka shfaqur kënaqësi për krijimin e një çmimi të tillë, siç është shprehur ajo, "jo vetëm për arsyen se ai e mban emrin e saj, por edhe për faktin se studentët do të angazhohen për të kontribuar në vendet ku jetojnë".

"Ideja është që të ketë një kontribut për shoqërinë, të jetë

edhe një lloj njohjeje e iniciativave të tilla dhe promovimi i asaj se si dikush angazhohet për komunitetin", ka shpjeguar Graff. Ajo ka sqaruar se projekti që vjen nga individët mund të jetë i lirë, por për bazë duhet të ketë zhvillimin e fshatrave, energjinë alternative, mbrojtjen e natyrës, kujdesin për pastrimin nga mbeturinat etj. Sipas saj, në

fokus është pjesa, që do të ndikojë në zhvillimin e vendeve të reja të punës. Graff, ka theksuar se kriteret për një projekt të suksesshëm janë: cilësia e iniciativës, zhvillimi i mundësive të reja, vazhdimësia dhe qëndrueshmëria, kontributi në zhvillimet sociale të shoqërisë, pjesa ekologjike, marrja e masave në mbrojtjen e ambientit, zhvillimi i përgjithshëm social, si dhe eliminimi i varfërisë. Ka sqaruar se projektet e studentëve duhet të jenë të dokumentuara, në mënyrë që të vlerësohen më lehtë. Gjithashtu ka bërë me dije se për vlerësimin e projekteve studentore do të krijohet juria, e cila do të përbëhet nga ekspertë vendorë e ndërkombëtarë.

Rektori Hajrizi, në fund, ka bërë me dije se aplikimi duhet të bëhet në mënyrë elektronike, deri në qershor të këtij viti. Projektet më të mira, sipas tij, do të shpërblehen me çmimin "Dr. Marianne Graff".

GRAF, PAS ÇMIMIT NË UBT, DEKOROHET ME "KALORËS I URDHRI TË SKËNDERBEUT"

Katër ditë pasi rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ia ka dhënë çmimin "Excellence Leadership Award", humanistes austriake, Marianne Graf, kjo e fundit, është dekoruar edhe me titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut", nga Institucioni i Presidentit të Shqipërisë, saktësisht nga presidenti, Bujar Nishani.

Në ceremoninë e ndarjes së këtij Titulli ka marrë pjesë edhe vetë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar me një pjesë të stafit të tij.

Me këtë rast, rektori Hajrizi ka biseduar edhe me Presidentin e Shqipërisë, siç thekson ai, për çështje të interesit të përbashkët.

Austriakja, Marianne Graf, i është humanistja që ka treguar lidërshipe për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë, sa herë që ata kanë pasur nevojë. Në Shqipëri e Kosovë, ajo ka ndihmuar nga viti 1992.

HAZIR ÇADRAKU, PROFESOR NË FAKULTETIN E NDËRTIMTARISË NË UBT

BOTA DUHET TË KUJDESET MË SHUMË PËR UJË

“Duhet të rritet shkalla e kujdesit për ujërat, jo vetëm në shkallë vendi, por edhe në shkallë planeti. Nëse vazhdojmë me këtë ritëm të ndotjes, në një të ardhme të afërt do të ballafaqohemi me thatësi dhe mungesë të ujit, ku kjo pastaj do të ketë pasoja në shëndetin e njerëzve në tërë botën”, thotë profesori Hazir Çadraku

UBT News: Një prej sfidave globale është kujdesi ndaj mjedisit, e sidomos ndaj ujërave. Çfarë roli ka faktori njeri në këtë aspekt?


Çadraku: Zhvillimet e hovshme globale kanë sjellë me vete edhe shqetësimet për resurset ujore, jo vetëm për sa i përket sasisë së ujit, por edhe cilësisë së tij. Rritjet demografike dhe zhvillimet e mëdha tekniko- teknologjike që po përjetojnë globi tokësor medoemos po shkojnë në drejtim të shfrytëzimit më të madh të ujërave mbitokësore dhe nëntokësore. Faktori njeri ka i të gjitha kompetencat për planetin sepse çdo sjellje e njeriut reflekton në zhvillimet sociale dhe demografike.

Njeriu duhet të jetë më miqësor me ujin, do të thotë, këto resurse natyre t'i shfrytëzojë në mënyrë sa më racionale dhe t'i ruajë ato. Ne sot kemi ndotje të resurseve ujore në tërë globin, duke pasur parasysh edhe ndryshimet klimatike që janë shqetësim global. Prandaj, duhet të rritet shkalla e kujdesit për ujërat, jo vetëm në shkallë vendi, por edhe në shkallë planeti. Nëse vazhdojmë me këtë ritëm të ndotjes, në një të ardhme të afërt do të ballafaqohemi me thatësi dhe mungesë të ujit, ku kjo pastaj do të ketë pasoja në shëndetin e njerëzve në tërë botën.

UBT News: Çfarë duhet të bëjë njeriu për ta ruajtur ujin?

Profesori Çadraku: Secili individ duhet ta ruaj ujin duke mos bërë veprime të panevojshme me të. Duhet të largohemi nga qasja se ujë do të ketë gjithmonë sepse nëse nuk kujdesemi sa duhet për të dhe ta shfrytëzojmë sa më racionalisht, nuk do ta kemi më.

UBT News: Çfarë thonë ekspertët në lidhje me atë se kur do të



Rrjeti hidrografik i Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna”

mbetemi pa ujë? Cilat vende janë më të pasura me ujë në Kosovë?

Çadraku: Janë bërë statistika të ndryshme se kur do të mbetemi pa ujë, por megjithatë shkencëtarët e qendrave të ndryshme botërore nuk kanë mundur ta japin një përfundim, ndonëse, vazhdimisht i përcjellin zhvillimet. Kjo më tepër varet nga faktori njeri, e sidomos nga ai natyror.

Në rangun botëror shpërndarja e resurseve ujore është e ndryshme në vende të ndryshme. Edhe në Kosovë ka shpërndarje jo të barabartë të sasisë së ujit. Ne kemi më

së tepërmi ujë në basinin e Dukagjinit, kurse tek Ibra dhe Morava e Binçës kemi më pak ujë. Pra, varësisht nga pozita gjeografike, ndryshon edhe sasia e ujit.

UBT News: Cila është situata e resurseve ujore në Kosovë, ndonëse nuk ka statistika konkrete.

Çadraku: Në Kosovë që nga viti 1999 e tutje, pra pas zhvillimeve që ndodhën në vend, njerëz të ndryshëm kanë tentuar të bëjnë disa ndryshime me qëllim të zhvillimit të matjes së pasurisë ujore, por edhe përkundër kësaj, ky sek-

tor ende mbetet sfidues. Vjetarët hidrologjikë mbarojnë në vitin 1986 dhe që prej atëherë ne nuk kemi mundur të bëjmë një sistematizim dhe monitorim të ujërave në Republikën e Kosovës. Ka disa zhvillime parciais që janë zhvilluar me projekte të ndryshme në kuadër të institucioneve të ndryshme të Kosovës, por çështja e resurseve ujore mbetet ende sfiduese.

UBT News: A do të duhej t'i kishim statistikat e resurseve ujore?

Çadraku: Përveç që është detyrim ligjor, statistikat e resurseve

ujore janë edhe të domosdoshme, në mënyrë që të kemi të dhëna për çështje të ndryshme planifikimi sepse në këtë aspekt duhet ta dimë se sa sasi uji kemi dhe çfarë cilësie ka ai ujë. Përveç kësaj, duhet ta dimë sa kemi kapacitete që këto ujëra të shpërndahen për kërkesa të ndryshme sepse me përcaktimet ligjore thuhet se në prioritetet për shfrytëzimin e kërkesave ujore është faktori njeri dhe nuk kërkojmë ta rrezikojmë shëndetin e njeriut. Ne nuk kemi bilanc ujor në shkallë vendi. Në këtë drejtim ka pasur disa tendenca, nisma dhe punime parciais, por në nivel shteti nuk posedojmë një dokument të tillë dhe kjo është pengesë e madhe për planifikimet zhvillimore për periudhat afatmesme dhe afatgjata.

Institucionet duhet të marrin hapa konkretë që brenda një kohe të shkurtër të arrijnë ta bëjnë një bilanc ujor në shkallë vendi, në mënyrë që të shohim shpërndarjen e resurseve ujore për kërkesa të ndryshme, përndryshe nëse vazhdohet në këtë mënyrë, është problematike të bëhen planifikime të mirëfillta të zhvillimit socio-demografik dhe ekonomik të vendit, por janë pengesë edhe në situatat kur investitorët afrohen për të investuar, sepse nëse ata nuk e kanë sigurinë e resurseve natyrore, sigurisht që menjëherë do të tërhiqen.

Kosova ka dokument strategjik për resurset ujore, por si i tillë ende nuk ka kaluar për miratim në Kuvendin e Kosovës, prandaj, lirisht mund të thuhet se vendi ynë nuk ka një dokument strategjik sepse aktualisht nuk është në funksion.

Nuk ka të dhëna dhe hulumtime për pasuritë ujore, ato kanë përfunduar në vitet e 80-ta. Si rezultat, të dhënat hidro-gjeologjike janë shumë të vjetra, kështu që është shumë me rëndësi që institucionet në këtë këndvështrim të bëjnë disa hulumtime për të parë se sa sasi uji ka dhe se ku mund të ketë pasuri të tjera.

UBT News: Ku gjenden resurset më të mëdha ujore në Kosovë?

Çadraku: Nëse e shohim Kosovën në aspektin vizual, mund ta ndajmë se nga janë resurset ujore më të mëdha në sasi. Në këtë drejtim mund të themi se prej Istogut e deri tek Prizreni kemi ujëra të bollshme e që janë burime të fuqishme ujore. Ndërsa, pjesa juglindore dhe veriore, prej Gjilanit, Kamenicës e deri në Mitrovicë është zonë më e mangët me resurse ujore. Këtu ka një shqetësim tjetër serioz sepse pikërisht në këto vende është koncentrimi më i madh i popullsisë dhe funksioneve të tjera që zhvillohen.

UBT News: Sa kohë merr sigurimi i të dhënave të tilla?

Çadraku: Këto hulumtime dhe të dhëna do të mund të siguroheshin jo në afat shumë të shpejtë, por brenda një periudhe 2-3 vje-

UJIN, DO TË MBETEMI PA TË

çare, nëse do të kishte angazhim më serioz të palëve të interesuara si: institucioneve publike e private, ekspertëve dhe të qytetarëve, por kjo kërkon një qasje shumë më serioze se kjo që është tani.

Ne nuk kemi industri apo bujqësi shumë të zhvilluar dhe që do të kërkonin sasi më të madhe të ujit. Këto dy vitet e fundit kemi pasur të reshura të shtuara, por kjo nuk është edhe shumë e qëndrueshme sepse këtu edhe çalojmë me të dhënat. Në kuptimin vizual, jemi më keq sesa që në realitet është. Është mirë që të reshurat janë shtuar, por me shifra nuk mund të flasim asgjë sepse ne nuk kemi përcjellje apo monitorim të reshjeve.

UBT News: Çfarë përfshin monitorimi i ujërave? Kush e ka përgjegjësinë ta bëjë monitorimin?

Çadraku: Monitorimi i ujërave është një term i përcjelljes së një fenomeni ose dukurie që duhet ta vëzhgojmë. Për këtë përgjegjëse janë institucionet vendore, kurse ky institucion në Kosovë është Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Ky institut ka disa të dhëna që maten, por janë në mënyrë shumë parçiale dhe nuk janë ashtu siç kërkohen. Deri më tani, ne nuk kemi vjetar hidrologjik për prurjen apo nivelin e ujërave e të mos flasim për ujërat nëntokësore. Këto ujëra monitorohen vetëm nga kompanitë që e bëjnë këtë për qëllime të veta. Në shekullin që ne po jetojmë dhe në një shtet kaç të vogël, mosmonitorimi i ujërave nuk flet mirë për shtetin tonë.

UBT News: Në raport me vendet e rajonit, ku jemi ne në krahasim me këto vende sa i përket resurseve ujore?

Çadraku: Një analogji dhe krahasim i tillë vështirë se mund të bëhet. Nëse ne krahasohemi vetëm me Shqipërinë, atëherë ajo ka një avantazh bukur të lartë në krahasim me neve në pikëpamje të resurseve ujore. Ndonëse as ata nuk e kanë shkallën e monitorimit në nivel, megjithatë kanë sasi më të madhe të ujërave, sepse edhe kanë më shumë territor, por edhe lumenj me të mëdhenj dhe me prurje më të mëdha.

Nëse krahasohemi me Kroacinë apo edhe vendet e tjera të rajonit, paraqiten të njëjtat probleme, sepse ne përveç që kemi sipërfaqe më të vogël territoriale, kemi edhe gjatësi të lumenjve aq të shkurtër sa që rrjedhjet e lumenjve tanë dalin shumë shpejt jashtë vendit dhe si rezultat, është e pamundur që ajo sasi t'i ushqejë ujërat nëntokësore, që do të thotë se ujërat e lumenjve tanë dalin nga vendi

ynë të pashfrytëzuara. Kur këtyre problemeve ia shtojmë edhe çështjen e monitorimit, na bie neve në një situatë jo të këndshme, sepse ne nuk bëjmë monitorime dhe as hulumtime të sasisë dhe cilësisë së ujërave në shkallë vendi.

Ne jemi vend me resurse jo edhe aq të mjaftueshme ujore, sidomos në krahasim me zhvillimet që po ndodhin dhe rritja e kërkesave kërkon edhe resurse më të mëdha.

UBT News: Cila do të duhet të ishte zgjidhja e problemit të ujërave në Kosovë?

Çadraku: Sfidat e parë është mbrojtja e ujërave. Shteti është dashur që të marrë masa në ndërtimin e fabrikave për trajtimin e ujërave të zeza, pra fillimisht duhet ta minimizojmë ose edhe ta eliminojmë shkallën e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Në këtë situatë që jemi, konsideroj se kemi një shkallë enorme të ndotjes së ujërave. Në këtë aspekt është e kotë që të kemi nivel të lartë të ujërave, nëse ata janë të ndotur dhe nuk mund të përdoren pa u përpunuar më parë. Sfidat kryesore paraqiten në ndalimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotur nga amvisëria dhe industria direkt e në lumenj. Pasojat janë të mëdha, ku zvogëlohet sasia, ngadalësohet rrjedhja e tyre dhe mundësia e vetëpastrimit është shumë e vogël. Çështja tjetër që duhet patjetër të trajtohet është se duhet të bëjmë ndërtime të miniakumulimeve sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës. Ka disa të dhëna historike në bazë të të cilave e dimë se ku mund të ndërtohen ato. Kjo ka rol të madh në aspektin të rregullimit mikroklimatik të zonës ku ndodhen, kontribuojnë në parandalimin e erozionit, e mos të flasim për përdorimin e atij uji për pije dhe ujitje, pastaj për parandalimin e përmytjeve e vërshimeve, duke mos e anashkaluar edhe çështjen e monitorimit sepse pa monitorim është e kotë të planifikojmë e të zhvillohemi.

Ne kemi në dispozicion pesë akumulime sipërfaqësore të cilat janë duke u shfrytëzuar, ku këtu përfshihen dy akumulime në Prishtinë.

UBT News: Ku jemi ne në aspektin e cilësisë së ujit që ne e përdorim për pije?

Çadraku: Cilësia e ujërave në Kosovë deri në një shkallë të plotëson kriteret për ujë të pijshëm. Akumulimet me të cilat furnizohet pjesa më e madhe e popullsisë me ujë të pijshëm, kontrollohen nga kompanitë rajonale të ujësjellës-kanalizimit, të cilat brenda tyre kanë laboratorët me anë të të cilave

e bëjnë kontrollimin e cilësisë së ujërave të cilin e distribuojnë si ujë të pijshëm. Edhe në nivel shteti e kemi Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik që në situatë të caktuara kontrollojnë dhe vëzhgojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ujin.

Çështja më e ndjeshme është në zonat rurale, ku popullsia e shfrytëzon ujin e puseve. Unë kam bërë shumë hulumtime fushore, ku kam vizituar vendin dhe kam parë që shumë puse janë jashtë çdo standardi për përdorim. Thellësia e tyre mesatare është 15-20 metra, që do të thotë se ato ujëra janë të zonës së parë, ku mundësia e ndotjes së ujërave në këtë thellësi është shumë e madhe. Në këto kushte të tilla nuk duhet që të shfrytëzohen për pije. Thellësia ideale e puseve duhet të jetë 20-50 metra.

UBT News: Cilat janë kriteret që duhet t'i respektojë secili që dëshiron ta hapë një pus?

Çadraku: Ekzistojnë shumë kriteret që duhet të plotësohen. Burimet duhet të jenë të mbuluara sipër, në mënyrë që shiu dhe era që bartin me vete ndotësit e ndryshëm, mos të kenë mundësi të futen në ujë. Për murosje të pusit, nuk guxojnë të përdoren elemente të punuara nga hekuri ose vajrat. Ka disa elemente ose parametra që kufizojnë dhe tregojnë se si duhet të bëhet hapja dhe përdorimi i ujërave sanitarë. Duhet të përcaktohen zonat e mbrojtjes sanitare që janë të obliguara edhe me ligj dhe mosrespektimi i tyre çon në dëmtime të natyrave të ndryshme, sidomos mund të kenë pasojat të mëdha në shëndetin e njeriut.

UBT News: Kemi dëgjuar se shumë familje nuk e përdorin ujin që vjen nga ujësjellësi, por e përdorin ujin e ambalazhuar. Çfarë mendimi keni për këtë çështje?

Çadraku: Çdo gjë që hyn në përpunim i humb disa parametra dhe disa të tjerë i fiton. E mira e kësaj do të ishte që ujërat të përdoren ashtu siç janë dhe ashtu siç dalin nga burimet. Por, meqë ne nuk kemi kapacitete për t'i përdorur të atilla, detyrohemi që ujërat t'i përpunojmë deri në disa parametra të caktuara, të cilat janë të lejuara dhe që nuk bënë të tejkalohen. Uji që është brenda parametrevë fizikë, kimikë, biologjikë e mikrobiologjikë është i pranueshëm për pije. Kurse, për çështjen se a duhet të përdoren për pije ujërat e ambalazhuara, duhet të bëhen analiza të thella dhe profesionale. Resurset ujore që dalin nga burimet natyrore janë cilësore dhe madje, mund të përdoren direkt ashtu siç dalin nga burimi.

FLASIN STUDENTËT E DALLUAR TË UBT-SË

Studentët: Studimi në UBT është privilegj

SHERIFE SOKOLI

Studentët e UBT-së me punën e vazhdueshme dhe interesimin që shprehin, gjithnjë e më shumë po dëshmojnë vlerat e tyre në profesionet për të cilat janë përcaktuar. Rezultati i këtyre sukseseve vjen nga një staf i shkëlqyer, profesorë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit dhe një kuadro i mjaftueshëm studimi.

Pra, secili drejtim në UBT ka studentë të cilët janë pasqyrë e punës së vazhdueshme dhe të palodhshme. Në bashkëbisedim me disa studentë të dalluar në drejtimet që i vijnë, shprehen kënaqësitë lidhur me kushtet të cilat ofrohen në UBT, duke bërë të ditur edhe synimet e tyre për të ardhmen që shpie drejt suksesit.

Besart Troshupa, si një absolvent i drejtimit Media dhe Komunikim, theksoi vlerësimin e tij si student për kolegjin në të cilin studion duke u shprehur mjaft i kënaqur me kushtet që ofrohen.

"Kolegji UBT, si institucion i lartë i arsimit në Kosovë është vërtet një top kolegji ku dhe studentët më të mirë bashkohen në të njëjtin vend për të mbledhur forcat dhe vazhduar drejt suksesit, e gjithë kjo falë angazhimit të profesorëve dhe kushteve të mira" u shpreh Troshupa. Lidhur me kushtet e ofruara u shpreh edhe Dorian Gjota student i drejtimit Sistemet e Informacionit. Sipas tij, sukcesi arrihet vetëm me punë dhe angazhim, duke mos lënë pa përmendur edhe mundin e profesorëve që për studentët është shtytje shumë e rëndësishme.

"Rrugëtimi im deri këtu ku jam është në mënyrën e duhur, sepse me angazhim të madh kam arritur që të kem suksese dhe do të vazhdoj më tutje derisa t'i përfundoj studimet, me një staf të mrekullueshëm profesorësh", tha ai.

Kujtesa Mehmeti, studente e drejtimit Sistemet e Informacionit, tregon eksperiencën e saj duke vlerësuar arritjet e saja të deritanishme, si edhe mundësitë që i janë ofruar.

"Rrugëtimi im në UBT deri tani ka shkuar ashtu siç e kam planifikuar, madje dhe më mirë. Me mundësitë që më janë ofruar mënyra për t'iu qasur materialeve studimore nga Moodle, ndihma nga profesorët dhe nga stafi në përgjithësi bëjnë që kushtet e studimeve të jenë shumë të mira", theksoi Mehmeti. **Reisa Imami** studente e drejtimit Shkenca Juridike flet rreth synimeve të saj dhe qasjes profesionale ndaj profesionit.

"Synimi im primar është që t'i jap kontribut maksimal vendit tim dhe të ballafaqohem me realitetin që po jetojmë sot. Duke u angazhuar sa i përket çështjeve juridike të cilave shpresoj t'u qasem me shumë profesionalizëm dhe efikasitet", u shpreh Imami. **Rrona Pula**, studente e drejtimit Shkenca Juridike tregon ambiciet e saja që ka në fushën e drejtësisë.

"Vendosa të studioj këtë fushë nga ambiciet e mia të mëdha që të bëhem një femër e suksesshme në fushën e drejtësisë dhe të kontribuoj në ardhmërinë e vendit dhe gjeneratave të reja", tha ajo.

Studentja tjetër e drejtimit Shkenca Juridike, **Arjeta Shala**, e cilëson UBT-në si universitet nga i cili dalin njerëzit të suksesshëm.

"UBT-ja cilësohet si njeri ndër institucionet privatet më të mira në Kosovë, nga i cili dalin kuadrot me ngritje profesionale më të mirë në vend", u shpreh Shala.

Nga ana tjetër, **Dren Nishliu**, student i drejtimit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, me mjaft entuziazëm tha se qëllimi i tij kryesor është të vazhdojë studimet master jashtë vendit dhe të jetë pjesë e projekteve të mëdha botërore.

"Synimi im është që të vazhdoj studimet master jashtë Kosovës në mënyrë që ta sfidoj veten praktikisht edhe në universitetet me prestigjioze botërore në lëmin e arkitekturës. Dhe gjatë kësaj kohe mendoj që të jem aktiv edhe në projekte të ndryshme, ku vetëm se kam filluar hapat e parë për projekte të mëdha", theksoi Nishliu.

Benita Syla, studente e drejtimit MBE, rrëfen eksperiencën e saj si studente duke treguar se me nisjen e studimeve në UBT për të filloi një epokë e re.

"Fillimisht isha studente në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në një universitet tjetër, gjë që më bëri të tërhiqem menjëherë, pasi që kushtet që ofroheshin ishin skajshmërisht negative. Nisa studimet në UBT dhe u ndjeva sikur të kisha lindur për herë të dytë. Çdo gjë më dukej korrekte dhe pozitive, për mua ishte fillimi i një etape të re", u shpreh Beqaj.

Rilind Beqaj studentë i drejtimit MBE gjatë bashkëbisedimit tha se struktura e organizimit të planprogramit me të cilin punon UBT dhe stafi që posedon e bëjnë të dallohet nga institucionet e tjera të arsimit të lartë. "Programi studimor i harmonizuar me praktikën më të mira ndërkombëtare, stafi akademik profesionalisht i përgatitur dhe i përkushtuar në punë, infrastruktura dhe pajisjet moderne për studime, puna në grupe të vogla dhe ajo ekipore. Të gjitha këto fakte e dallojnë UBT sa i përket cilësisë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë", tha ai.

Kurse **Samire Sadiku** studente e drejtimit Shkenca Politike, tregon se me t'u regjistruar në UBT koncepti për institucionet private të arsimit të lartë ndryshoi tërësisht. "Në fillim nuk kam qenë shumë optimiste mbi cilësinë e studimeve që bëhet në një kolegji privat, por me të filluar studimet në UBT, pikëpamjet e mia ndryshuan tërësisht, kjo si rezultat i seriozitetit të profesorëve të ngritur akademikisht", u shpreh Sadiku.



UBT Executive Academy for Professional Development

your Long Life Learning partner...



Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional në kuadër të Kolegjit UBT-së ka si qëllim ofrimin e mundësive tek studentët dhe personat e tjerë për ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në fushat e Teknologjisë Informativë dhe të Komunikimit, Menaxhimit të Projekteve, Burimeve e Njerëzore etj.

Akademia për Zhvillim Profesional është qendra më e avancuar për ofrimin e trajnimeve profesionale dhe e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për realizimin e trajnimeve dhe certifikimeve me sukses.

Laboratorët e Teknologjisë Informativë në kuadër të Akademisë ofrojnë mundësinë e kryerjes së detyrave praktike me pajisjet e fundit dhe më bashkëkohore të Teknologjisë Informativë dhe të komunikimit.

Sallat e trajnimeve janë të pajisuara me të gjitha elementet që mundësojnë organizimin e trajnimeve atraktive të kuptueshme si dhe mundësinë e diskutimeve të përbashkëta.

Teknologji Informativë dhe Komunikim CISCO Networking Academy

- IT Essentials: PC Hardware and Software
- CCNA 1: Introduction to Networks
- CCNA 2: Routing and Switching Essentials
- CCNA 3: Scaling Networks
- CCNA 4: Connecting Networks
- Cisco: Introduction to Cyber Security

European Computer Driving License (ECDL)

Software Engineering

Programming Languages

- Visual Basic, C#, MVC
- Web Programming (PHP and MySQL)
- Database Programming (MS SQL, Oracle)

Web Development Trainings

- Wordpress Training
- Joomla Training
- E-commerce and SEO Development
- Prestashop, Drupal etj
- HTML5 and CSS
- C# and MS SQL
- Mobile APP Development

Microsoft Windows Server 2012

- Installing and Configuring Win Server 2012
- Active Directory and Domain Controller Win Server 2012
- Microsoft Exchange Server 2012

Computing Simulation

Computer Design and Animation

Customer Relationship Management (CRM)

Enterprise Resource Planning (ERP)

Models, Optimization and Simulation

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit
- (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës

- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznis plan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativë
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme(MRP)
- Shkathësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Dogana
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhimi Financiare
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiar edhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing
- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punë të suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse.

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqum Comunitere e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatike
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë(Pneumatikë, Elektro - Pneumatikë, E-Teknika/Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx-Teknologjitë(CAD/CAM,
- CAQ,CAP dhe CA të tjera)
- CNC - Teknikat
- Robotikë
- Teknikat e Punës/Organizimi Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim AUTOCAD dhe ARCHICAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Akademia Profesional e Kolegjit UBT trajnimet i organizon në qendra të ndryshme të Kosovës si në: Prishtinë, Kampusi Inovativ në Lipjan, Prizren dhe Ferizaj.

Trajnimet profesionale në disiplina të lart cekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendor dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superior dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një listë të gjerë trajnimesh për një karrierë profesionale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Për informata shtesë ne lidhur me trajnimet ju lutem na kontaktoni në:

Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional

Adresa: Lagjja KALABRIA p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 541 400 ext. 111
Email: ictacademy@ubt-uni.net
Website: http://academy.ubt-uni.net

KONFERENCA "DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E LIRISË SË MEDIAVE"

KOSOVA DO MË SHUMË LIRI MEDIALE, AQ SA EDHE ETIKË PROFESIONALE

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, e ka nderuar me çmimin "Exellence Lidership Award", diplomatin e mirënjohur evropian, dr. Erhard Busek, për kontributin e tij në rrafshin politik e shkencor, si dhe për angazhimin e tij në çështjen e Kosovës

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka vlerësuar se në Kosovë ka nevojë më shumë për lirinë e medias, për aq sa ka nevojë që në të mbizotërojë etika profesionale.

Ai e ka thënë këtë në Konferencën "Dita Austriake-Kosovare e Lirisë së Mediave", organizuar nga UBT, Instituti i Medias dhe shoqatës Austriake-Kosovare.

"Mediat luajnë një rol shumë të rëndësishëm, qoftë pozitiv apo negativ, ato shprehin saktësi apo pasaktësi. Prandaj, kërkohet një autonomi apo liri e tyre, në mënyrë që qytetarët të informohen shpejtë e qartë.", tha Hajrizi.

Sipas tij Kolegji UBT ka bashkëpunuar me Institutin e Kosovës për Media, në mënyrë që të ketë ndëraktivitet. Hajrizi tregoi se si rezultati i këtij bashkëpunimi janë bërë disa hulumtime për besueshmërinë e mediave, për shikueshmërinë e tyre. Po ashtu, bëri me dije se janë mbajtur debate për temën, duke e futur në këtë mes edhe konferencën e së enjtes. Para se të fillonte debati për lirinë e shprehjes në media, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, e ka nderuar me çmimin "Exellence Lidership Award", diplomatin e mirënjohur evropian, dr. Erhard Busek, për kontributin e tij në rrafshin politik e shkencor, si dhe për angazhimin e tij në çështjen e Kosovës.

Fituesi i këtij çmimi prestigjioz të UBT-së, ish-zëvendëskancelari i Austrisë dhe diplomati i mirënjohur evropian, dr. Erhard Busek, ndërkaq, theksoi se të gjitha çmimet që ai i merr nuk nënkuptohet se ka punuar për çmime, por për të arritur rezultate sa më të mira. Busek, gjithashtu, ka vlerësuar se Kosova ka arritur shumë në aspektin e lirisë së medias.

"Por e ndjej se puna nuk ka mbaruar këtu. Ne do t'ju mbështesim gjatë tërë rrugëtimit tuaj", shtoi Busek, sipas të cilit gjithçka ka bërë, nuk e ka bërë që të marrë



"Kosova është larg standardit të lirisë së shprehjes dhe gazetarët në Kosovë janë cak i personave apo grupeve të caktuara të interesit", u tha ndër të tjera në konferencë

mirënjohje, sepse mirënjohja më e madhe për të është angazhimi i brezave të rinj për çështjen e Kosovës, në veçanti për lirinë e mediave. "Ju jeni përgjegjës për të ardhmen tuaj", u shpreh z. Busek.

Ai gjithashtu tha se situata e lirisë së mediave duhet të përmirësohet, pasi që është shumë e rëndësishme për demokracinë në Kosovë si dhe rrugëtimin e saj drejt integritimit evropian. Sipas presidentit të Komisionit për Media, Fazli Veliu, liria e shprehjes në media është element i pandashëm nga liria e shprehjes së përgjithshme. "Kosova është larg standardit të lirisë së shprehjes dhe gazetarët në Kosovë janë cak i personave apo grupeve të caktuara të interesit", theksoi ai teksa shtoi se gjendja e lirisë së mediave nga viti në vit po përkeqësohet dhe ende po vazhdon të mbetet vetëm një debat i mbyllur në kuadër të publikut.

Përfaqësuesja e Komisionit të Mediave në Parlamentin e Kosovës, Shqipe Pantina, pasi foli për rolin e medias, si fuqi e katërt në shtetet demokratike, vlerësoi se mediat në Kosovë kontrollohen e cenohen nga persona e grupe të caktuara të interesit. "Liria e mediave shpesh cenohet edhe nga vetë gazetarët, si rezultat i mungesës së profesionalizmit, qëllimisht, apo që për t'u shërbyer grupeve të caktuara të interesit", vuri në pah ajo. Pantina konsideron se edhe pse kanë kaluar 16 vjet nga lufta, media kosovare ende nuk e ka arritur fazën e pjekurisë. "Ende kemi mungesë të mediave që i shërbejnë publikut, duke e përçarur të vërtetën ashtu siç është", u shpreh ajo. Për ekspertin e medias, Remzije Shahini - Hoxha, në Kosovë nuk mund të flitet për çështjen e lirisë së shprehjes në rrafsh të përgjithshëm. "Liria e shprehjes nuk ka limite. Ajo është

bazike për të drejtat e njeriut dhe ne duhet të jemi më të kujdesshëm, sepse në disa momente e kemi keqkuptuar lirinë e mediave.

Liria jonë mbaron kur cenohet liria e tjetrit", u shpreh Shahini - Hoxha. Sipas drejtorit të Informacionit në TV Klan, Gazmend Sylja, secili gazetar duhet ta frenojë vetën gjatë shkrimit. "Detyra e gazetarëve është të mbledhin material, kurse shkrimi duhet të bëhet mbi fakte e ngjarje reale", tha ai, duke kritikuar se në Kosovë, gazetarët e rinj nuk kënaqen me shkrimet që bëjnë, por vazhdojnë të bëjnë edhe komente. Ai mendon se në Kosovë ka liri të tepruar të mediave. "Gazetarët, duke u thirrur në emër të lirisë së shprehjes e keqpërdorin misionin e tyre", tha Sylja.

Adelheid Woefl, gazetare për çështjet e Ballkanit nga Austria, konsideron se në Ballkan ka më pak liri të mediave, ndonëse sipas

saj, disa vende kanë arritur progres në këtë aspekt. Ajo tha se sa i përket lirisë së mediave, Kosova radhitet në vendin e 87-të, Shqipëria në vendin e 82-të, Serbia në vendin e 67-të, kurse Bosnja e Hercegovina gjendet në vendin e 66-të. Sipas saj, rënie ka shënuar Maqedonia, e cila aktualisht radhitet në vendin e 117-të.

"Disa nga mediat jo vetëm që raportojnë çka u shërben grupeve të interesit, por edhe shërbejnë si armë për t'i kundërshtuar kritikët e tyre", u shpreh Woefl.

Ligjëruesi në UBT, Ferid Selimi, tha se çdo shkrim në media duhet të jetë i interesit të përgjithshëm. "Një shkrim, që e ka aktualitetin, i ka të gjitha elementet, që do ta bënin të lexueshëm, të botueshëm, por që nuk do t'i pëlqente redaktorit, ose pronarit të medias, shkrim që do t'i prishte punë atyre të dyve, nuk ia vlen barra qiranë të merret mend e të shkruhet".

Botohet libri "Transmetuesi publik", i ligjëruesit në UBT, dr. Ferid Selimi

Ka dalë nga shtypi libri shkencor, Transmetuesi Publik, i autorit, dr. Ferid Selimi. Është ky libri i shtatë i tij që ua jep lexuesve, ndërsa i dyti i natyrës shkencore. Libri, pos trajtimit të gjithanshëm të transmetuesit publik në Kosovë – RTK, e jep një pasqyrë të qartë edhe për informimin pas luftës së dytë botërore, sfidat, pushtimin e mediave nga Serbia, zhvillimet e pasluftës në të, organet drejtuese të tij, për bashkëdrejtimin me ndërkombëtarët, zgjerimin e programeve, reformat dhe infrastrukturën ligjore, mënyrën

e financimit, si dhe për dhjetëra elemente të tjera që i përkasin këtij transmetuesi publik kosovar. Libri u jep mundësi të mira hulumtimi studentëve, sidomos atyre që e studiojnë gazetarinë.

Transmetuesi publik, i autorit, dr. Ferid Selimi, s'është thjesht një rrëfim, apo përshkrim i të bërave dhe të pabërave nga transmetuesi publik – RTK, por një shkencë e mirëfilltë që rezonon thellë dhe që jep edhe zgjidhje: se si duhet të funksionojë një transmetues publik, në rastin konkret – RTK-ja.

Dr. Selimi, aktualisht ligjërues në UBT, ka të botuara edhe librat: Qeverisja vendore – shqyrtime krahasimtare; Pellgu i dhembjes (bashkautor); Muzeu i jetës; Mizëkapuçët; Kujtime të thinjura I dhe Kujtime të thinjura II. Po ashtu, ka marrë pjesë në dhjetëra konferenca shkencore, kombëtare e ndërkombëtare, si dhe ka botuar një gamë punimesh të prezantuara.

Autori është i lindur në Preshevë, më 1963. Në rrafshin akademik ka doktoruar në fushën e gazetarisë.



INTERVISTË ME PROFESORIN E FAKULTETIT TË NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS NË UBT, NOL DEDAJ

UBT ME PROGRAM TË VEÇANTË PËR SIGURINË NË KOMUNIKACION

“Fati i Kosovës është që UBT-ja ka një program të mësimit të veçantë, i cili ka si model programin austriak. Atje bëhen hulumtime për ndërtimin e rrugëve dhe çështje të tjera në këtë lëmi. Në këtë fakultet, krahas lëndëve që kanë të bëjnë me ndërtimet arkitekturore, ligjërohen edhe lëndët që kanë të bëjnë me komunikacionin dhe elementet e sigurisë rrugore”, thotë profesori Dedaj

UBT News: A është i shprehur tek ju “defekti profesional”, ku i shihni të gjitha mangësitë dhe të metat në komunikacion më tepër se tek tjerët?

Dedaj: Zakonisht, ne si profesionistë e kemi këndin tonë të shikimit dhe prej tij i verifikojmë dhe i përkufizojmë elementet që janë të dëmshme për shoqërinë tonë në komunikacionin rrugor.

UBT News: A mund të na tregoni diçka më tepër për lëndën të cilën e ligjëroni ju?

Dedaj: Në UBT kam takuar shumë profesorë që janë të përkushtuar për punën e tyre, si dhe jam njohur me lëndët që janë në kuadër të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, ku përfshihen edhe lënda të cilën e ligjëroj unë, Bazat e Komunikacionit. Fati i Kosovës është që UBT-ja ka një program të mësimit të veçantë, i cili ka si model programin austriak. Atje bëhen hulumtime për ndërtimin e rrugëve dhe çështje të tjera në këtë lëmi. Në këtë fakultet, krahas lëndëve që kanë të bëjnë me ndërtimet arkitekturore, ligjërohen edhe lëndët që kanë të bëjnë me komunikacionin dhe elementet e sigurisë rrugore.

Për herë të parë unë në UBT po e shoh një fakultet që ka të bëjë me përzjerje të lëndëve kryesore. Syllabusi i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës është i kri-

juar në atë mënyrë që studentët deri në fund të studimeve të tyre do të kenë mundësi dhe njohuri të mëdha edhe për sa i përket komunikacionit. Këta studentë premtajn shumë dhe jam shumë optimist që ata nesër do të dalin të diplomuar dhe me shumë përgjegjësi do ta kryejnë punën e tyre.

UBT News: A është ndryshe mënyra se si ligjërohet në këtë degë e UBT-së nga forma siç ligjërohet në universitetet tjera?

Dedaj: Në universitetin publik nuk kanë lëndë të ndërtimit të ulët, por vetëm atij të lartë. Si pasojë, inxhinierët që po diplomohen nuk i kushtojnë fare rëndësi projektit të sigurisë rrugore gjatë ndërtimit të rrugëve.

Në të ardhmen besoj që do të jetë obligative që projektet e ndërtimit të rrugëve të kenë si pjesë përbërëse edhe projektin e sigurisë rrugore. Në këtë aspekt, studentët e UBT-së do të jenë shumë të përgatitur që pas mbarimit të fakultetit të kenë njohuri në lidhje me këtë çështje.

Studentët e vitit të tretë në Master e kanë për detyrë që t'i hulumtojnë pikat e zeza dhe ato të konfliktit në vendet që jetojnë ata dhe pastaj, së bashku me mua në fund bëjnë projekte dhe marrin masa për evidentimin dhe largimin e këtyre pikave në mënyrë që me këtë veprim të bëhet parandalimi dhe minimizimi i aksidenteve.

UBT News: Nga kush është marrë ideja për ligjërimin e një lënde të tillë?

Dedaj: Në shtetet e perëndimit punohet me programe të cilat ndryshojnë vazhdimisht, varësisht nga nevojat dhe propozimet

që ka vendi dhe qytetarët. Plani që ka UBT-ja është një pasqyrë shumë e mirë edhe për universitetin publik që të reflektojë e t'i marrë praktikën e UBT-së dhe t'i fus në planprogramin e tij lëndët që aktualisht ligjërohen këtu sepse janë shumë të nevojshme.

UBT News: Sa ju duket studentëve atraktive kjo lëndë, duke qenë se gjithçka realizohet në praktike.

Dedaj: Sot aksidentet janë bërë fenomene të pandalshme dhe thuajse kanë prekur çdo familje. Gjatë diskutimit me studentët, unë i kam caktuar edhe detyrat projektuese të cilat do t'i përfundojnë dhe u kam kërkuar atyre që të hulumtojnë dhe t'i gjejnë vendet ku ndodhin më së shumti aksidente në qytetet e tyre. Pastaj, bashkërisht kemi hulumtuar dhe i kemi gjetur elementet e problemeve që kanë qenë shkaktarë të aksidenteve në ato pjesë. Detyra projektuese e studentëve është që të gjejnë mënyra dhe ide se si t'i eliminojnë pikat e zeza dhe ato të konfliktit nëpër vendet përkatëse. Kështu, secili prej studentëve i hulumton defektet rrugore që ndodhen nëpër rrugët e qyteteve prej nga ata vijnë.

Një fenomen i problemeve të

tilla është edhe Prishtina, me ç'rast studentët tanë e kanë matur gjerësinë e rrugëve, si dhe mundësinë e shtimit të shtigjeve të biçikletave nëpër rrugët e Prishtinës, duke i marrë si model vendet e tjera të Evropës.

UBT News: Kjo thjesht mbetet detyrë shkollore, apo ju paraqitet zyrtarëve të komunave përkatëse për shqyrtim?

Dedaj: Në UBT kemi zyrtarë të komunave të cilët janë në përfundim të studimeve dhe gjatë përpjekjeve për zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës rrugore, ata kanë mbetur të mahnitur me faktin se çka mund të bëjnë ata për qytetet e tyre, vetëm me njohuri dhe ide të mjaftueshme dhe jo me shumë mjete të nevojshme financiare. Pas përfundimit dhe pranimin të detyrave projektuese, UBT-ja do të organizojë edhe një konferencë për sa i përket sigurisë rrugore dhe ku ne do t'i bëjmë publike edhe për opinionin e gjerë detyrat e studentëve tanë sepse në këto detyra, ne kemi përdorur jo vetëm profesionalizmin, por edhe shkencën. Pastaj, projektet e tilla do t'u paraqiten edhe komunave përkatëse, duke ua dhënë atyre arsyet se për çka kemi punuar dhe se si mund të eliminojmë pikat e zeza dhe ato të konfliktit nëpër rrugët e qyteteve të tyre, me qëllim të shmangies së aksidenteve që shumë shpesh përfundojnë edhe me fatalitet.

UBT News: Çka janë pikat e zeza dhe ato të konfliktit?

Dedaj: Pikat e zeza janë vendet ku ndodhin dy apo më tepër aksidente, si pasojë e faktorit rrugë dhe gabimeve të lëshuara gjatë hartimit të projekteve rrugore ose edhe mosrespektimit të projektit rrugor, kurse rregullimi i tyre në mënyrë inxhinierike kushton jashtëzakonisht shumë. Kurse, pikat e konfliktit janë gabime të cilat lëshohen gjatë projektimit të rrugës, si pasojë e mosnjohjes së adekuat. Në këto raste, studentët e vitit të tretë janë mësuar se si duhet të evidentohen dhe eliminohen këto pika në forma të llojllojshme të kryqëzimeve dhe kam shpresë që detyrat projektuese do të dalin jashtëzakonisht të mira.

UBT News: Sa jeni të kënaqur me këto detyra projektuese?

Profesori Dedaj: Dy punime të studentëve janë në pranim sipër, kurse një detyrë tjetër është më e ndërlikuar sepse ka të bëjë me rregullimin e Prishtinës-Shkup sepse aty ndodhen dy pika të zeza dhe që si pasojë ka edhe shume aksidente që shpesh kanë përfunduar me fatalitet.

Pas përfundimit të punimit, rezultatet do t'i paraqiten edhe opinionit dhe profesionistëve, të cilët do të shohin se si rrjedhin punimet kur krijohen dhe respektohen edhe planet e sigurisë rrugore dhe se çfarë ndodh kur bëhet e kundërta dhe për këtë qëllim në UBT do të organizohet një konferencë, ku do të jenë të ftuar edhe politikëbërësit dhe zyrtarët e komunave në mënyrë që edhe ata ta shohin se ku janë bërë gabimet dhe do t'i përmirësojnë ato.

UBT News: Sipas jush, kush është përgjegjës për të gjitha këto parregullsi në komunikacion?

Dedaj: Derisa në shtetet e perëndimit këshillat e sigurisë nacionale i udhëheqin njerëzit me eminentë të fushës së sigurisë së komunikacionit rrugor, tek ne nuk ndodh ajo. Derisa në shtetet e tjera secila komunë e ka këshillin e sigurisë lokale, tek ne nuk ekziston një këshill i tillë. Ky është një problem i menaxhimit të aksidenteve në fushën e sigurisë.

Në shtetet e perëndimit ekzistojnë gjyqtarët e specializuar për aksidente, ku prej këtu më pas dalin edhe masat parandaluese, ne nuk kemi gjyqtarë të specializuar për shqyrtim të aksidenteve. Pastaj, tek ne ekspertët kërkojnë nga prokurori të shkruhet neni me të cilin ka gabuar shoferi, por kjo nuk duhet të bëhet sepse nuk është përgjegjësi e tyre. Ekspertët duhet t'i shikojnë dhe t'i shqyrtojnë gabimet teknike nëpër rrugë.

UBT News: Cilët janë faktorët që i shkaktojnë aksidentet rrugore?

Dedaj: Janë pesë faktorë që ndikojnë. I pari është faktori njeri, i cili i bën shumicën e aksidenteve, duke mos qenë në gjendje të vozis automjetin për shkak të gjendjes së tij të lodhur, gjendjen nevrrike, pastaj kur është nën ndikimin e substancave narkotike apo alkoolit, kjo sepse elemente të tilla i zvogëlojnë aftësitë e njeriut. Faktor tjetër është shpejtësia që lidhet edhe me faktorin njeri, por edhe me atë edukativ. Pastaj, faktori rrugor që përfshin lëshimin e gabimeve teknike gjatë ndërtimit të rrugëve. Faktori automjet në Kosovë është fajtor më shumë sesa që parashihet me standardet evropiane, ku ai është 3-5 për qind, kurse në Kosovë ky standard tejkalohet sepse shumica e automjeteve janë më të vjetër se 15 vjet. Faktor tjetër është edhe incidenti, ku në vendin tonë di të shkaktojë probleme të mëdha me rastin e shirave, pastaj këtu përfshihen edhe balta, gjethet, rënia e gurëve, e mjegullës, të cilat shkaktojnë pamundësinë e shmangies së aksidenteve.

UBT News: Sa e kryen policia punën si duhet, si dhe kompanitë e pastrimit të rrugëve?

Dedaj: Gabimet të cilat policia nuk i falë janë në rastet e përdorimit të alkoolit apo narkotikëve. Pas kësaj, shoferët e tillë marrin vetëm një gjobë në para, ku për mendimin tim ky nuk është një dënim i mjaftueshëm, megjithatë në këtë



KONFERENCA "DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E EKONOMISË"

rast faji nuk është i policisë sepse ata vetëm e bëjnë punën e tyre.

Shteti duhet të ketë një vullnet politik për t'iu qasur këtij problemi me njerëzit adekuat. Shteti duhet të merret me edukimin e këtyre personave në mënyra të ndryshme, duke iu hequr pikë nga testi i patentë shoferit. Edukimi mund të bëhet në mënyra të ndryshme, përmes filmave vetëdijesues si dhe ligjëratave me tema të atilla që i bindin shoferët e padisiplinuar se çka ndodh nëse nuk i respektojnë rregullat e komunikacionit. Të gjitha këto do të kishin shkaktuar ndryshime thelbësore në mendjen e njeriut.

UBT News: A kemi ndonjë shembull të mirë të ndonjë rrugë që është ndërtuar sipas standardeve evropiane?

Dedaj: Mua më ka befasuar për të mirë kompania e ndërtimit të rrugëve "Bechtel-Enka", me ndërtimin e të ashtuquajturës autostradë, edhe pse në fakt nuk është e tillë, është vetëm rrugë e shpejtë. Autostrada ka karakteristika të tjera: ka tre shirita qarkullimi me një kah, si dhe, një shirit ndihmës, pastaj ka përkufizime dhe rregulla të tjera: automjetet nën 60 kilometra në orë nuk kanë të drejtë të kenë qasje për lëvizje, kamionët, traktorët dhe mjetet e tjera bartëse të mallrave nuk kanë të drejtë të lëvizin nëpër autostradë.

E jona është rrugë e shpejtë dhe e sofistikuar me elemente të sigurisë, është bërë aq bukur sa nuk kanë lënë hapësirë për qarkullimin e ujit, rënien e gurëve, kalimin e kafshëve të egra dhe shumë elemente të tjera, por mbi të gjitha, i ka edhe elementet e sigurisë. Jam i bindur që kjo kompani që e ka ndërtuar autostradën e kanë projektin e sigurisë edhe pse asnjëherë nuk është diskutuar nëpër televizione, prandaj kjo është edhe arsyeja e kostos së lartë të projektit. Ndonëse ka kushtuar shumë, çdo financim ka vlerë sepse as shtetet e Ballkanit nuk e kanë këtë nivel të sigurisë në rrugë.

UBT News: A janë të ndërtuara si duhet rrugët urbane në Kosovë?

Dedaj: Rrugët tona urbane i kanë disa të meta, si mbjellja e pemëve, sepse në shumë raste e pengojnë dukshmërinë e rrugëve, kurse këtu është në pyetje faktori incident.

Dukshmëria e tabelave, e reklamave dhe elementeve të tjera po e pengojnë qarkullimin e veturave, pastaj janë edhe shtigjet e ciklistëve të cilat nuk po vendosen në anën e duhur të rrugës.

Nëse komuna do t'ia linte projektet e ndërtimit të rrugëve UBT-së, situata në komunikacionin rrugor do të ishte shumë më mirë.

Prishtina është qytet për eksperimente profesionale dhe kjo mund të bëjë krijimin e një grupi ekspertësh të cilët do të paguhehin, por edhe do të punonin si duhet për të rregulluar kaosin rrugor në Prishtinë.

Projektet e realizuara nga UBT-ja do t'i befasojnë shumicën e qyteteve të Kosovës, duke përfshirë Obiliqin, Podujevën e Prishtinën.

Kosova ofron kushte për zhvillim ekonomik

Austria ka tejkaluar shumë kriza dhe barriera ekonomike, por edhe përkundër kësaj, ajo ende nuk ka kaluar në sferën publike" tha Barbara Koln, presidente e reformave ekonomike austriake, duke treguar se edhe përkundër kësaj, austriakët besojnë në tregun e lirë, por gjithmonë duke pasur parasysh respektimin e ligjit



Kosova i ka të gjitha kapacitetet për t'u zhvilluar ekonomikisht, por shoqëria jonë duhet të krijojë kushte më të mira për investitorët e huaj dhe ata vendorë, u tha në konferencë

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka vlerësuar se Kosova ofron kushte të mira për zhvillim ekonomik dhe punësim, por sipas tij, duhet pasur vullnet politik dhe qytetarë për të punuar.

Ai e ka thënë këtë në Konferencën "Dita Austriake-Kosovare e Ekonomisë", organizuar nga UBT, Shoqata Austriake-Kosovare dhe Instituti liberal për hulumtim të politikave.

"UBT-ja po mundohet që përmes kuadrove të reja të krijojë hapësirë për zhvillimin e tregut të lirë dhe mjedisit ku studentët tanë të shprehin me përkushtim aftësitë e tyre", tha Hajrizi.

Ai e përmendi përvojën e tij personale, duke treguar se ka nënshtruar austriake, por ka vendosur që të kthehet në Kosovë dhe të jap kontributin dhe përvojën e tij të marrë në Austri sepse vendi ynë ka nevojë për kuadro që kanë nivelin e lartë të shkollimit.

Duke iu drejtuar veçanërisht studentëve që ishin të pranishëm në konferencë, Hajrizi u shpreh se çdokush që ka nivelin e duhur të arsimimit, është e pamundur të përballet me problemin e punësimit, kjo pasi që sipas tij, Kosova ka shumë të diplomuar, por jo edhe njerëz që janë në gjendje ta kryejnë punën e tyre si duhet, "prandaj nëse ju bëheni të mirë, jo vetëm që do të

gjeni punë, por edhe do të kërkojeni nga të gjithë".

Armend Kelmendi, Drejtor në Administratën Tatimore të Kosovës tha se Kosova është bërë pjesë e ekonomisë së tregut botëror dhe kjo i ka ndihmuar edhe bizneset kosovare që të kenë përfitime shumë më të mëdha. "Qeveria po punon vazhdimisht që t'ua lehtësoj punën ndërmarrjeve në Kosovë", shtoi ai, duke treguar se ata po i luftojnë të gjitha dukuritë negative që e pengojnë zhvillimin ekonomik, duke vënë theks të veçantë tek konkurrenca jolegjale dhe ekonomia joformale.

"Ekonomia joformale është kanceri i ekonomisë kosovare", theksoi Kelmendi. Barbara Koln, presidente e reformave ekonomike austriake tregoi historinë e zhvillimit ekonomik të Austrisë dhe vendeve më të zhvilluara të botës, që dikur përballëshin me probleme të mëdha në rrafshin ekonomik. "Austria ka tejkaluar shumë kriza dhe barriera ekonomike, por edhe përkundër kësaj, ajo ende nuk ka kaluar në sferën publike" tha ajo, duke treguar se edhe përkundër kësaj, austriakët besojnë në tregun e lirë, por gjithmonë duke pasur parasysh respektimin e ligjit.

Koln përmendi edhe skandalin e Panamasë dhe mënyrës se si dhjetëra udhëheqës shtetëror i kanë fshehur pasuritë dhe paratë

të cilat i kanë fituar në mënyrë të jashtëligjshme, gjithmonë duke tentuar t'iu ikin pagesave tatimore, veprim të cilin ajo e quan shumë të gabuar.

"Unë jam pro taksave sepse ato sigurojnë efektivitetin ekonomik në shoqëri, por duhet pasur parasysh që taksat e larta e pamundësojnë lindjen e konkurrencës dhe zhvillimit ekonomik", u shpreh Barbara Koln.

Biznesmeni amerikan, Michael Williams tha se baza kryesore e zhvillimit ekonomik është kapitalizmi, ndonëse shumica e njerëzve duke mos e kuptuar rolin e tij, e luftojnë në të gjitha format. "Kapitalizmi është veprim i domosdoshëm ekonomik sepse ndikon vazhdimisht në rritjen e standardit të jetesës".

Ai përmendi edhe nevojën e reduktimit të taksave, me qëllim që të arrihet një perspektivë më e madhe në zhvillimin shoqëror. "Është përgjegjësi personale që njerëzit të marrin iniciativë për të përmirësuar jetën e tyre", theksoi Williams.

Maria Banco, ligjëruese në Spanjë, tha se gjithçka në ekonomi ka të bëjë me besimin, duke filluar nga shkëmbimi, e deri tek sjellja e shitësve dhe e blerësve.

"Besimi është diçka qenësore dhe energjia e tij lirohet në mënyra të ndryshme tregtare", tha ajo, duke shpjeguar se kur

lëkundet besimi, rritet kreativiteti dhe sistemi në pikëpamje të progresit të njerëzve. Banco vlerësoi se ndërmarrësit duhet të jenë revolucionarë që bëjnë ndryshime, mirëpo gjithmonë duke qenë të pavarur nga sistemi politik. Armend Muja, ligjërues në UBT tha se Kosova i ka të gjitha kapacitetet për t'u zhvilluar ekonomikisht, por sipas tij, shoqëria jonë duhet të krijojë kushte më të mira për investitorët e huaj dhe ata vendorë.

Duke iu referuar valës së largimit të qytetarëve nga Kosova, Muja tha se ka zhvilluar një studim për t'i gjetur shkaqet dhe arsyet e ikjes, me ç'rast tregoi se nga rezultatet e studimit del që dëshira e qytetarëve për t'u larguar nga Kosova, është rritur nga 24% sa ishte në vitin 2008, në 38% në vitin 2016. Ai shpjegoi se njerëzit e grupmoshave të reja dhe të moshuara janë ata që kanë tentuar të largohen më së tepërmi, si pasojë e konkurrencës, resurseve të kufizuara dhe presionit demografik.

Sipas tij, për të pasur një ekonomi të zhvilluar, Kosova duhet të lëvizë nga prodhimi i lëndës së parë, në gjysëmprocesim dhe procesim. "Pika e dobët e shtetit tonë janë mosgjatja e mënyrave të reja për prodhim dhe mosnjohuritë në këtë aspekt. Prandaj, ne duhet t'i rrisim shpenzimet në zhvillim dhe hulumtim", shtoi ai.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

STUDENTËVE TË UBT-SË U HAPEN RRUGË PËR STUDIM NË SUEDI

Në përpjekjet për zgjerim të partneritetit ndërkombëtar, UBT-ja, si institucion i arsimit të lartë ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Lieveeus të Suedisë.

Ky universitet vlerësohet ndër më prestigjiozët, jo vetëm në Suedi, por dhe në Evropë.

Marrëveshja e arritur u mundëson studentëve që t'i vazhdojnë studimet e tyre për një semestër ose 1 vit akademik, në disiplina të ndryshme shkencore.

Po ashtu, marrëveshja u mundëson studentëve të UBT-së që kanë përfunduar një cikël studimesh në UBT, që ta vazhdojnë pjesën tjetër në Universitetin Linnaeus. Me marrëveshjen e sipërhënuar, UBT-së i mundësohet edhe ofrimi i studimeve të doktoratës në bashkëpunim me profesorë nga Universiteti Linnaeus. Studentët e interesuar të UBT-së, më shumë informata rreth aplikimeve mund të marrin në Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare të UBT-së, numër 304, katë 3.



Marrëveshja u mundëson studentëve të UBT-së që kanë përfunduar një cikël studimesh në UBT, që ta vazhdojnë pjesën tjetër në Universitetin Linnaeus.

UBT LIDH MARRËVESHJE ME KENTUCKY UNIVERSITY

Edhe një marrëveshje e UBT-së me një universitet amerikan



Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të UBT-së, rektori i këtij institucioni të lartë arsimor në Kosovë, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka arritur edhe një marrëveshje bashkëpunimi me një universitet amerikan. Këtë herë, marrëveshja është arritur me universitetin e mirënjohur,

Kentucky University. Marrëveshja parasheh aktivitete të përbashkëta në fushën e hulumtimit dhe shkëmbimit të materialeve dhe publikimeve akademike.

Për më tepër, marrëveshja parasheh shkëmbim të stafit administrativ e akademik, si dhe të studentëve të studimeve në

nivelet Bachelor e Master. Si edhe disa marrëveshje të ngjashme me universitete të tjera, amerikane e evropiane, edhe kjo është arritur për 5 vjet, me mundësi vazhdimi. Marrëveshjet e këtilla i japin rast çdo studentit të UBT-së për të studiuar në shtetet më me traditë në rrafshin edukativo-arsimor.

SIPAS MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR NGA REKTORI HAJRIZI DHE MINISTRI SHALA

UBT e MKRS merren vesh për shkëmbime akademike e programe hulumtuese



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmodn Hajrizi dhe ministri Kujtim Shala, pas nënshkrimit të marrëveshjes

UBT-ja ka nënshkruar Memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe me Institutin Arkeologjik të Kosovës (IAK). Marrëveshja ka të bëjë me zhvillimin e programeve të bashkëpunimit në rrafshin e shkëmbimit akademik dhe në programe hulumtuese, ndërsa është nënshkruar midis rektorit të UBT-së, Edmond Hajrizi dhe ministrit të Kulturës, Kujtim Shala. Memorandumit parasheh shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapë-

sirave, që studentët e UBT-së të realizojnë punë praktike në MKRS e IAK, ndërsa UBT-ja në kuadër të programeve dhe trajnimeve t'u ofrojë mundësi participimi në përputhje me politikën e përcaktuara të institucionit. Sipas Memorandumit, UBT-ja i vë në dispozicion MKRS-së dhe IAK-ut programe dhe trajnime, që kanë për qëllim ngritjen dhe avancimin e stafit të tyre, në përputhje me një politikë të miratuar nga të dy palët paraprakisht. Ministri Shala e ka cilësuar Memorandumin si

hap të rëndësishëm në zhvillimin e raporteve midis institucioneve kulturore dhe të pavarura arsimore, në funksion avancimit të fushave të interesit të përbashkët dhe krijimit të mundësive dhe hapësirave për bashkëpunim. Edhe rektori i UBT-së, Hajrizi, e ka vlerësuar lart Memorandumin. "Ka domethënie të veçantë për UBT-në, sepse krijon mundësi për studentët t'ij dhe ofron mundësi për bashkëpunim të ndërsjellë në fushat specifike me institucionet përkatëse", ka thënë Hajrizi.

UBT-ja përpiqet që t'u hapë perspektivë të rinjve kosovarë

I përkushtuar për të qenë në nivel të edukimit të brezave të rinj, institucioni i lartë arsimor i Kosovës, UBT, ka aplikuar me programe atraktive në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

Madje, nga kjo e fundit, është kaluar me sukses faza e parë, e cila nënkupton aprovimin e Aplikacionit. Se përkushtimi i UBT-së ka të bëjë me përgatitjen e të rinjve për treg të punës, tregojnë edhe programet me të cilat është aplikuar, e që i përkasin dy niveleve të studimit Master (MA) dhe Bachelor (BA), si:

1. Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji – BA,
2. Infermieri – BA
3. Farmaci – BA
4. Dizajn i Integruar – BA
5. Inxhinieria Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura – MA
6. Shkenca Politike – MA dhe
7. Media dhe Komunikim – MA

Të gjitha këto përcillen me specializime përkatëse, ndërsa

shumica për herë të parë në Kosovë.

Edhe drejtimet pasuniversitare, në tri drejtimet e fundit, u krijojnë mundësi studentëve që ta zhvillojnë karrierën shkencore dhe të jenë më të përgatitur për tregun e punës.

Për këto drejtime, UBT-ja ka përgatitur infrastrukturë moderne dhe staf akademik, të përgatitur nëpër universitete të njohura evropiane.



Studentët e UBT-së vizituan institucionet e drejtësisë

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit Juridik në UBT, janë pritur të premten në institucionet e drejtësisë kosovare: Gjykatën dhe Prokurorin, në Prishtinë.

Të udhëhequr nga ligjëruesi Lavdim Krasniqi, ata janë njoftuar me punët e gjyqësorit dhe

të prokurorisë, ndërsa kishin rastin të ishin pjesë e një seance gjyqësore, në të cilën janë njohur nga afër me procesin.

Studentët janë pritur nga gjyqtarë e prokurorë dhe nga stafi përcjellës i dy institucioneve.

KONFERENCA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT PRONËSORE INTELEKTUALE

UBT-JA E PËRKUSHTUAR PËR TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka thënë në Konferencën kombëtare për të Drejtat Pronësore Intelektuale, në Prishtinë, se UBT-ja është e përkushtuar në forcimin e ligjshmërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave pronësore intelektuale. Këtë konstatim, rektori Hajrizi e ka nxjerrë në Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, teksa ka folur për arritjet e UBT-së

prej themelimit, 15 vjet më parë, e deri në ditët e sotme. Ai ka prezantuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me universitetet e njohura rajonale, evropiane e ndërkombëtare, për sukseset e studentëve të UBT-së etj. Konferenca është organizuar nga Agjencia e Pronësisë Industriale, Zyra për të Drejtat e Autorit, Doganat e Kosovës dhe Policia e Kosovës, ndërsa kanë

marrë pjesë edhe ministri i Kulturës, Kujtim Shala, përfaqësues të tjerë të Qeverisë së Kosovës, të Zyrës për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, të Inspektoratit të Tregut të Kosovës etj.

Konferenca për pronësinë intelektuale ishte përqendruar në sistemin e pronësisë intelektuale në Kosovë, për arritjet e institucioneve si dhe për sfidat e tyre.

PANAIRI I EDUKIMIT NË PRISHTINË

UBT-ja në Panair, fokus i maturantëve për orientim studimi



Përfaqësuesit e UBT-së në këtë panair tregojnë për interesimin e madh të maturantëve dhe të studentëve për të studiuar në UBT, nga të gjitha rajonet e Kosovës

Ndërkohë që Panairi i edukimit që po mbahet për të dytën ditë me radhë, në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, përfaqësuesit e UBT-së në këtë panair tregojnë për interesimin e madh të maturantëve dhe të studentëve për të studiuar në UBT, nga të gjitha rajonet e Kosovës.

"Panairi po vazhdon edhe sot. Që nga orët e hershme të mëngjesit, po vërehet një interesim i madh nga maturantët e shkollave të ndryshme kosovare, që po na

vizitojnë", thotë përfaqësuesi i Qendrës së Karrierës në UBT, Halil Bashota. Ky theksoi se të interesuarve po u tregohen mundësi të mira në orientimin profesional, në dy nivelet e shkollimit, Bachelor dhe Master.

Panairi i edukimit informon gjithçka që ka të bëjë me shkollim të mëtutjeshëm të të interesuarve. Organizohet nga institucionet arsimore: Kosova, rajoni e Evropa, që të promovohen programet e studimeve.

Kompania "Ciao Berto" punëson studentë të UBT-së



ciaberto
www.ciaoberto.com

Udhëheqësi i marketingut në 'Ciao Berto', Arbër Racaj, shprehet të jetë i kënaqur me kualitetin e punës që e bëjnë studentët

Kompania më e madhe në Kosovë për prodhim dhe dizajn "Ciao Berto" ka punësuar një numër të konsiderueshëm të studentëve të UBT-së.

Studentja e arkitekturës në UBT, Gentiana Demaj, e ka nisur punën në këtë kompani dy muaj më parë. Ajo thotë se rrugën e punësimit ia kanë hapur njohuritë nga UBT-ja, ndërsa shton se njohuritë praktike në "Ciao Berto" e bëjnë të ndihet mjaft komode.

"Këtu po kemi qasje të drejtë-përdrejtë në prodhim dhe dizajn,

ndaj shumëçka që kemi mësuar në fakultet, po e shohim konkretisht këtu", ka thënë Demaj.

Edhe Egzona Mulliqi, studente e arkitekturës në UBT është e punësuar që 5 muaj në 'Ciao Berto'. Merret me punë administrative në kompani.

"Njohuritë e fituara në UBT dhe këtu në fushën e administrimit po më ndihmojnë shumë", ka thënë Mulliqi. Udhëheqësi i marketingut në 'Ciao Berto', Arbër Racaj, shprehet të jetë i kënaqur me kualitetin e punës që e bëjnë studentët. "Punëto-

ret tona, të shkolluara në UBT, e njohin punën dhe po e kryejnë me përgjegjësi të lartë atë", ka thënë Racaj. Statistikat tregojnë se mbi 90 për qind e studentëve që kanë mbaruar studimet në UBT kanë gjetur vende të punës.

Ky është treguesi më i saktë se programet e UBT-së harmonizohen plotësisht me tregun e punës.

Punësimi i studentëve të UBT-së nga "Ciao Berto", faktori edhe më shumë përshtatjen e programeve të UBT-së me tregun kosovar të punës.

FAKULTETIT MENAXHMENT BIZNES DHE EKONOMI

Dy studente të UBT-së marrin titujt Master në Menaxhment Biznes dhe Ekonomi

Blerta Gërguri – Grajçevci dhe Zana Baraku, janë dy studente të UBT-së, që brenda dy muajve kanë marrë titujt Master shkence në këtë institucion të arsimit të lartë.

Që të dyja i përkasin Fakultetit Menaxhment Biznes dhe Ekonomi (MBE). Mentor i tyre ishte, dr. Sc. Ylber Limani, njëherësh dekan i MBE-së.

Studentja Blerta Gërguri-Grajçevci ka mbrojtur temën: "Menaxhimi i institucioneve shëndetësore publike – përcaktimi i kriterëve për menaxhim strategjik të QKUK-së".

Sipas mentorit Limani, hulumtimi ka për qëllim përcaktimin e strategjive për zhvillimin afatgjatë të institucionit shëndetësor, me fokus në zhvillimin e

kapaciteteve për përmirësimin e kualitetit e të kujdesit shëndetësor për të gjithë qytetarët.

"Ky është një proces që duhet të integrojë sektorin publik dhe atë privat, që të krijohen kushte më të mira për zhvillimin shëndetësor dhe punësimin", ka thënë Limani rreth temës.

Studentja tjetër, Zana Baraku, ndërkaq, ka mbrojtur temën:

"Ekselencia e Biznesit: Roli i Liderimit në Implementimin e Strategjisë".

Për këtë temë, profesor Limani thotë se është ngritur një debat akademik e biznesor në nivel botëror.

"Në Kosovë është fillimi i hulumtimit të mundësive të ngritjes e zhvillimit të liderimit në biznes, si dhe ngri-

tjes së aftësive për zhvillim dhe implementim të suksesshëm të strategjisë së biznesit", është shprehur Limani, sipas të cilit kontributi qëndron tek argumentimi i nevojës që ka liderhipi në organizatat kosovare, për të njohur proceset organizative dhe për të orientuar diturinë e eksperiencën në rezultate më të mira në biznes.

KONFERENCA DYDITORE NDËRKOMBËTARE
"DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE 2016"



Rektori Hajrizi kërkon bashkëpunim rajonal të institucioneve të arsimit të lartë, në fushën e shkencës dhe inovacionit

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka kërkuar më shumë bashkëpunim midis institucioneve rajonale të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor, për të krijuar kapacitete dhe infrastrukturë të konkurrenceshme me rajonet e tjera në Evropën Juglindore.

Këtë kërkesë, Hajrizi e ka shfaqur në Tiranë, në fund të kësaj jave, në konferencën dyditore ndërkombëtare: "Ditët e studimeve shqiptare 2016", ku ka referuar me temën: "Shkenca dhe inovacioni në Evropën Juglindore".

UBT-ja, bashkë me Universitetin e Evropës Juglindore, ishte partner kryesor e kësaj Konference, të organizuar nga UET në Tiranë.

Në Konferencë, me punime shkencore janë paraqitur 40 personalitete akademike, nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. "Dizajnimi dhe menaxhimi i institucioneve të larta duhet të mbështet në praktikën më të mira, për t'u përballur me sfidat e teknologjisë, shkencës dhe inovacionit", ka thënë Hajrizi, teksa ka shtuar se kjo duhet bërë me qëllim të përshatjes së sfidave që po vijnë nga teknologjia e reja.

Në paraqitje, rektori Hajrizi ka treguar se UBT-ja është duke zhvilluar projekte të suksesshme, siç është shprehur ai, "që të përballemi me trendët dhe me frymën e teknologjive të reja".

Studentet e UBT-së, fituese në «Ekspo Stil Arki ASA»



Studentet e vitit të tretë të Arkitekturës në UBT, Dega në Ferizaj: Hatixhe Hoxha, Fatlinda Jusufi, Festina Avdiu, Shpresë Kamberi dhe Gentiana Gërbeshi, janë fitueset e vendit të parë në projektin "EmigratiON-OFF". Pro-

jehti është paraqitur, në Tiranë, në fillim të muajit, në Festivalin ndërkombëtar të arteve pamore, stilit dhe arkitekturës "Ekspo Stil Arki ASA". Në këtë ekspozitë kanë marrë pjesë 120 përfaqësues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

U PREZANTUA HULUMTIMI "PAVARËSIA DHE BESUESHMËRIA E MEDIAVE NË KOSOVË"



QYTETARËT DUAN MEDIA TË PAVARURA DHE PROFESIONALE

Në vazhdim të hulumtimeve në fushën e medias në Kosovë, UBT dhe Instituti i Medias i Kosovë (IMK) prezantuan sot hulumtimin "Pavarësia dhe besueshmëria e mediave", që paraqet fazën e dytë të një hulumtimi më gjithëpërfshirës, pjesa e parë e të cilit është prezantuar vitin e kaluar, ndërsa hulumtimi do të vazhdojë edhe muajt në vijim.

Hulumtimi u prezantua në kuadër të shënimit të Ditës Botërore e Lirisë së Shtypit.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi dhe kreu i IMK-së, Fazli Veliu paraqitën të gjeturat e raportit, duke thënë se ai paraqet gjendjen e medias në Kosovë sot, me të gjitha specifikat e veta, të nxjerra nga anketimi i 1000 qytetarëve, të të gjitha moshave e përgatitjeve profesionale dhe në të gjitha rajonet e Kosovës (51.5 % mjedise urbane, 48.5 % mjedise rurale, si dhe 52 për qind meshkuj e 48 për qind femra).

Rezultatet e anketimit tregojnë se 72.6% e qytetarëve lexojnë ose shikojnë/dëgjojnë informacione nga me-

diat, ndërsa pjesa tjetër (22.9 %) është deklaruar se nuk ka interesim për mediat.

Sipas përgjigjeve, qytetarët informohen më së shumti nga televizioni, 74.4%, 56% nga interneti, 14.6% nga gazetatat, 10.1 % nga radiot dhe 1% nga burime të tjera.

Emisionet më të përcjella janë lajmet - 31%, emisionet politike 11%, ato të kulturës 16%, të sportit 20.4%, të muzikës 19% dhe të tjera 31%

Të pyetur sa ju besojnë mediave kosovare (TV e radio), përgjigjet janë këto: mesatarisht 59.5 %, pak 25.5%, aspak 8.7%6. Ndërsa mediave online (portaleve e rrjeteve sociale) mesatarisht u besojnë 48%, pak 33.3% dhe aspak 14.7%

E sa i takon pyetjes a besoni se ka media të pavarura/të lira në Kosovë, përgjigjet janë këto: mesatarisht besoj 44.5%, Po 13.7%, Jo 18.8%, nuk kam përgjigje 23.1% Ndërsa, kur janë pyetur se cilat media kanë pavarësi/liri më të lartë, ata kanë përmendur rrjetet sociale (32.7%), televizionet (31.5%), portalet online (22.8%),

radiot (11.9%). Ndërsa, kur janë pyetur çka duhet bërë më shumë mediat, që të rritet besueshmëria e qytetarëve kosovarë ndaj tyre, të anketuar kanë preferuar që mediat kanë privatësi/ liri të plotë nga subjektet e ndryshme; të jenë profesionale në dhënie e lajmit; të kenë qasje gjithëpërfshirëse, si dhe të ofrojnë më shumë programe edukative kulturore.

Pas prezantimit të raportit, u zhvillua një debat i gjerë lidhur me të gjeturat e raportit, por edhe aspekte të ndryshme të zhvillimit të medias, në kushtet e zhvillimeve teknologjike dhe ndryshimeve rrënjësore që media ka pësuar dhe po pëson çdo ditë e më shumë. Dita Botërore e Lirisë së Shtypit festohet çdo vit, anë e mbanë botës, me 3 Maj. Ky, sipas Kombeve të Bashkuara, është një rast për të nënvizuar parimet themelore të lirisë së shtypit, si edhe për të vlerësuar lirinë e shtypit anë e mbanë botës, për të mbrojtur mediat nga sulmet ndaj pavarësisë së tyre dhe për të nderuar gazetarët të cilët kanë humbur jetën duke kryer detyrën e tyre.

Studentët e Arkitekturës prezantuan punimet nga lënda Projektimi Arkitektonik 1

Në UBT u organizua ceremonia e prezantimit të punimeve të studentëve të vitit të parë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në lëndën Projektimi Arkitektonik 1. Para profesorit të lëndës, Dr. Lulzim Beqiri dhe

asistenteve Mimoza Sylejmani, Rineta Jashari dhe Safete Veliu, punimet e tyre i prezantuan 130 studentë. Punimet kanë përfshirë analizat e shtëpive të banimit individual në Kosovë dhe janë hulumtime individuale të studentëve.



DREJTUES TË ORGANIZATËS 'PANEUROPA' MBAJTËN LIGJËRATË NË UBT

KOSOVA JEP MUNDËSI TË MËDHA PËR FUQIZIMIN E BASHKIMIT EVROPIAN

Habock e Jauernik, kanë shfaqur bindjen se për këtë arsye, Kosova, jo vetëm që duhet të bëhet pjesë e BE-së, por është e drejtë e patjetërsueshme e saj që të kërkojë me ngulm që ky proces të përshpejtojë

Stefan Habock, udhëheqës i organizatës 'Paneuropa' dhe Philip Stephan Jauernik, menaxher i të njëjtës organizatë, janë shprehur të befasuar në kuptimin më të mirë të fjalës për gjërat e reja që e karakterizojnë Kosovën. Ata, gjatë një ligjërate që e kanë mbajtur para dhjetëra studentëve të UBT-së, në objektin e kësaj të fundit, të premten, kanë thënë se duke qenë si shteti më i ri dhe me popullsinë më të re në Evropë, Kosova ka mundësi për të dhënë kontribut të madh në zhvillimin dhe fuqizimin e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuptim, Habock e Jauernik, kanë shfaqur bindjen se për këtë arsye, Kosova, jo vetëm që duhet të bëhet pjesë e BE-së, por është e drejtë e patjetërsueshme e saj që të kërkojë me ngulm që ky proces të përshpejtojë.

Të gjitha këto, dy mysafirët austriakë, i kanë thënë në ligjëratën e mbajtur, pas një diskutimi proevropian të rektorit të UBT-së, Edmond Hajrizi.

"Integrimi evropian i Kosovës dhe shoqërisë së saj është bazë për zhvillim të gjithmbarshëm",



ka thënë Hajrizi. Edhe mysafirët, gjithashtu, kanë thënë se Kosova si shtet i pavarësuar duhet të bëhet pjesë e familjes evropiane, ndonëse sipas tyre, disa shtete janë kundër një hapi të tillë. Sidoqoftë, Habock e Jauernik, shprehën se me Kosovën në BE edhe më lehtë do të mund të luftohen dukuritë negative që e prishin stabilitetin e Evropës. Duke folur për lëvizjen e lirë në Evropë, Jauernik ka theksuar se duhet për të bërë më shumë. "Këtij populli të ri i mungon e drejta elementare, i mungon liria e lëvizjes dhe kjo gjë duhet të ndryshojë", ka thënë ai. Jauer-

nik është shfaqur edhe me kritika ndaj gjendjes së përgjithshme politike në Evropë, ndërsa këtë përgjegjësi ia ka adresuar elitës politike evropiane, korrupsionit dhe urrejtjes mes popujve. Krejt këto, sipas tij, po ndikojnë në nivelin e jetës së banorëve të pafajshëm në Kosovë, të cilët kanë sakrifikuar çdo gjë për të qenë të lirë dhe prapë po u mohohet kjo e drejtë. Stefan Habock, ndërkaq, ka theksuar se e ka përcjellë gjendjen në Kosovë, që nga lufta e fundit, ndaj e vlerëson shumë kontributin e popullit të saj, siç shprehet ai, "për gjithçka që kanë sakrifikuar gjatë

gjithë këtyre viteve". "Me atë që keni bërë dhe arritur, populli juaj ka fituar respektin tim", theksoi ai, duke iu drejtuar profesorëve dhe studentëve të pranishëm në sallë. Habock shpjegoi se synimi i tij më i madh është që të organizojë konferenca të mëdha të rinjve, pjesë e të cilave do të jenë popujt e të gjitha vendeve të Evropës, duke përfshirë edhe atë nga Kosova. Sipas tij, kjo do të bëhet me qëllim që vende të ndryshme të fuqizohen dhe të jenë pjesë, jo vetëm e kulturës, por edhe e politikës evropiane. "Evropa është shtëpia jonë dhe

ne duhet të punojmë shumë që të rrisim cilësinë e jetës këtu", ka shtuar ai, duke vlerësuar se edhe Austria nuk ka bërë mjaftueshëm për kosovarët. Por, siç është shprehur ai, me ndihmën e qytetarëve të Kosovës, kosovarët do t'i tregojnë Evropës dhe botës se janë njerëz të mrekullueshëm dhe punëtorë. "Përparësia e popullit tuaj është se ju si njerëz të rinj, keni mundësinë t'i tregoni botës anën tuaj më të mirë", u ka thënë Habock studentëve, teksa bashkë me Jarnikun i janë përgjigjur interesimeve të studentëve dhe ligjëruesve për temën e ligjëruar.

UBT UA MUNDËSON STUDIMIN NË MOREHEAD UNIVERSITY 50 STUDENTËVE



Një marrëveshje e rektorit, prof. dr. Edmond Hajrizi, me përfaqësues të universitetit amerikan, Morehead State University, krijon mundësi që në periudhën 5-vjeçare, 50 studentë të UBT-së të studiojnë në këtë universitet.

Marrëveshja përfshin periudhën 2016-2021, me mundësi vazhdimi. Ajo parasheh që për çdo vit në këtë universitet amerikan të studiojnë 10 studentë.

Për studentët e UBT-së, që i vazhdojnë studimet për një vit akademik ose për një semestër në Morehead University, do të ndahet një bursë prej 4000 dollarësh.

Edhe studentët e Morehead University do të kenë mundësi që një pjesë të studimeve t'i bëjnë

në UBT. Marrëveshja parasheh edhe rastet kur studentët e UBT-së duan që një cikël të studimeve ta përfundojnë në Morehead University. Atyre u jepet përparësi në regjistrim. Pos shkëmbimit të studentëve, marrëveshja parasheh edhe zhvillim të përbashkët të shkollave verore, vizita të ndërsjella, me qëllim të zhvillimit akademik dhe profesional të stafit e të studenteve të institucioneve gjegjëse, si dhe dizajnimin e kurrikulave dhe programeve të reja të studimeve. Do theksuar se UBT është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë, i cili çdo vit pranon studentë ndërkombëtarë, të cilëve u ofron studime të plota në gjuhën angleze.



RRETH 50 STUDENTË TË ARKITEKTURËS NË UBT QËNDRUAN PËR VIZITË STUDIMORE NË TIRANË

Në vazhdën e vizitave studimore, fundjavën që shkoi studentët të Fakultetit të Arkitekturës në UBT qëndruan për vizitë studimore në Tiranë. Rreth 50 studentë të këtij

fakulteti, në vizitën e sponsoruar nga UBT, të organizuar nga MSc. Blerta Vula dhe të shoqëruar nga Dr. Aghan Bajmaku, vizituan Aeroportin e Tiranës, Zyrrat qendrore

të Vodafone Albania dhe Parkun e Biznesit të Tiranës. Studentët u njohën nga afër me strukturën ndërtimore dhe operative të institucioneve të lartpërmendura.

NË CEREMONINË GALA TË ALBANIAN ICT AWARDS NË TIRANË

STUDENTËT E UBT-SË TRIUMFOJNË ME SUKSESE NË ALBANIAN ICT AWARDS IV

Dy studentë të UBT-së, Florian Piraj dhe Lum Gashi, janë shpallur fitues të çmimit "Inovacioni i vitit", në ceremoninë Gala të Albanian ICT Awards, në Tiranë, e cila u organizua për të katërtin vit me radhë. Ata kanë fituar me produktin e tyre "Formon Core". Kompania "Formon", pjesë e të cilës janë Piraj dhe Gashi, është themeluar në mars 2015, ndërsa është prodhuesi i parë rajonal i produkteve hardverike në fushën e Industrisë 3D. Qëllimi kryesor i Formon-it është që të ndërtojë mjete më të thjeshta, që e bëjnë procesin krijues sa më të lehtë dhe më të thjeshtë për të gjithë përdoruesit. "Formon Core", pra, është produkti

cili krijon objekte tredimensionale, duke e nxjerrë plastikën shtresë pas shtresë dhe me rezolucion të lartë. Kjo arrihet nëpërmjet softuerit "Scope", i zhvilluar nga "Formon", i lehtë për t'u përdorur dhe kompatibil për sisteme të ndryshme operative. Po ashtu, ka mundësi lidhjeje me Wi-Fi, i integruar në pllakën elektronike.

Porositë për Printerin 3D "Formon Core" kanë filluar tashmë, kurse produkti do të dalë në tregës shpejt. Një tjetër përparësi e këtij produkti është edhe çmimi dukshëm më i lirë se konkurrentët ndërkombëtarë.

Studenti tjetër i UBT-së, Leutrim Berisha, ndërkaq, ka fituar nga Albanian ICT Awards mirënjohjen

"Hakerat e bardhë". Kjo për shkak se Berisha kishte marrë një set çmimesh nga NASA, Pentagon dhe Google, si kontribuues në sigurinë kibernetike të këtyre organizatave.

Do theksuar se një vit më parë, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi e kishte marrë çmimin Akademiku i vitit, pikërisht nga Albanian ICT Awards. Vjet, çmime kishin fituar edhe disa studentë të UBT-së.

UBT-ja ka sponsoruar ngjarjen, duke i mbështetur me bursa studimi në UBT, dy studentët fitues.



UBT Executive Academy organizoi sesion informues për Google Summer of Code

UBT Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional për studentët e UBT-së dhe të tjerë organizoi sesionin informues për mundësitë e aplikimit në Google Summer of Code. Në këtë sesion informues, pjesëmarrësit u njoftuan konkre-

tisht për projektet dhe idetë me të cilat mund të aplikojnë dhe të jenë pjesë e internshipit veror nga google me mundësi të përfitimit të stipendimit që ofrohet nga google dhe partnerët e saj. Shkurtimisht studentët gjithashtu edhe u trajnuan për

formën e aplikimit dhe kërkesat që duhet plotësuar për të marrë pjesë. Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional do të jetë në dispozicion të studentëve të interesuar për t'ju ndihmuar gjatë fazës së aplikimit dhe më pastaj zhvillimit të projektit.



Vazhdojnë trajnimet në fushën e teknologjisë informative dhe të telekomunikimit

Akademia Ekzekutive e UBT-së për Zhvillim Profesional ka vazhduar me grupin e radhës për trajnimin në fushën e teknologjisë informative dhe të telekomunikimit, respektivisht në trajnimin për zhvillim dhe dizajnim të webit. Këtë radhë, një interesim i madh ka qenë nga kandidatët që vijnë nga industria e teknologjisë

informative, respektivisht individë të punësuar në fushat përkatëse. Pjesëmarrësit në trajnim do të aftësohen për mënyrën e dizajnit të ueb-faqeve, përdorimit të HTML 5 dhe CSS3, si dhe instalimin, konfigurimin dhe përdorimin e platformave të gatshme për menaxhim të përmbajtjeve (CMS), siç është Wordpress. Pjesëmarrë-

sit në trajnime janë nga profile të ndryshme, gjë që e bën trajnimin më atraktiv me diskutimet dhe idetë që do të dalin gjatë projekteve të tyre. UBT është e përkushtuar që të ofroj mundësitë e zhvillimit profesional për të gjithë të interesuarit në qendrat e tij në Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe në Kampusin Inovativ në Lipjan. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen testit dhe do të pajisen me certifikata

SUKSESE TË STUDENTËVE TË UBT-SË

Studentja Arta Rrustemi, nga UBT me bursë në Universitetin Humboldt në Berlin

Studentja e UBT-së, Arta Rrustemi, pasi ka fituar bursën e programit Erasmus, po i vazhdon studimet njëvjeçare në Universitetin Humboldt në Berlin të Gjermanisë. "Ky vit është një sfidë për mua, por përgatitja në UBT ishte e mjaftueshme dhe mësimdhënia nuk ka shumë dallim. E çmoj ligjërimin në UBT dhe i gëzohem kthimit pas kësaj eksperience", thekson Arta. Përmes një shkrimi të saj të shkurtër, Arta prezanton përvojën e saj: Ditën e arritjes në Berlin ishte një ditë e ftohtë vjeshte. Para se të mbaroj vitin e parë, mora

lajmin se kisha fituar bursën e programit Erasmus, që do të me mundësonte studimin njëvjeçar në Universitetin Humboldt. Isha e emocionuar, edhe pse nuk ishte hera e parë që isha në Kryeqytetin (dikur të ndarë) gjerman. Berlini është një vend me përditshmëri dinamike dhe ndër qytetet më të mira për jetën studentore. Kur arrita në Berlin, studentët e tjerë të Programit Erasmus ishin përgatitur për të dalë. Jeta e natës në Berlin është shumë argëtuese. Kreuzberg, K' Dum, Warschauer Strasse, e Mitte janë të mbushura me njerëz. Në krahasim me Prishtinën, të

rinjtë e Berlinit vishen shumë më thjesht dhe në klubet e natës nuk ka asnjë kod veshjeje. Tash jam e dashuruar në stilin e jetës së Berlinit. Për ta zbuluar Berlinin ka shumë vende historike e kulturore. Universiteti Humboldt, aty ku i ndjek ligjëratat, është mahnitës. Ndërtesat e Universitetit gjenden në qendër të qytetit. Koncepti i Universitetit Humboldt është krijuar 200 vite më parë. Wilhelm von Humboldt ka pasur për qëllim të bëjë unifikimin e hulumtimit dhe mësimdhënies, të krijojë realitetin e arsimit gjithëpërfshirës për studentët. Edhe pas 200



UBT nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Komunën e Vushtrrisë

UBT po vazhdon më përkrahjen e komunave të Kosovës, në fusha të ndryshme. Në këtë vazhdë, këto ditë, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i komunës së Vushtrrisë, Bajram Mulaku kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, me qëllim që të zhvillojnë programe bashkëpunimi dhe shkëmbimi për ngritje të kapaciteteve profesionale si dhe programe hulumtuese. Rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi tha se kjo Marrëveshje është e bazuar në parimin e interesit të ndërsjellë për përfitim të të dyja institucioneve,

duke respektuar pavarësinë e njëri-tjetrit dhe ka për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapësirave që studentët e UBT-së të realizojnë punën praktike në Komunën e Vushtrrisë, gjithnjë sipas planit të paraparë në programin e lëndëve përkatëse. Ndërkaq, i pari i Vushtrrisë është shprehur i kënaqur që përmes kësaj marrëveshjeje Komuna e Vushtrrisë do të ketë në dispozicion programe dhe trajnime nga UBT-ja, të cilat kanë për qëllim ngritjen dhe avancimin e stafit komunal në përputhje me një politikë të avancuar.



Arta Rrustemi

QENDRA E KARRIERËS E UBT – NDËRLIDHJE E FORTË MES STUDENTIT DHE INDUSTRIJË

Qendra e Karrierës në UBT është themeluar si një ndër qendrat e para në vend, dhe në rajon, me qëllim që t'i shërbejë studentëve nga dita e parë e studimeve deri në përfundim. Qendra kryesisht merret me zhvillimin dhe orientimin profesional të studentëve duke e ndërlidhur universitetin me tregun e punës dhe industrinë, ku përmes shërbimeve siç janë: informimi dhe orientimi profesional, praktikat e punës, vizitat studimore, ligjëratat tematike si dhe zhvillimi profesional apo trajnimet për t'i mundësuar atyre që të përgatiten sa më mirë për një të ardhme të sigurt, si për punësim ashtu dhe për jetë. Halil Bashota, udhëheqës i Qendrës së Karrierës në UBT, tha se kjo qendër ka realizuar me sukses internshpinin e studentëve, ku një numër i madh i studentëve ndjekin programet e zhvillimit profesional. "Deri më tani ne në UBT kemi arritur të ofrojmë industrinë me universitetin përmes marrëveshjeve të shumta me kompani dhe biznese publike e private, me qëllim që ta ofrojmë universitetin sa më afër industrisë. Ndaj, sot, falë këtyre bashkëpunimeve, për kaq shumë vite, Qendra e Karrierës ka realizuar me sukses internshpinin e studentëve, që në disa programe të studimit 100 për qind e studentëve kryejnë praktikën profesionale, një numër shumë i madh i studentëve ndjekin programet e zhvillimit profesional dhe trajnimeve të ndryshme, ku krahas procesit akademik, studentët përgatitën edhe me shkathtësi për punë", pohoi Bashota. Po ashtu, sipas Bashotës, në UBT numri i studentëve që punësohen po rri-



"Deri më tani ne në UBT kemi arritur të ofrojmë industrinë me universitetin përmes marrëveshjeve të shumta me kompani dhe biznese publike e private, me qëllim që ta ofrojmë universitetin sa më afër industrisë. Ndaj, sot, falë këtyre bashkëpunimeve, për kaq shumë vite, Qendra e Karrierës ka realizuar me sukses internshpinin e studentëve...", thotë ndër të tjera Bashota

tet çdo vit. Studentët punësohen përmes Qendrës së Karrierës, si dhe përmes rrugëve të rekrutimit të rregullt. Deri më tani kanë një numër të madh të studentëve që kanë gjetur punë përmes nesh. Me të ardhur në qendër, ata janë udhëzuar se si të aplikohet. "Vlen t'i cekim dy kompani të cilat procesin e rekrutimit e kanë bërë bashkë me Qendrën e Karrierës. Pra, janë kompania "Buçaj" dhe kompania "Justpost", si një shembull i shkël-

qyer i bashkëpunimit të mirë në mes universitetit dhe industrisë. Në rastin në fjalë, studentët janë testuar dhe intervistuar nga një panel i përbërë nga përfaqësuesit e kompanisë dhe të universitetit", u shpreh Bashota. Gjithashtu, ai ka theksuar se UBT ka dy forma për mundësinë e intershipit për studentët. "Ne kemi dy forma të intershipit: internshpinin e mentoruar dhe internshpinin e lirë. Formën e parë të intershipit e

kemi në disa fakultete, ku studentët e kanë lëndën internshpinin dhe e kanë obligative ta kryejnë një praktikë të tillë. Në këto programe shkalla e realizimit shkon në 100 për qind, të gjithë studentëve u jepet një mundësi e tillë. Një shembull në këtë pjesë është Arkitektura" theksoi ai derisa shtoi se çdo student kryen një praktikë 12-javore në semestrin e fundit, për të cilën edhe mentorohet. Ndërsa forma e dytë e intershipit, për-

cillet nga Qendra e Karrierës. Sipas Bashotës Qendra e Karrierës vazhdimisht ka marrë pjesë në panairët e organizuara në Kosovë dhe jashtë saj. Është pjesëmarrëse e rregullt në Panairin e Edukimit, i cili organizohet në Prishtinë dhe në Tiranë, në Panairin e Punës, si dhe në panairët e tjera jashtë shtetit, që kanë të bëjnë me materialet ndërtimore, teknologjisë dhe inovacionit. "Në Panairin e Edukimit ne kemi prezantuar ofertat tona akademike për të rinjtë në Kosovë, duke sjellë përherë programe të reja dhe atraktive. Edhe në panairin e fundit të organizuar në prill të këtij viti, ne kemi pasur risi të shumta, atraktivitetin e të cilave e tregojmë më së miri interesimi shumë i madh i të rinjve për të na vizituar", tha Bashota. Bashota ka folur edhe për projektin e madh të Qendrës së Karrierës, që është realizuar në shkollat e mesme të Kosovës, ku janë ofruar disa ligjëratat për të orientuar nxënësit për karrierën e tyre të mëtejshme dhe atë se çfarë kërkon industria e vendit. "Sikurse edhe viteve të tjera, por veçanërisht këtë vit, ne kemi realizuar një nga projektet më të mëdha të orientimit në karrierë për të gjithë të rinjtë maturantë të kësaj gjenerate. Pra, projekti është realizuar në 92 për qind të shkollave të mesme, ku nxënësit u janë ofruar ligjëratat mbi orientimin në karrierë, këshillime profesionale mbi kërkesat e tregut të punës, shkathtësitë që i kërkon industria, si dhe mundësitë e studimit në programe të reja dhe inovative, të cilat kanë rezultuar me sukses dhe oferta e UBT-së është pritur shumë mirë". Besart Troshupa

Ligjëratë tematike e arkitektes Aslihan Demirtas



Një ligjëratë tematike, organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës, mbajtur në UBT nga arkitektja Aslihan Demirtas, është përcjellë me interesim të madh nga rreth 200 studentë. Ligjëratat kishte në fokus komunitetin dhe qasjen e përbashkët të tij në vendimmar-

rje, nëpërmjet pyetjeve: Si mund të ndërtojmë së bashku, cilat janë mënyrat dhe proceset e tjera për të krijuar hapësira të përbashkëta që mund të përfshijnë gëzimin e të qenit ndryshe etj. Është folur për rolin e arkitektit në publik, për kopshtet urbane të perimeve,

për stacione të autobusëve, për strehimore gjysmë të projektuar dhe të gjysmëlëna dhe të ngjashme. Në ligjëratë është përdorur edhe imagjinata, si ta zëmë kthimin në jetë të një kinemaje të braktisur, krejt më qëllim të konkretizimit të ligjëratës.



TRAJTESË

PROF. ARDIAN GOJANI

Komunikimi i arritjeve në fizikë për një publik të gjerë është shumë i vështirë, sepse vetë fizika është e vështirë. Nuk e kam fjalën vetëm për risitë, që po bëhen gjithnjë e më të pakuptueshme, por për një rreth të ngushtë specialistësh, por edhe për gjërat që dihen prej qindra vjetësh. Për shembull, një gjë që na ka mësuar Galileu shumë moti është se gjuha e natyrës është matematika, e gërmat e kësaj gjuhe janë rrrathët, trekëndëshat, e figurat e tjera gjeometrike. Por, sa nga ne do ta kuptonim natyrën po të na prezantohej si një bashkësi rrrathësh e figurash? Apo, nga ana tjetër, sa nga ne i qasemi natyrës me këto germa? Komunikimi i fizikës, apo i shkencës në përgjithësi, është i domosdoshëm, dhe atë jo vetëm për arsye utilitare: me të vërtetë, vazhdimisht na duhet të marrim vendime që është dashur të ndikohen nga shkenca, si për shembull a më bëjnë dëm këto barna, a e ndot ambientin nëse e lë kompjuterin ndezur, e për qëllime të tjera praktike si këto. Por, më me rëndësi është se fizika bëhet për të treguar diçka. Ka metafora të shumta që e shpjegojnë atë njohuri të mbledhur dhe të sistemuar në fizikë a shkencë. Njutoni e ka përdorur idenë e oqeanit të së vërtetës kur ka folur për këtë, kurse Fajnmene ka thënë që ne po mundohemi t'i kuptojmë rregullat e një loje shahu, që luhet nga zotat. Edhe ideja e natyrës si një libër nuk është e re. Mbetet që shkencëtarët, ta lexojnë natyrën dhe ta ndërtojnë narrativën për ta treguar atë. Metafora e tregimit për fizikën e ka një të mirë të madhe, e ajo është që e shkud konceptin e fizikës si përmbledhje faktesh në vakum. Pas çdo fakti gjendet një kontekst, në të cilin ai fakt gjallërohet dhe përdoret, e rrjedhimisht edhe prodhon mundësi për njohje të re. Për shembull, fakti që shpejtësia e dritës është 300 milionë metra në sekondë nuk thotë asgjë, po të mos përcillet me të dhënat e tjera, përfshirë edhe atë se kjo shpejtësi nuk ndryshon, pa marrë parasysh rrethanat. Konteksti i shtuar tash sjell njohuri të reja; në rastin konkret, ajo njohuri e re u ndërtaua si teoria e relativitetit. Skena ku zhvillohet tregimi i fizikës është vetë natyra, gjithësia apo pjesë të veçanta të saj, disa më të mëdha, si galaktika, Dielli a Toka, e disa më të vogla, si molekulat, atomet, apo edhe vetë bërthama e atomit. Çdo pjesë e kësaj scene është e lidhur në mënyrë shumë intime me pjesët e tjera të tregimit. A nuk është interesante që procesi i fuzionit nuklear - bashkimi i dy bërthamave atomike që e formojnë një të re dhe lirojnë energjinë - shpjegon Diellin, energjinë që rrezaton trupi më i madh qiellor në afërsinë tonë? Kurse, personazhet janë nga më interesantët që mund të imagjinohen: lëvizja, drita, fushat fizike, probabiliteti, informata, atomi, elektroni, kuarqet, etj. Narrativi i fizikës zhvillohet asisoj që të arrihet te

TREGIMI MË I MAHNITSHËM

Fizika është tregimi që e kemi formuluar për të shpjeguar natyrën. Jam i sigurt që edhe ne mund të tregojmë, duhet të tregojmë diçka, sepse ja kemi borxh botës dhe vetes.

të kuptuarit e karakterit të këtyre personazheve. Por duhet pasur kujdes, sepse ndonjë shpesh mendojmë që më në fund e kemi kuptuar karakterin e një personazhi, ai ndryshon, ndonjëherë edhe në mënyrë drastike. Kuptimi i lëvizjes shërben si një shembull i mirë për këtë. Në antikë është menduar se lëvizja rrethore është më e përkryera, më e thjeshta, më e bukura, dhe, çka është me shumë rëndësi, e pafundmja (kujto që rrethi nuk ka as fillim e as mbarim). Kjo është lëvizja që e bëjnë trupat qiellore, pra, zhvillohet në qiell, në vendin ku jetojnë zotat. Kurse, lëvizja drejtvizore kishte një karakter më të ulët, bëhej në tokë, nga trupa të zakonshëm, kishte një fillim e një fund. Sot e dimë që për të realizuar lëvizjen rrethore një trup, është i domosdoshëm bashkëveprimi i tij me një trup tjetër. Në rastin e trupave qiellore ai bashkëveprim sigurohet nga fusha e gravitetit, kurse në rastin e vërtitjes së një guri mbi kokë, atë bashkëveprim e siguron fija e perit me të cilin e kemi lidhur gurin. Po të mos ishte peri, guri do të hidhej sipas një vije të drejtë. Pra, lëvizja në rreth jo vetëm që është e kufizuar në hapësirë (rrethi e ka një perimetër të caktuar), por edhe në kohë, sepse ajo lëvizje përfundon pasi të ndërpritet bashkëveprimi. Galileo e gjeti që lëvizja që ka karakter të përkryer, është ajo e njëtrajtshmja drejtvizore, pra, lëvizja me shpejtësi konstante dhe në vijë të drejtë. Kjo ishte lëvizja e pafundme, më e thjeshta dhe më e bukura. Rrjedhimisht, çdo shmangie nga lëvizja e njëtrajtshme drejtvizore dëshmon për bashkëveprimin e trupit me një trup tjetër. Dhe, shih tash, mu si nëpër tregime detektivësh, lëvizja vijepërkulur është gjurmë për një bashkëveprim dhe në moment e kuptojmë që në terr, aty ku nuk shohim, gjendet diçka. (Po të mos kishte diçka, lëvizja do të ishte drejtvizore, pra.)

Lëvizja e njëtrajtshme drejtvizore nuk ekziston në natyrë, por shumë lëvizje mund të përafrohen dhe konsiderohen si të tilla. Përafrimi është veti kyçe e fizikës, sepse nuk ka asnjë ligj që nuk është përfutur përmes përafrimit. Po të mos ishte përafrimi, paradoksi i Zenos nuk do të kishte zgjidhje, Akili nuk do ta mbërrinte breshkën dhe lëvizja - çfarëdo lëvizje - nuk do të ekzistonte. Për ata që nuk e dinë, historia e Akilit, një djaloshi këmbësh-pejtë, dhe breshkës synon të tregojë se lëvizja është iluzion, sepse

përfundon në paradoks. Akili, i cili gjendet pas breshkës, tenton ta zë breshkën. Por, derisa Akili ka arritur te vendi se ku gjendej breshka në fillim të vrapit, vet breshka ka lëvizur për një distancë, sado të vogël. Ky cikël vazhdon deri në infinit, dhe distanca në mes të të dyve kurrë nuk e arrin vlerën zero, sepse gjithmonë do të gjendet një distancë në mes tyre, sado e vogël. Edhe një herë, zgjidhja e këtij paradoksi është përafrimi, me ç'rast vlera infinitezimale barazohet me zeron. Pra, fizika, edhe pse është tregimi më i saktë që e ka ndërtuar njeriu, themel i ka në përafrim. Ajo që është interesante dhe që e bën të mahnitshëm narrativin e fizikës është se fizika është në gjendje të parashikojë. Bile, fizika, në vetvete e përmban edhe mekanizmin që i filtron parashikimet në ato që do të realizohen dhe në ato që nuk do të realizohen. Ky mekanizëm është shumë i thjeshtë dhe përbëhet nga vetëm dy hapa: hapi i parë është të dyshosh, dhe hapi i dytë është të testosh, pra të eksperimentosh me atë që thuhet. Një gjë e tillë nuk ndodh as në matematikë, as në art, as në religjion, as në filozofi. Kjo veti e fizikës për të parashikuar qëndron në thelb të zhvillimit teknologjik dhe shpikjeve të reja. Edhe më i çuditshëm është fakti se fizika bën punë edhe nëse nuk i përkufizojmë konceptet në esencë të tyre, por mjaftohet me një përkufizim operacional. Energjia është një shembull: askush nuk është në gjendje të tregojë se çka është energjia me të vërtetë, por gjithkush mund ta masë atë. Koha, hapësira e drita janë shembuj tjerë. Shën Augustini ka thënë se e di se çka është koha deri në çastin kur dikush më pyet se çka është ajo; në momentin që tentoj të jap përgjigje e ta shpjegoj, më nuk e di se çka është koha.

Ekziston një vijë interesante e narrativit shkencor, e ajo është se pjesë të ndryshme të tregimit gjithnjë vijnë e shkrihen apo bashkohen, duke krijuar një tregim koherent dhe konvergjent. Po të shikojmë historinë e fizikës, ajo karakterizohet me bashkimin e lëmvive në dukje të ndryshme, në sisteme të unifikuara. Al-

gjebra dhe gjeometria u unifikuan nga Dekarti dhe në vend të figurave gjeometrike, sot operojmë me ekuacione. Njutoni bashkoi mekanikën qiellore dhe atë tokësore duke i përshtetur ato me ekuacioneve të tregimit. Më pas,

Hamiltoni bashkoi mekanikën me optikën, Maksvelli bashkoi elektricitetin, magnetizmin dhe optikën, Ajnshtajni bashkoi hapësirën dhe kohën, de Broli bashkoi grimcat dhe valët, dhe Bul e Turing bashkuan arsyetimin dhe llogaritjen, duke i vënë bazat e kompjuterit. Sa për ilustrim, mekanika dhe optika bashkohen përmes parimit të Hamiltonit, i cili pak a shumë thotë se një sistem fizik ndryshon asisoj që aksioni gjithmonë është minimal. Një variant tjetër i këtij parimi thotë që fenomeni ndodh për kohën më të shkurtër të mundshme. Ju kujtohet se rrezja e dritës thyhet kur kalon nga uji në ajër, prandaj e shihni lugën e futur në gotën e çajit si të thyer. I njëjti princip vlen edhe në mekanikë. Shembull klasik për të ilustruar këtë merret rasti i një notari që mbytet në det, i paraqitur në figurë. Kujdestari i plazhit, që gjendet në një largësi në plazh, për t'i ndihmuar notarit do të dojë ta arrijë në kohën më të shkurtër, sepse ashtu jo vetëm që e kryen punën në kohën më të shkurtër, por edhe shpenzon më së paku energji të trupit. Dhe, për të arritur në kohën më të shkurtër nuk do të thotë që duhet të vraponi në vijën e drejtë që e bashkon me notarin, sepse një pjesë të rrugës do ta bëni duke vrapuar në rërë, e një pjesë duke notuar nëpër det. Në këto raste, shpejtësia në rërë dhe në ujë do të jetë e ndryshme, rrjedhimisht trajektorja që duhet ta përshtojë për ta arritur notarit do të jetë një vijë e thyer, njëjtë sikurse në rastin e dritës. Në figurë, secili segment mund të konsiderohet si hap i vrapit apo i notit që kalohet në njësi të kohës, dhe numri minimal i segmenteve i përgjigjet vijës së kuqe. Natyrisht që njeriu është trup shumë i komplikuar fizik dhe nuk i zhvillon lëvizjet kështu, sepse në lëvizjen e tij ndikojnë edhe faktorë tjerë jofizik, por çdo trup i thjeshtë, si lavjerrësit, topat e biliardit, Hëna në lëvizjen e saj rreth Tokës, e të tjera, e ndjekin këtë parim. Dhe tash shfaqet një pyetje e mistershme: si e di drita se cila është rruga që kalohet në kohën më të shkurtër?

Por, për t'iu kthyer narrativës që e ndërton fizika dhe që synon në unifikim. Pikë së pari, është i mahnitshëm fakti që ka ligje të natyrës, të cilat mund t'i gjejmë dhe shpjegojmë. Më pastaj, është i mahnitshëm edhe fakti që këto ligje janë të njëjtë për fenomene krejt të ndryshme dhe mund të shkruhen matematikisht. Kjo i motivon shkencëtarët që ta ndërtojnë një tregim të atillë që supozon unitetin e natyrës. Por, është edhe një motiv tjetër dhe që ka të bëjë me të bukurën: shkrirja e fenomeneve dhe përfitimi i një teorie të madhe të unifikimit do të jetë shumë më e kënaqshme

nga ana estetike. Të gjitha këto elemente, dyshimi, përafrimi, bukuria, tendenca drejt unifikimit, bëjnë që autorët e narrativës shkencore të zhvillojnë ide të reja dhe ta ndryshojnë, sado pak, narrativën shkencore. Ky ndryshim shfaqet ose si devijim nga rruga e ndjekur gjer në një moment, ose mund ta zhvillojë narrativën, duke e çuar përpara, në drejtimin që e ka pasur që sa kohë, ose duke e degëzuar. Zhvillimi i konceptit të dritës është një shembull. Drita gjithmonë është konsideruar si mesazh, si bartëse e informatës. Në formën më primitive, përmes dritës e shohim ambientin përreth, kurse në një formë më të avancuar, në atë fushë të studimit që njihet si spektroskop, drita zërthehet në ngjyrat përbërëse dhe na tregon për përbërjen kimike të substancës. Bile, edhe vet valët elektromagnetike apo radiovalët, përmes së cilave punon radio, televizioni, interneti, e komunikimet, janë një formë e dritës. Por, përpos këtij karakteri, përpos kësaj vetie, rishtazi - konkretisht, pas shpikjes së laserit - është gjetur edhe një karakteristikë tjetër e dritës, ajo e veglës mekanike. Pra, përmes dritës mund të kryhet punë. Drita vepron me energji, e cila përcillet te materia dhe e shkakton zhvendosjen apo deformimin e materies. Një fenomen që karakterizohet me aftësinë e dritës për të kryer punë është ablacioni laserik: një tufë drite nga laseri fokusohet në material dhe shkakton vlimin e tij - pra, e vlon edhe hekurin me dritë. Materia e vluar hidhet me vrull në një anë, kurse materiali i mbetur hidhet me shpejtësi shumë të madhe në anën tjetër. Sot studiohet mundësia për të lansuar satelitë me këtë metodë. Një aplikim tjetër i këtij karakteri të dritës është zhvendosja e mikrogrimeve me pincetë, piskatore, mashë laserike. Një tufë laserike që ka seksion tërthor në formë të unazës rrezaton mbi një mikrogrime të qendërzuar, dhe zhvendosja e tufës shkakton edhe zhvendosjen e mikrogrimeve. Pak a shumë, si tractor beam nga filmi Star Trek (ja që e realizova rregullin e pashkuar që çdo ligjëratë popullarizuese nga fizika duhet t'i referohet shtigjeve yjore). Për fund, cila është narrativa që Kosova, që ne si shoqëri, e kemi ndërtuar në lidhje me fizikën? Për fat të keq, kjo është shumë e vobektë. Fizika mësohet në shkollë dhe interesi për të është relativisht i mirë, i krahasueshëm me vendet e tjera të botës. Por, përderisa bota ka materiale plotësuese, libra e revista popullarizuese, shoqëri profesionale, dhe aktivitete komunitare, ne kemi mbetur në diskursin e lëndës shkollorë, të cilën kështu-ashtu nuk e bëjmë si duhet. E ritheksoj që fizika është tregimi që e kemi formuluar për të shpjeguar natyrën. Jam i sigurt që edhe ne mund të tregojmë, duhet të tregojmë diçka, sepse ja kemi borxh botës dhe vetes.

(Prezantim i mbajtur në TEDx Prizren)



NDIKIMET DHE (NDËR) VARËSIA MEDIA - POLITIKË



Gjylje Rexha

Zhvillimi i mediave është i lidhur ngushtë me sistemin shoqëror dhe politik. Sistemi mediatic i një vendi zhvillohet në kuadër të sistemit politik dhe si i tillë është i varur nga rregullat e vendosura nga politika. Në vendet demokratike, raporti është shumë më kompleks dhe nuk mund të përcaktohet thjesht si raport i varësisë së krijuar nga rregullat ligjore. Pushteti i parë dhe i dytë ndërtojnë raporte komplekse me pushtetin e katërt. Ndërmjet politikës dhe mediave/gazetarëve krijohen raporte që nga studiuesit vlerësohen deri simbiotike. “Në shoqërinë demokratike ku zgjedhjet janë aq të rëndësishme, politikantët bëhen të rëndësishëm për mediat dhe hapësira e transmetimit është jetike për politikanët” (Willis 2007). Raporti, që është i varësisë nga legjislati dhe i ndërvarësisë në veprimtarinë e përditshme, është më kompleks në rastin e mediave masive. Kjo ndodh për shkak të ndikimit që ky lloj i mediave ka në shoqëri dhe zotërimin të kapaciteteve për përcjelljen e mesazhit politik. “Rrënja strukturore e fuqisë së mediave masive buron nga kapaciteti i tyre unik për t’i ofruar politikantit audiencë, të cilën në madhësi dhe në përbërje, nuk mund ta arrijë me çfarëdo mjeti tjetër” (Blumler, Gurevitch 2001). Në kuadër të mediave masive, ndikimi e politikës më së tepërmi e përfshijë mediat publike. Këto media të dallueshme për nga struktura, qasja editoriale, raporti

me shtetin dhe politikën, mënyrën e financimit etj, konsiderohen si organizata mediatike të rëndësishme për rolin që kanë në zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ato janë pjesë e rëndësishme dhe në shumë raste qendrore e sistemit mediatic, për faktin se paraqiten ashtu siç i cilëson Chris Hanretty: si mediat më të organizuara, por edhe më të politizuara (Hanretty 2011).

Tre modele të medias dhe politikës nga Hallin dhe Mancini

Studiuesit e mirënjohur David Hallin dhe Paolo Mancini në librin e tyre “Comparing Media Systems – Three Models of Media and Politics”, ofrojnë bazë të mirë për analizën krahasuese të raporteve ndërmjet mediave dhe politikës, në 18 vende të Evropës Perëndimore dhe të Amerikës Veriore. Autorët identifikojnë parimet kryesore të dallimeve në sistemet e mediave dhe variablat politike, që kanë formësuar evoluimin e tyre, duke i klasifikuar në tre modele të mëdha:

- Modeli i Polarizuar Pluralist,
- Modeli Demokratik Korporatist,
- Modeli Liberal.

Për secilin nga modelet, autorët analizojnë katër dimensione të mëdha, përmes të cilave argumentojnë se sistemet në këto vende mund të krahasohen me sukses.

Tabela: Modeli i variacionit në katër dimensionet e sistemit të medias

	Pluralist	Demokratik Korporatist	Liberal
Zhvillimi i shtypit masiv	I ulët	I lartë	I lartë
Paralelizmi politik	I lartë	I lartë	I ulët
Profesionalizmi	I ulët	I lartë	I lartë
Ndërhyrja e shtetit	E lartë	E lartë	E ulët

Burimi:

Comparing Media Systems – Three Models of Media and Politics, fq 299

Këto dimensione janë: zhvillimi i tregut të mediave me theks të veçantë në zhvillimin e fortë apo të

dobët të shtypit masiv; paralelizmi politik që nënkupton shkallën dhe natyrën e lidhjeve ndërmjet mediave dhe partive politike; zhvillimi i profesionalizmit gazetaresk; shkalla dhe natyra e ndërhyrjeve shtetërore në sistemin e medias. Në disa raste dallimet ndërmjet modeleve janë substanciale, ndërsa në të tjera gjenden elemente të përbashkëta.

Në kuadër të analizës për katër dimensionet, autorët shtellojnë edhe raportin e shtetit dhe partive politike me transmetuesit publikë. Në të gjitha modelet, transmetuesit publikë konsiderohen pjesë e rëndësishme e sistemit mediatic dhe njëkohësisht organizata në veprimtarinë e të cilave ka ndikim të shtetit. Dallimet janë në mënyrën e ndikimit të shtetit dhe partive politike të veshura me pushtet, varësisht nga rezultatet zgjedhore.

Tre modelet dhe ndikimi mbi transmetuesit publikë

Në modelin e Mesdheut, ndikimi ushtrohet nga ana e forcave të mëdha politike, sidomos nga ato që janë në pushtet. Studiuesit Hallin dhe Mancini vlerësojnë se në të gjitha vendet e Mesdheut, politika synon të ketë rol të gjerë, sidomos, por jo ekskluzivisht, në mediat publike, në mënyrë të veçantë në lajme dhe programet për çështjet publike. Modeli “politika mbi transmetimin” është zbatuar

ndikimit përmes emërimeve në pozitat udhëheqëse të transmetuesve publikë.

Gjendja dhe qasja është krejt tjetër në vendet e Modelit të Evropës Veriore / Qendrore, ose atij Demokratik Korporatist. Këto vende karakterizohen nga transmetues publikë të fuqishëm dhe të organizuar në mënyrën që t’i shërbejnë interesit të përgjithshëm. Ata e kanë të rregulluar mirë dhe të garantuar financimin dhe hyjnë në radhën e transmetuesve publikë që aspak ose më së pakti, varen nga të hyrat komerciale. Mirëpo, synimi për të pasur transmetues publikë që i shërbejnë interesit të përgjithshëm, edhe në këto vende, ngrit çështjen se si do të udhëhiqen këta transmetues. Ndërmjet vendeve të këtij modeli ka variacione për mënyrën e udhëheqjes së transmetuesve publikë, por e përbashkëta është se qeveria nuk është e përfshirë dhe të gjitha vendet kanë zhvilluar mekanizma për të izoluar transmetuesin publik nga kontrolli i shumicës politike”.

Derisa në vendet e Modelit Korporatist gjenden transmetuesit publikë më të qëndrueshëm dhe “më të pastër”, në modelin Veri-Atlantik gjenden disa variacione të këtyre transmetuesve. Tek ky model është BBC-ja si transmetues publik inspirues dhe model në vete për vende të tjera, brenda dhe jashtë modelit, por edhe modeli i vërtetë liberal i Shteteve të Bashkuara, ku transmetuesi publik ka pak ndikim. BBC është shembulli klasik i asaj që autorët e cilësojnë “modeli profesional” i qeverisjes së transmetuesit publik.

Sistemet e transmetuesve publikë në Kanada dhe në Irlandë janë modeluar sipas BBC-së. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërkaq janë vendi ku dominon sistemi i transmetimit komercial, kurse sistemi i transmetimit

publik ka mbetur i dobët, sipas standardeve krahasuese.

Pavarësisht nga tiparet dalluese të modeleve, autorët Hallin dhe Mancini në konkluzionet e librit e pranojnë se shumë nga rastet janë të përziera dhe duhen parë si të tilla. Ata shtrojnë pyetjen se si këto tre modele mund të lidhen me sisteme të tjera. Autorët vlerësojnë se Modeli Liberal është relevant për studimin edhe të shumë sistemeve tjera, për shkak të ndikimit global dhe për shkak se neoliberalizmi dhe globalizmi vazhdojnë të shpërndajnë ide dhe struktura mediale liberale. Modeli Demokratik Korporatist do të ketë relevancë për analizimin e sistemeve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, që kanë zhvillime të ngjashme historike, si Polonia, Hungaria, Republika Çeke dhe vendet Baltike. Edhe pse Modeli Liberal ka dominuar studimet për mediat dhe ka shërbyer tradicionalisht si model normativ për matjen e sistemeve tjera të mediave, Hallin dhe Mancini vlerësojnë se është Modeli i Polarizuar Pluralist ai që gjerësisht mund të jetë i zbatueshëm në sistemet tjera, si model empirik për lidhjet ndërmjet mediave dhe sistemeve politike.

Karakteristikë kryesore e Modelit të Mesdheut është kultivimi i praktikës së ndërhyrjes në mediat mbi të cilat politika ka ndikim dhe ky ndikim shndërrohet në varësi të medias nga politika. Me këtë karakteristikë, Modeli i Mesdheut, ashtu siç thonë Hallin dhe Mancini, mund të përdoret me efikasitet për studime empirike edhe në vendet e Ballkanit. Mediat në shtetet e këtij rajoni, e sidomos transmetuesit publikë, janë nën ndikimin e vazhdueshëm të faktorëve jashtë sistemit mediatic, por brenda sistemit politik. Prandaj, ndryshimet në mënyrat e funksionimit të tyre varen drejtpërdrejt nga ndryshimet e përgjithshme që duhet të kalojnë shoqëritë e këtyre vendeve.

UBT-ja organizon Akademi Ndërkombëtare Verore, 6 - 15 korrik 2016

UBT-ja po e vazhdon traditën e organizimit të Akademisë Ndërkombëtare Verore. Sivjet, ajo mbahet për të pestën herë me radhë, ndërsa do të fillojë më 6 dhe do të mbarojë më 15 korrik 2016. Akademia mbahet në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, teksa për mbarëvajtjen sa më cilësore janë paraparë 13 disiplina të ndryshme shkencore, me gjithsej 16 programe, si:

Shkenca Kompjuterike, Shkenca Politike, Energji Efiçente, Sisteme të Informacionit, Menaxhment dhe Ekonomi, Drejtësi, Media dhe Komunikim, Menaxhim i Mekatronikës, Arkitekturë, Ndërtimtari, Edukim dhe Zhvillim i Qëndrueshëm, Ekonomik dhe Shkenca të Jetës. Derisa Akademia mbahet nga data 6-15 korrik 2016, aplikimi

për studentët vendorë të të gjitha universiteteve/kolegjeve dhe ndërkombëtarëve, është i hapur deri më 25 qershor 2016. Edhe këtë vit, profesorë të njohur ndërkombëtarë dhe vendorë, do të ligjërojnë në disiplina të ndryshme shkencore. Në përfundim të programit, studentët certifikohen dhe marrin 2-4 ECTS kredi, të njohura ndërkombëtarisht. Përveç aktiviteteve akademike, gjatë Akademisë zhvillohen edhe diskutime, forume, punëtori të ndryshme, vizita studimore, gara sportive dhe aktivitete të tjera. Për të gjithë studentët vendorë aplikimi është pa pagesë. Për më shumë informata rreth aplikimit dhe Akademisë Ndërkombëtare Verore shihni linkun: <http://sa.ubt-uni.net> dhe kontaktoni: sa@ubt-uni.net

5th INTERNATIONAL SUMMER ACADEMY 2016
6 - 15 JULY

UBT INNOVATION CAMPUS

sa@ubt-uni.net | +381 38 541 400

TË JESH GUXIMTAR APO TË KESH GUXIM



Ferid Selimi

Të guxosh ose të guxojmë, do të mund të trajtohej në dy segmente. E para, në të qenët tonë të gatshëm; dhe E dyta, të pasurit tonë. Thënë pak më ndryshe, do të nënkuptonte, që: Së pari të jesh ose të jemi të gatshëm për të kryer një detyrë a një punë të rrezikshme ose shumë të vështirë, për pa u trembur nga rreziqet e vështirësitë, që pasojnë. E që ndryshe do të mund të themi edhe: të largosh, përkatësisht të heqim ndjenjën e shqetësimit të thellë, kur jemi përpara një rreziku, që na kanoset drejtpërdrejt, apo gjendemi përpara një rreziku të ardhshëm; dhe,

Së dyti: të kesh ose të kemi gatishmëri për të kryer një detyrë a një punë të rrezikshme ose shumë të vështirë, për pa u trembur nga rreziqet e vështirësitë, që pasojnë. E që ndryshe do të mund të themi

edhe: të largosh, përkatësisht të largojmë ose të heqësh, përkatësisht të heqim ndjenjën e shqetësimit të thellë kur kemi përpara një rrezik, që na kanoset drejtpërdrejt, apo kemi përpara një rrezik të ardhshëm. Vështirësitë dhe rreziqet mund të jenë të llojeve të ndryshme, e që mund të vënë vepruesin ose mos vepruesin në kushte të tilla ku do të pasonte një e keqe e madhe, ose mund të bëhet, përkatësisht të bëhemi shkakuar të një gjendjeje të rëndë e fatkeqe. Mirëpo, jo domosdoshmërisht, guximi i dikujt ose yni, sjell gjendje të rëndë e fatkeqe. Jo gjithmonë të qenët tonë të guximshëm do të thotë gatishmëri për të vepruar ose mos vepruar. Guximi i vepruesit ose i mos vepruesit mund të sjell të mira dhe një gjendje shumë më të mirë sesa e para. Por, meqë përmenda disa nga vështirësitë, atëherë përmenda edhe disa nga pasojat, që mund të sjell guximi në ato raste. Tek e fundit, vetë emërtimi guxim ka kuptimin e të bërit diçka, që është e rrezikshme ose e vështirë. Prandaj, jo secili ka guximin të ndërmer se të mos ndërmer ndonjë veprim, që lidhet me rrezikshmëri. Jo secili trembet. Dhe e kundërta, jo secili nuk trembet. Ndosht, madje shpesh, që të të kaplojë ose të na kaplojë një frikë e menjëhershme, një shqetësim, dhe mbase të mban a na mban edhe pasi të kalojë momenti i atij shqetësimi a

frike. Kjo gjendje, kur njeriu ballafaqohet me këso situatash njihet si trembje. Prandaj, ne edhe kur guxojmë mund të trembemi. Sikur që, edhe kur trembemi, guxojmë. Sepse është njerëzore të na kap ndonjë frikë e menjëhershme a shqetësim, e që mund të na mbaj edhe pas atij momenti kur na ka kapluar shqetësimi. Sikur që, edhe kur na kaplon një frikë e menjëhershme a një shqetësim momenti, ne guxojmë, dhe tejkalojmë atë. Por, edhe kur guxojmë, trembemi. Sepse edhe atëherë na kap një frikë e menjëhershme a një shqetësim. Dhe e kundërta. Kur trembemi, guxojmë. Sepse, jemi të gatshëm për të kryer një detyrë a një punë të rrezikshme ose shumë të vështirë, për pa na shkuar në mendje të trembemi nga rreziqet e vështirësitë, që pasojnë. Dhe për më tepër kemi gatishmëri për të vepruar ose mos vepruar në raste të ndryshme. Që do të thotë: jemi edhe kemi. Pra, mund që të mos na kaplojë shqetësimi a frika e menjëhershme, ose të na kaplojë, e ta tejkalojmë pa e vënë re fare, ose të mos na tremb a shqetësojë ai moment i asaj frike të menjëhershme, moment, që mbase na jep forcë, dhe na bën të lirohemi nga ajo gjendje, për të mos ndikuar aq te ne, sa të trembemi. Ose për të mos ndikuar aq në rreth sa të trembim dikë. Veprimi ose mos veprimi, deshëm ose jo, lë pasoja, të cilat

i vërejmë ose i ndiejmë më vonë. Jo rastësisht i kujtojmë disa ndodhi më shpesh, e disa harrohen thuaja krejt. Kujtimi për ndodhitë e para shumë viteve është pasojë e diçkaje, që ka ndodh dhe është ngjitur për kujtesën tonë. Mund të jetë guximi, frika, trembja, gëzimi, vuajtja, pikëllimi, etj.. Ani, se nuk i kemi kuptuar mbase me kohë, e ani se nuk i kuptojmë si të tilla. Ato, si atëherë kur kanë ndodhur e kur ne jemi ballafaquar me to, kanë qenë të tilla, e të tilla janë edhe sot, dhe do të mbeten edhe në të ardhmen, kur të ketë kaluar goxha një kohë e gjatë nga ato veprime ose mosveprime. E që sërish na sjellin në gjendjen e të qenët tonë dhe në pasjen tonë.

Përshkrimi, që i bëjmë ditëve të fëmijërisë, ose kohës kur nuk kishim ushqim e veshmbathje të bollshme, ose momentet kur mund të ishim rrezikuar nga një situatë e pakëndshme, mbase është pasojë mu e asaj frikës "mos po kthehet një kohë e tillë" dhe në fund themi: "mos u përsëritë ajo kohë!". Me këto fjalë, përgatisim veten, duke u kthyer në kohë, e duke kujtuar gjendjen, të qenët tonë, dhe duke krahasuar me gjendjen, të qenët tonë dhe pasjen, që kemi tani. Dhe kjo përgatitje nuk bëhet krejt rastësisht, por, për të kryer detyrat a punët, që do të mund të jenë të rrezikshme ose të vështira, për pa u trembur nga rreziqet e vështirësitë, që pasojnë.

Pra kujtesa për të kaluarën, për fëmijërinë, ose për kohën e humbur, ose për kohën kur kemi vepruar ose nuk kemi vepruar, jo domosdoshmërisht është shenjë e plakjes, dhe jo domosdoshmërisht është shenjë e frikës, siç theksojnë disa. Ajo është mbase një kujtesë e të qenët tonë, si dhe e pasjes. Prandaj, edhe shpesh i bëjmë vetes pyetje: Jemi ne, këta? dhe, Kemi ne, këtë? Kur pyesim veten: Jemi ne këta? - Mendojmë në të qenët dhe në gatishmërinë tonë për të qenë të gatshëm për një veprim ose mosveprim. Ndërsa kur pyesim veten: Kemi ne këtë? - Zakonisht mendja na shkon te pasja e guximit për të vepruar ose mos vepruar. Ose pasja e frikës për të njëjtin qëllim. Prandaj, edhe them, që, gatishmëria për të vepruar ose mos vepruar, jo domosdoshmërisht lidhet me frikën, që mund të jetë në ndërdijen tonë, por me të qenët i gatshëm dhe me pasjen e gatishmërisë për të vepruar ose mos vepruar. Sikur që, jo domosdoshmërisht është edhe shenjë e guximit tonë. Sepse, një ndjenjë e tillë (e humbjes kot e kohës) te ne mbjell nevojën për të vepruar ose për të mos vepruar, e që do të thotë të marrim një vendim. Pra të bëhemi gati të kryejmë një detyrë a një punë të rrezikshme ose shumë të vështirë, për pa u trembur nga rreziqet e vështirësitë, që pasojnë. E që do të thotë: Të guxojmë.

NË OHËR TË MAQEDONISË

QETI e UBT-së merr pjesë në Konferencën "AdventureNEXT"

Një përfaqësues i Qendrës UBT-së për Ekonomi, Turizëm dhe Inovacion (QETI) mori pjesë në Konferencën përuruese rajonale të quajtur "AdventureNEXT", organizuar nga Adventure Travel Trade Association (ATTA), që u mbajt nga 10-12 maj, në Ohër të Maqedonisë. Së bashku me partnerin dhe nikoqirin e destinacionit, Maqedoninë (zyrtarisht, "Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit në Maqedoni"), kjo konferencë mbledhi bordet kombëtare të turizmit,

duke përfshirë operatorët ndërkombëtarë, gazetarët, furnizuesit lokalë, pronarët e hoteleve dhe operatorët turistikë nga Evropa Juglindore (Maqedonia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia) etj. Pjesëmarrësit u ftuan që të marrin pjesë në mënyrë që të mësojnë, të lidhen dhe të rriten, duke qenë të rrethuar nga bukuria e liqenit të Ohrit dhe Maqedonisë Perëndimore. Pjesa më e madhe e seancave të diskutimit përfshin

nevojën për inovacion dhe trajnim të mëtejshëm të punonjësve të industrisë All, e cila është në përputhje me misionin e CTEI, si dhe është përpjekje për të sjellë së bashku njerëz nga rajoni për të formuar partneritete. Për më tepër, ngjarja ishte një sukses i madh, sepse tregoi potencialin masiv të Ballkanit për turizëm, duke u bazuar në reagimet e pjesëmarrësve nga Amerika e Veriut, si dhe të ftuarit nga Evropa dhe Australia Perëndimore, të cilët e vizituan Ballkanin për herë të parë.

UBT-ja hap udhë për studime pasuniversitare në Evropë

Dodona Blakaj, arkitektja e re, e cila i ka përfunduar studimet themelore në UBT, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, është pranuar për t'i vazhduar studimet pasuniversitare, Master, në universitetin "Politecnico di Milano", më i madhi dhe më i vjetri në Itali, me rreth 40 mijë studentë. Ajo ka treguar se ka fituar edhe bursë të studimeve për drejtimin "Architectural Design and History". Blakaj i ka përfunduar studimet themelore në UBT, në korrik të vitit të kaluar. Përshtypjet e saj për UBT-në vazhdojnë të jenë të shkëlqyeshme. "UBT-ja ofron mundësi të mëdha për ngritje profesionale, të krahasueshme me nivelin e universiteteve evropiane", ka thënë ajo dhe ka shtuar se pikërisht për shkak të nivelit të barabartë, studentët e UBT-së kanë mundësi të zgjedhin për

studimet e mëtejme. "Studentët i kanë rrugët e hapura për t'i vazhduar studimet në shumicën e universiteteve të mirënjohura evropiane e ndërkombëtare", ka thënë ajo për UBT-në, duke folur fjalë të mira edhe për menaxhmentin dhe për stafin akademik brenda. "Profesorët e UBT-së janë të një niveli të lartë akademik. Ata sjellin standarde ndërkombëtare për zhvillimin e programeve të studimit dhe janë gjithmonë të gatshëm e transparentë, për të ndihmuar studentët për ngritje profesionale", është shprehur ajo. Po ashtu, i vlerëson lart edhe kushtet infrastrukturore në UBT. "Në UBT mund të studiohet dhe të punohet, pasi që është institucion i lartë i arsimit në Kosovë, që investon shumë, krejt me qëllim të rritjes së cilësisë dhe inovacionit në mësimdhënie", ka përfunduar ajo.



PAS BASKETBOLLIT, DO T'I PËRKUSHTOHEM GAZETARISË SPORTIVE

“Deri në një moshë e kam ndërmend që të vazhdoj të merrem me sport. Do të vazhdoj me sport, por jo në mënyrë aktive. Besoj që do t'i përkushtohem maksimalisht profesionit tim, më konkretisht, gazetarisë së sportit”, thotë studentja e UBT-së, basketbollistja Ulpiana Emra



UBT News: Ulpiana, si ka nisur karriera juaj sportive?

Ulpiana: Nisur nga vetë fakti që unë rrjedh nga një familje sportistësh, ku vëllai im është futbollist i mirënjohur në Kosovë, inspirimi im i parë ka qenë pikërisht ai. Përkrahja e madhe e familjes më ka shtyrë që unë t'ia filloj këtij sporti që në moshën 10-vjeçare.

Hapat e parë i kam marrë në një shkollë të basketbollit, të quajtur Junior 06, në Prizren dhe jemi trajnuar nga trajneri Ramush Rushiti. Aty kam luajtur për 3 vite. Më pas, në moshën 13-vjeçare kam hyrë në ekipin e parë të femrave në Prizren, në klubin e basketbollit “Bashkimi”. Fillimisht kam qenë në ekipin rezervë, sepse isha ende shumë e re. Në këtë ekip kam qendruar për 5 vite, e deri në këtë vit, ku tash prej janarit të këtij viti jam transferuar në kampionin aktual të Kosovës, K.B. “Prishtina”.

UBT News: The që jeni transferuar këtë vit në K.B. “Prishtina”. Si e kanë pritur ardhjen tënde pjesa tjetër e ekipit?

Ulpiana: Në fillim pritja nuk ka qenë edhe aq e mirë, por me kalimin e kohës kanë filluar të adaptohen me praninë time. Gjithashtu, edhe unë kam filluar të ambientohem me rrethin dhe me bashkëlojtaret e mia aktuale. Edhe pse fillimi ka qenë i vështirë, pasi që ndërrova ekip pas 5 viteve, prapë ka qenë një ndryshim pozitiv edhe për mua, por edhe për vajzat e klubit të cilat nuk e kanë pritur transferimin tim në këtë ekip. Vlen të përmendet që përfundimi ka qenë tejet i mirë sepse veç dihet që ne u kurorëzuam me titullin e kampionit të Kosovës.

UBT News: Ju na treguat që sivjet K.B. “Prishtina” u shpall kampion e Kosovës. Si ndiheshit ju në ato momente?

Ulpiana: Ishte një emocion i papërshkrueshëm. Unë e kam përjetuar ndjenjën e të qenurit kampion edhe viteve të mëherëshme, por kjo ka qenë në kategoritë më të ulëta, për kategorinë kadet dhe junior. Kurse, shpallja si kampion i Kosovës në senior është një ndjenjë shumë e veçantë pasi që ka qenë qëllimi ynë kryesor dhe secili person që e arrin qëllimin e tij ndihet shumë mirë dhe me vlerë

UBT News: Sporti të jep momente të veçanta gëzimi e pikëllimi. A mund ta përmendësh një rast të tillë?

Ulpiana: Është shumë e vërtetë. Sporti është pjesë e jetës sime dhe në momentin që e shndërron në pjesë tënden, atëherë sigurisht që do të ketë momente gëzimi e pikëllimi që nuk mund t'i përshkruash me fjalë. Momentet më të rënda për ne kanë qenë kur kemi arritur të shkojmë deri në finale dhe në momentet e fundit kemi humbur mundësinë për fitimin e trofeut. Megjithatë, janë momente që neve na kanë dhënë mësim dhe kanë ndikuar në përmirësimin tonë. Kurse, momentet më të mira kanë

qenë kur ekipet e mia kanë arritur të shpallen kampione.

UBT News: Ju jeni studente e Medias në UBT. Sa është e vështirë t'i përkushtoheni basketbollit dhe studimeve në të njëjtën kohë?

Ulpiana: Kur do diçka, atëherë mundesh edhe ta arrish. Për mua nuk është aspak e vështirë pasi që ligjëratat i kam paradite, kurse pjesën tjetër të ditës e kam të lirë dhe kështu arrij t'i përkushtohem edhe basketbollit. Përderisa të dyja janë gjëra që unë i dua në jetë dhe i bëj me përkushtim e dëshirë, atëherë nuk është aspak problem që t'i mbajë në rend të dyja.

UBT News: Sa është e vështirë që të merresh me sport në Kosovë?

Ulpiana: Është shumë e vështirë, sidomos duke i pasur parasysh kushtet jo të mira, veçmas në ligën e femrave. Unë mendoj që bëhet një diskriminim shumë i madh në krahasim me meshkujt, ku investimet tek liga e meshkujve janë marramendëse. Basketbolli mashkullor është sporti më i paguar në Kosovë, përkundër basketbollit femëror që nuk ka përkrahje as minimale, ku vetëm komuna me një shumë simbolike i përkrahë klubet. Për këtë arsye mund të thuhet se motivimi mungon nga

ana e investitorëve, por dëshira jonë e madhe bën që ne të jemi pjesë e sportit.

UBT News: Nisur nga fakti që je femër, a shihesh ndonjëherë me sy paragjykes a kritik nga të tjerët?

Ulpiana: Jo, deri sot nuk më ka ndodhë dhe nuk e besoj që do të ndodhë kjo sepse në vendin tonë përkrahen edhe femrat. Ne nga populli shihemi me sy shumë të mirë.

UBT News: Në të ardhmen, veten e shihni si gazetarë profesioniste apo si basketbolliste?

Ulpiana: Unë e shoh veten si gazetarë profesioniste, kjo sepse sporti e ka një moshë të caktuar kur mund të merresh me të në mënyrë aktive, më tutje nuk mund të vazhdosh. Pikërisht për këtë arsye edhe i përkushtohem studimeve maksimalisht.

UBT News: A e shihni veten si trajnere pasi që ta arrish moshën kur nuk mund të luash më?

Ulpiana: Jo, nuk e besoj. Deri në një moshë e kam ndërmend që të vazhdoj të merrem me sport. Do të vazhdoj me sport, por jo në mënyrë aktive. Besoj që do t'i përkushtohem maksimalisht profesionit tim, më konkretisht, gazetarisë së sportit.

**CAMPUS
RADIO
100.7FM**



University of Warsaw



Bachelor and Master Degree in International Relations



Teaching and Research Areas

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



University of Warsaw (UW)

Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

UW Highlights:

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

Institute of International Relations:

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

Fees & Financing:

Bachelor: 1300 € / Year
Master: 2000 € / Year

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Come to UBT and get European degree

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: warsaw@ubt-uni.net
Email: ismn@uw.edu.pl
Institute of Warsaw
www.ism.uw.edu.pl

Danube University Krems



Master of Business Administration - MBA

Specializations with MBA Program

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management



Fees & Financing

Tuition fee: Euro 21,900

Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Danube University



Danube University Krems has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University Krems combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

Department for Management and Business

We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

Top 10 Reasons to Join a Danube MBA

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni

Top University Education for Top Students!

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: dukmba@ubt-uni.net
Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at
Tel: +43 (0)2732 893 2126
Web: www.donau-uni.ac.at

Vienna University of Technology



CONTINUING EDUCATION CENTER



Msc Engineering Management
Your key to the top engineering league



CONTENTS

Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

MODALITIES

3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

FEES & FINANCING

Tuition fee: Euro 22,000

Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000

The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

HIGHLIGHTS

- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



Top University Education for Top Students!

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

Vienna University of Technology
Continuing Education Center
Operrgasse 11 • A -1040V ienna
T +43(0)1/58801-41701 • e engineering@tuwien.ac.at
Email:engineering@ubt-uni.net
http://engineering.tuwien.ac.at



BARASVLERA E 7 KRITEREVE TEKSTUALE NË SHQIPE

Tekstet lëvizin në dimensionin gojor e shkrimor; me një ose me shumë fjali; monolog apo dialog; me elemente paragjuhësore, apo jashtëgjuhësore, si edhe në të përziera. Përkufizimi se tekst është vetëm ai që i plotëson 7 kriteret tekstuale, jep të kuptohet se kriteret janë të barasvlershme, dhe të tilla duhet trajtuar e studiuar

GANIMET KLAIQI

Prodhuesi i çfarëdo veprë, letrare apo joletrare, e ka detyrë gjuhësore të ndërtojë tekste logjiksht të kuptueshme dhe gramatikisht të strukturuar. Detyrë e dytë është ndërtimi i raporteve me marrësin - lexuesin. Robert-Alain de Beaugrande dhe Wolfgang Ulrich Dressler shpjegojnë se 7 kriteret e tekstualitetit që e bëjnë një tekst të jetë tekst janë: Kohezioni, Koherenca, Intencionaliteti (Synueshmëria), Akceptabiliteti (Pranueshmëria), Informativiteti (Njoftueshmëria), Situacionaliteti dhe Ndërtëkstualiteti. Nëse një nga këto kriteret s'është plotësuar, atëherë nuk ka tekst komunikues. Ka jotekst (de Beaugrande & Dressler 1981:3). Teksti shfaqet nëpërmjet librave, letrave, gazetave dhe mund të jetë shkrimor ose gojor. Komunikimi bëhet midis partnerëve dërgues-marrës (shkrues e lexues). Jo vetëm në shqipe, por edhe në gjuhët e tjera është krijuar një traditë se ndër kriteret më të rëndësishme për organizimin e tekstit janë Koherenca dhe Kohezioni. Kriteret e tjera kundrohen dytësore a të treta, ndonëse kriteret janë të dedikuara për ta plotësuar njëri-tjetrin. Ekziston një përndarje funksionale, që ka të bëjë me raportin dërgues-marrës. Koherenca, Kohezioni, Situacionaliteti, Intencionaliteti dhe Ndërtëkstualiteti i përkasin dërguesit, teksa akceptabiliteti dhe informativiteti, ndonëse perceptohen nga dërguesi, kanë të bëjnë me marrësin. Notimin për realizimin e suksesshëm ose jo të kriterëve të para nga dërguesi, e jep marrësi. Për çdo lëmi, janë trendët ato që e bëjnë një tekst më të pranueshëm. Në periudhën e Rilindjes Kombëtare, patriotët, të vetmen armë vepruese për të zgjuar ndjenjat kombëtare të popullit të tyre e kishin gjuhën. Ata, shkallën e komunikimit gjuhësor s'e ngrehnin mekanikisht, por me përmbajtje logjike, gramatikore, me synim të qartë, me situata, me ndjeshmëri për pranuesin, me informacion dhe me ndërtesktualitet. Ishin të zot për ndërtimin e raporteve komunikuese gjuhësore. Tradita ka vazhduar edhe në periudhat e tjera shoqërore, letrare, e kulturore.

Kriteret në tekstin shqip

Kohezioni – është kriteri i parë, të cilin De Beaugrande dhe Dressler (1981:3) e përkufizojnë si strukturë sipërfaqësore

që e bën lidhjen gramatikore të fjalëve, me varshmëri ndaj njëra tjetrës. Poema "Bagëti e Bujqësia" e Naim Frashërit e realizon me përsosmëri kohezionin.

Atje (Në Shqipëri) lint diell' i qeshur edhe hëna e gëzuar,

Fat' i bardh' e mirësija n'atëvënt janë mbluar;

Nat' atje 'shtë tjetër natë, edhe dita tjetër ditë.

Në pyjet e gjelbëruar, atje rrinë Perënditë.

Heinz Vater (2001:30) ka argumentuar se Kohezioni i përket të gjitha njësive gramatikore, përfshirë edhe aspektin fonetik: ritmin, rimën, intonacionin, pauzat etj. Për dallim nga poema e Naimit, që për synim ka himnizimin e atdheut, gjithnjë duke e plotësuar kriterin bazë të tesktualitetit, poezia e Migjenit "Kangët e pakëndueme" ka synim tjetër – dëshirën për ta gëzuar lirinë.

Koherenca – si kriter i dytë i tekstualitetit, për dallim nga kohezioni, përbën lidhjen semantike dhe logjike të tekstit.

Kangët e pakëndueme

Thellë në veten teme flejnë kangët e pakëndueme të cilat ende vuetjta as gëzimi s'i nxori, të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme me shpërthye, m'u këndue pa frigë e pa zori.

Këto vargje tregojnë se sa e rëndësishme është lidhja logjike e fjalëve në varg. Realizimi i përpiktë, edhe i koherencës e bën këtë poezi atraktive për çdo kohë.

Intencionaliteti (synueshmëria) – Ky kriter paraqet qëndrimin e prodhuesit. Kjo bëhet nëpërmjet Kohezionit e Koherencës, pa të cilat ky kriter nuk mund të realizohet.

Në librin satirik të at Gjergj Fishtës, "Nën hije të parrizit" (1990:92-100),

biseda e Shën Pjetrit, Skënderbeut dhe djallit, e jep qëndrimin e plotë të prodhuesit në lidhje me zhvillimet e kohës brenda shoqërisë. Deri tek përfundimi paraqiten anët më të errëta të popullit të autorit. Në fund jepet tabloja, që e paraqet synimin e Fishtës:

"Për ketë punë, hin npariz o mos i qit kujdes vedit për Shqypninë; pse, për inat të djallit e tërë shqypatërvet, Zoti ka me e mbajt Shqypninë më kambë me nder e me lumni", janë fjalët e Shën Pjetrit në adresë të Skënderbeut.

Akceptueshmëria – I dedikohet marrësi, gjithnjë duke pasur parasysh realizimin normativ të kriterëve të para të tekstualitetit nga dërguesi.

"Andra e një Shqypniës s'lihtë po vërtetohet. Kush e kish pa ket Andër të bukur? Nji pakicë shum e vogël prejë nesh, idealist të përqeshun a t'pakuptuemen prejë vulgut, të cillt maa teper se pësmdhetë vjet me radhë kemi paa rrezikun, kemi dishrue shëlbimin, kemi diftue mjetin e shëlbimit. Koha, mikneshë e kadaltë por e sigurtë e mëndimtarve, provoj plotnisht se kishim arrsyte: Rrëimi i Mbretëniës Otomane e shpuri kombin t'onë buzë të vorrit, e gati e shtyni m r e n d ë , por Shqypnia u njall vetëm prej asajë dore t'cilën na e kshim kasnecue si shëlbosja"

(Konica: Ylli I Dritës 1913: 11).

Një tekst i tillë për kohën dhe rrethanat politike të kohës, realizuar me kriteret paraprake të tekstualitetit e vë në vend Akceptueshmërinë.

Informativitetit (Njoftueshmëria) - ka të bëjë me të përiturën në raport me të papëriturën, të njohurën me të panjohurën, (De Beaugrande & Dressler 1981:10), është më lehtë i matshëm.

Titulli i një gazete kosovare (Koha Ditore, ballina, 14 maj 2013)

Krasniqi: Veriu e dëgjon Beogradin, jo Prishtinën

Është titull informativ më shkallë të lartë, i pasuar nga nëntitulli: "Nënkryetari i Qeverisë serbe, Aleksandër Vuçiq, një ditë pas qëndrimit në Kosovë, paralajmëroi se marrëveshja Thaçi-Daçiq nuk është fundi i lojës dhe theksoi se serbët e Kosovës 'kurrë nuk do të jenë kosovarë'". Ky kriter, në rastin konkret lidhet shumë me aktualitetin dhe me rrethanat shoqërore, përkatësisht me botën reale. Saktësohet edhe rëndësia e Situacionalitetit në tekst. Ai është ndërtuar nga elementet jash-tëkstore të gjuhës, si: Krasniqi, Veriu, Beogradi, Prishtina, Aleksandër Vuçiq, Thaçi-Daçiq, etj. Këta janë faktorët, pra, që i krijojnë situatat dhe që i bëjnë ato relevante në komunikim.

Ndërtëkstualiteti – Përkufizuesit e kriterëve të tekstualitetit e kanë e definuar atë me dy domethënie: si refrencë e llojit të tekstit dhe si referencë e tekstit tjetër (1981:13). Thjeshtimi e nënkupton një tekst tjetër brenda tekstit.

Parisi, Vendlindja

Do të hyjmë në Paris gurin tonë aty do ta ngulim, nuk do të na presë Teuta, Genti nuk do të na presë hordhi e egër romake nuk do të na presë njeri i gjallë.

Evropës së përgjumur s'do t'i përulemi

as perëndive të krisura. Ma jep besën, Lum Lumi, se nuk do ta harrojmë vendlindjen.

Në këtë poezi (Ali Podrimja 1990:50) vërehet struktura e organizuar e llojit të tekstit. Autori e bën një lidhje midis Parisit dhe vendlindjes, jo si një rrëfim të thjeshtë udhëtimi, por si një përkushtim artistik. Kundrimi si rrëfim i thjeshtë e bën këtë poezi në leximin e parë. Por, brenda atij lloji është një tekst tjetër, për kuptimin e të cilit është e nevojshme gjithsesi që të "këshillohet" teksti i parë, dhe që do të vlerësohet si lexim i dytë. Ky i dyti i ngjason një parodie. Gjuhëtari gjerman, Heinz Vater (Vater 2001:48) e mohon leximin e parë si ndërtesktualitet, teksa e vlerëson si kriter të tekstualitetit (ndërtëkstualiteti). vetëm leximin e dytë.

Krejt në fund, duke pasur parasysh që tekstet lëvizin në dimensionin të ndryshme: gojor – shkrimor; me një ose me shumë fjali; monolog apo dialog; me elemente paragjuhësore, apo jashtëgjuhësore, si edhe tekste të përziera, përkufizimi i tekstualitetit se tekst është vetëm ai që i plotëson 7 kriteret e tij, sforcohet ideja se ato janë të barasvlershme dhe vetëm sit ë tilla duhet trajtuar e studiuar.



Top Education for Top Students



- 15 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i certifikuar për ekscelencë (EFQM)
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfitues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfitues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and Go International...

Kolegji UBT - Bartës privat i Arsimit të Lartë i akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe licencuar nga MASHT.

PROGRAMET E AKREDITUARA

- **MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)**
 - Financa, Banka dhe Sigurime
 - Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
 - Manaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
 - Marketing dhe Shitje
 - Biznes ndërkombëtar
 - Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit
- **SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)**
 - Shkenca Komputerike dhe Inxhinieri
 - Rrjeta dhe Telekomunikacion
 - Softuer dhe sisteme Inxhinierie
 - Baza e të dhënave dhe Menaxhimi i Informacionit
 - Grafikë kompjuterike dhe Multimedia
 - Programim i WEB-it
 - Sistemet Intelgjente dhe Robotika
 - Sigurimi dhe Siguria e Informacionit
- **MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (Baçelor dhe Master - I vetmi i akredituar në vend)**
 - Menaxhimi i Mekatronikës
 - Dizajimi Industrial i Produkteve
 - Sistemet Intelgjente dhe Robotike
 - Inxhinieri Biomedicionale
 - Inxhinieri Elektrike dhe Elektronike
 - Inxhinieri Mekanike dhe materialeve
 - Inxhinieria e Aeronautikës

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Licënca falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Çertifikime për kontabilist në bashkëpunim me SCAA

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është **1200 €**, për nivelin Master është **1500 €** me mundësi pagese deri në **12 kështe**.
- Për të gjithë **nxënësit e dalluar** UBT ofron përkrahje financiare

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

PËR UBT:

“UBT është krijuar si një universitet ndërkombëtar; një universitet modern që i përbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike.”

Edmond Hajrizi, Rektori i UBT-së

“Edukimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve, që sot veprojnë ndërkombëtarisht, jo vetëm në hapësirën e Europës, por globalisht. UBT ju ofron mundësinë për të arritur qëllimet-objektivat ndërkombëtare”

“Profesorët e këtij universiteti janë më të mirët, dhe mund të shtojë që studimet tuaja në UBT janë më të mirat për të ardhmen tuaj si dhe të vendit tuaj, por edhe për një të ardhme më të mirë të Europës.”

Dr. Erhard Busek Special Coordinator for the Stability Pact for SEE

- SISTEMET E INFORMACIONIT (Baçelor dhe Master)

- Sistemet e Informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Librarive dhe Menaxhimi i Dijes
- Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe simulim
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia

- ARKITEKTURË DHE

PLANIFIKIM HAPËSINOR (Baçelor dhe Master)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

- INXHINIERI NDËRTIMQRE (NDËRTIMTARI)

DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

Lagja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400, Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjiilan